

**MINISTRINA E EKONOMISË, KULTURËS DHE
INOVACIONIT**

**RAPORTI I MONITORIMIT PËR
KATËR MUJORIN E PARË 2025**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
-SEKTORI I BUXHETIT-

RAPORT

MBI

MONITORIMIN E FONDEVE BUXHETORE TË KATËR MUJORIT TË PARË 2025
PËR MINISTRINË E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

MAJ 2025

PËRMBATJA

HYRJE.....	2
RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE 4 MUJORI I PARË 2025	5
ANALIZA SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE PËR VITIT 2024	6
INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT	8
ANALIZA FINANCIARE SIPAS PROGRAMEVE	0
PROGRAMI I PLANIFIKIMIT MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMI (PROGRAMI 01110)	0
PROGRAMI I TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË (PROGRAMI 08220).....	1
PROGRAMI I ARTI DHE KULTURA (PROGRAMI 08230).....	15
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PËR INOVACION DHE TEKNOLOGJI (PROGRAMI 01150)	25
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PËR ZHVILLIM EKONOMIK (PROGRAMI 04130)	27
PROGRAMI I MBËSHTETJES PËR MBIKËQYRJEN E TREGUT, INFRASTRUKTURA E CILËSISË & PRONËSIA INDUSTRIALE (PROGRAMI 04160).....	42
PROGRAMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE (PROGRAMI 10220)	45
PROGRAMI I TREGUT TË PUNËS (PROGRAMI 10550)	47
PROGRAMI I INSPEKTIMI NË PUNË (PROGRAMI 04170)	50
PROGRAMI I ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL (PROGRAMI 09240)	53
PROGRAMI I STREHIMIT (PROGRAMI 06190)	55
APARATI I MINISTRISË SË EKONOMISË, INOVACIONIT DHE KULTURËS NËPËR PROGRAMET ..	60
SHPENZIMET NGA TË ARDHURAT JASHTË LIMITIT	64
PËRFUNDIMI.....	65

Ky dokument përfaqëson raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program që ka në fushën e përgjegjësisë shtetërore Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit sipas VKM nr. 30, datë 17.01.2024.

Ky dokument ofron informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit dhe mbulon periudhën 1 janar 2025 deri më 30 prill 2025.

Strategjia e MEKI-it është arritja e një buxheti më të mirë të balancuar dhe të qëndrueshëm, ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur me monitorimin e tij.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2024 për MEKI përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e MEKI-it kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin strategjik të ecurisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të MEKI-it në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesish të performancës.

Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit 12 mujor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit buxheti i MEKI-it është mbështetur plotësisht në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimi të programit buxhetor afatmesëm.

Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës MEKI do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit.

Forma dhe përmbajtja e raporteve të monitorimit u krye sipas Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar gjatë përgatitjes së raportit zhvilloi komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të varësisë të MEKI, me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të qartë të arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës raportuese.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën makro-dhe mikroekonomike, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim garantimin e një rritjeje ekonomike të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Miradministron burimet, harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergimit ekonomikosocial të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës e të shërbimeve për biznesin e qytetarin. Promovon dhe orienton drejt risive ndërkombëtare duke maksimizuar suksesin e investimeve.

Komandon instrumente administrative ekzekutive të zgjidhjes së konflikteve shtet-privat;

b) garanton të drejtën për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë;

c) harton dhe zbaton politikat e qeverisë në fushën e zhvillimit dhe promovimit të kulturës, trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së dialogut kulturor, integritetit kulturor

në familjen evropiane e botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

ç) synon dhe mundëson stimulimin e aktivitetet inovative, të cilat do të rrisin produktivitetin ekonomik dhe institucional përmes zhvillimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit efikas;

d) identifikon koncepte, procese novatore dhe teknika të reja, kryen studime dhe analiza krahasuese për politikat në nivel rajonal e botëror, për të vlerësuar të dhënat në kuadër të hartimit

apo zbatimit të politikave qeveritare, me qëllim hartimin e strategjive që mundësojnë zbulimin e mundësive të reja të inovacionit;

dh) në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, bashkërendon dhe zbaton politikat shtetërore që synojnë standarde të larta të shërbimeve publike, të ofruara për ushtrimin e të drejtave

të qytetarëve dhe përmirësimin Krijimi i mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat.

MEKI harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, konvergjimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimin të klimës e të shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për arsim dhe formim profesional, punësim të sigurt e të denjë, sigurim shoqëror.

Mbulimi i prioriteteve strategjike të institucionit me fondet e mjaftueshme buxhetore është një synim, i cili do të sigurojë institucionit qëndrueshmërinë dhe integritetin e nevojshëm për arritjen e rezultateve që përmirësojnë jetën e qytetarëve. Mund të ekzistojë një mospërputhje jomateriale ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela dhe grafikë për shkak të rrumbullakimeve. Vlerat e plota paraqiten në anekset bashkëngjitur këtij raporti.

MEKI, për përmbushjen e misionit të saj, për vitin 2024, administron dhe menaxhon fondet publike, në bazë të Ligjit nr. 9936/2008, i ndryshuar dhe Ligjit nr.97/2023, datë 07.12.2022, si dhe në bazë të akteve normative të dala gjatë vitit apo Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Këto fonde janë alokuar për 11 programe, të cilat mbështetin tre shtyllat kryesore të institucionit.

SHTYLLA 1: EKONOMI

Qëllimi: Të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rritja e konkurrencës. Programet buxhetore të përfshira (7):

 Mbështetje për Zhvillim Ekonomik

 Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilësisë & Pronësia Industriale

 Inspektimi në Punë

 Strehimi

 Arsimi i Mesëm Profesional

 Sigurimet Shoqërore

 Tregu i Punës



SHTYLLA 2: KULTURË

Qëllimi: Të ruhet dhe zhvillohet pasuria kulturore dhe identiteti kombëtar. Programet buxhetore të përfshira (2):



Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë



Arti dhe Kultura



SHTYLLA 3: INOVACION

Qëllimi: Të promovohen zgjidhje inovative për t'u përballur me sfidat e kohës. Programi buxhetor i përfshirë (1):



Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji

✂ Programi i Koordinimit Institucional: “Planifikim, Menaxhim, Administrim (PMA)”

Ky program mbështet në mënyrë tërthore të tre shtyllat strategjike, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të institucionit. Ai financon organizimin dhe menaxhimin e burimeve dhe proceseve të brendshme për funksionimin e përditshëm të Aparatit të MEKI, në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore.



Qasje e Integruar Ndërsektoriale

Të gjithë sektorët bashkëpunojnë për të krijuar një ekosistem të fortë dhe të qëndrueshëm, ku zhvillimi ekonomik, pasuria kulturore dhe inovacioni, veprojnë në sinergji për të përmbushur misionin institucional dhe për të përballuar sfidat e kohës.

RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE 4 MUJORI I PARË 2025

Me ligjin nr.115/2024, për grup 12, është miratuar plani fillestar me vlerë 56,006129,000 lekë. Me miratimin e VKM-së nr. 30, datë 17.01.2024 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, ministria shtuan edhe disa fusha përgjegjësie dhe në total administrohen fonde për 11 programe. Gjatë periudhës janar - prill u miratuan edhe një akte normativ.

Gjatë kësaj periudhe këto burime financiare MEKI i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj.

Kanë ndodhur disa ndryshime mbi planin fillestar, të cilat janë të detajuara në kapitujt më poshtë. Si rrjedhim i kësaj, plani i rishikuar rezulton të jetë 57 miliardë lekë. Këto fonde buxhetore të miratuara, MEKI i ka administruar për financimin e aktiviteteve në 11 programe të cituara me sipër.

Në fund të muaji prill 2024, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin, sipas të dhënave të gjeneruara sipas Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, të datës 13 maj 2025, paraqitet si më poshtë. Plan i investimeve me financim të huaj është bërë aktiv në sistem pas 4 muajorit të pare.

Realizimi i shpenzimeve për çdo program paraqitet kundrejt planit të rishikuar.

Tabela 1 Shpenzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë sipas programeve

Vlera në mijë lekë

Kodi i Programit	Emërtimi	Shpenzime Faktike 2024	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Shpenzime Faktik	% e realizimit
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,741,886	526,979	528,388	203,885	38.6%
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	70,973	349,388	1,349,488	907,793	67.3%
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	389,682	511,619	511,992	135,112	26.4%
04160	Mbështetje për Mbikqyrjen Tregut, Infrastruktura Cilësisë & Pronësia Industriale	383,415	389,922	390,822	134,164	34.3%
04170	Inspektimi në Punë	236,379	282,984	283,384	80,913	28.6%
06190	Strehimi	1,070,622	1,295,000	1,295,000	144,065	11.1%
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	1,006,537	1,119,378	1,120,881	202,964	18.1%
08230	Arti dhe Kultura	2,400,735	2,989,063	2,990,567	545,599	18.2%
09240	Arsimi Mesëm Profesional	3,265,936	3,940,469	3,943,939	890,290	22.6%
10220	Sigurimet Shoqërore	46,217,951	40,800,090	40,800,090	12,635,567	31.0%
10550	Tregu i Punës	2,457,661	2,926,547	2,927,547	721,644	24.7%
	Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë	60,241,777	55,131,439	56,142,098	16,601,995	29.6%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	473,108			21,198	
	Totali Shpenzimeve të Ministrisë	60,714,885			16,623,193	

Burime MEKI

Nga sa shihet në nivel ministrie vitit 2025 është realizuar rreth 16.6 miliardë lekë ose 29.6 % e planit të rishikuar (pa përfshirë të ardhurat jashtë limitit).

ANALIZA SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE PËR VITIT 2025

Treguesit bazë të realizimit buxhetor për 11 programe sipas llogarive ekonomike paraqiten si më poshtë:


Tabela 2 RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

Artikulli	Emërtimi	Shpenzime Faktike 2024	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Vlera në lekë	
					Shpenzime Faktik	% e realizimit
600	Paga	4,281,623,618	5,023,627,000	5,008,627,000	1,659,795,138	33.1%
601	Sigurime Shoqërore	703,187,290	853,311,000	850,311,000	272,818,966	32.1%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,609,600,439	1,355,905,000	1,344,995,390	298,574,644	22.2%
603	Subvencione	540,293,991	750,000,000	750,000,000	176,874,750	23.6%
604	Transferta Korente të Brendshme	48,848,366,073	41,665,505,000	41,666,345,000	12,716,305,878	30.5%
605	Transferta Korente të Huaja	64,046,552	31,826,000	61,826,000	19,500,114	31.5%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,688,201,647	1,975,796,000	1,984,524,482	391,525,406	19.7%
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	57,735,319,610	51,655,970,000	51,666,628,872	15,535,394,896	30.1%
230	Kapitale të Patrupëzuara	30,154,809	60,620,000	58,535,000	-	0.0%
231	Kapitale të Trupëzuara	1,990,689,060	3,414,849,000	3,416,934,000	169,658,615	5.0%
232	Transferta Kapitale	20,000,000		1,000,000,000	867,200,000	86.7%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshëm	2,040,843,869	3,475,469,000	4,475,469,000	1,036,858,615	23.2%
230	Kapitale të Patrupëzuara	8,116,140	-	-	1,800	
231	Kapitale të Trupëzuara	457,497,280	-	-	29,739,587	
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj	465,613,420	-	-	29,741,387	
	Totali Shpenzime Kapitale	2,506,457,289	3,475,469,000	4,475,469,000	1,066,600,002	23.8%
	Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor	60,241,776,899	55,131,439,000	56,142,097,872	16,601,994,898	29.6%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	473,108,202			21,198,443	
	Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga te ardh. jashte limti	60,714,885,101			16,623,193,341	

Burimi MEKI

Me poshtë paraqitet ecuria e buxhetit sipas llogarive ekonomike fakt vs. Plan i rishikuar 2024.

Figura 1 Plan/fakt 2024 sipas llogarive ekonomike




Duke analizuar përqindjen e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të MEKI, siç tregohet në figurën e sipërme, pjesën më të madhe të shpenzimeve e zë llogaria 604

“Transferta Korente të Brendshme”, e cila përbën rreth 74.2% të planit buxhetor. Pas saj ndodhen llogaritë “Paga dhe Sigurime” me rreth 8.9%, dhe “Mallra dhe shërbime të tjera” së bashku me llogaritë 603, 605, dhe 606, që përbëjnë rreth 5%. Ndërkohë, “Shpenzimet kapitale” zënë 8 % të totalit. Ky shpërndarje e shpenzimeve lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë dhe kërkesat e MEKI për të përmbushur detyrimet ligjore. Në këtë kuadër, rreth 46.22 miliardë lekë, ose 9.6 miliardë lekë më shumë se në 12-mujorin e vitit të kaluar, janë alokuar në programin 10220 “Sigurimi Shoqëror” për të mbuluar pagesat e pensioneve publike, për shkak të indekseve dhe shpërblimeve për pensionistët. Rritja e pagave në korrik 2024 ka ndikuar gjithashtu në strukturën e shpenzimeve.

Po ashtu, duke krahasuar peshën e llogarive ekonomike të planifikuara dhe të realizuara, siç ilustron në figurën 2, vërehet një qëndrueshmëri e peshës së këtyre shpenzimeve gjatë vitit 2024. Menaxhimi rigoroz i procedurave të financave publike ka siguruar stabilitetin financiar të institucionit. Qëllimi për periudhën e ardhshme është vazhdimi i konsolidimit financiar dhe administrativ për të arritur realizimin e plotë të buxhetit dhe të treguesve të performancës të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Pesha specifike sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve, paraqitet sipas figurës të mëposhtme:

Figura 2 STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA VS. REALIZIMIT 2024



INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për vitin 2025 buxheti i miratuar sipas Ligjit nr. 115/2023. Gjatë vitit buxheti pësoi ndryshime, të cilat konsistojnë në ndryshime, shtesa të fondit të veçantë, si dhe akte normative.

Tabela më poshtë paraqet planin e rishikuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

Ligji i buxhetit nr. 115/2024, është miratuar detajimi si me poshtë:

- Shkrese e MF, protokolluar në MEKI me nr.16474/1, datë 22.01.2025 për shpenzime korrente;
- Shkrese e MF, protokolluar në MEKI me nr.3211, datë 26.02.2025 për shpenzime kapitale

Transferime dhe Fond i veçantë

- Fondi veçantë sipas shkrese se MF protokolluar me tonën nr. 2503/1, datë 18.03.2025;
- Pagesa kalimtare sipas shkresës se MF protokolluar ne MEKI me nr. 16153/2, date 10.02.2025

Akte Normative

- AN nr. 3, datë 30.04.2025;

Figura 3 Ndryshimet e buxhetit për periudhën janar - prill 2025

Në lekë

<i>Titulli</i>	<i>Emërtimi i Institucionit Buxhetor / Programit</i>	<i>Plan Fillestar Viti 2025 (*)</i>	<i>Shkrese nr. 16153, dt 10.02.2025</i>	<i>Fondi i veçantë</i>	<i>AN nr.3</i>	<i>Plani i rishikuar</i>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	526,979,000	558,872	850,000		528,387,872
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë	1,139,378,000		1,503,000		1,140,881,000
08230	Arti dhe Kultura	3,009,063,000		1,504,000		3,010,567,000
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	349,388,000		100,000	1,000,000,000	1,349,488,000
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	676,309,000		373,000		676,682,000
04160	Mbështetje për Mbikëqyrje e Tregut, Infrast. e Cilësi dhe Pron. Industr.	389,922,000		900,000		390,822,000
10220	Sigurimi Shoqëror	40,800,090,000				40,800,090,000
10550	Tregu i Punës	3,026,547,000		1,000,000		3,027,547,000
04170	Inspektimi ne Pune	282,984,000		400,000		283,384,000
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	4,510,469,000		3,470,000		4,513,939,000
06190	Strehimi	1,295,000,000				1,295,000,000
	Total	56,006,129,000	558,872	10,100,000	47,290,296	57,016,787,872

Burimi MEKI

(*) FH

ANALIZA FINANCIARE SIPAS PROGRAMEVE

Të analizuara sipas programeve treguesit buxhetor paraqiten:


Programi i Planifikimit Menaxhimit dhe Administrimi (Programi 01110)

Qëllimi dhe Objektivi i këtij programi: Përmirësimi i strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore, krijimi i një stafi permanent dhe sa më të qëndrueshëm, si dhe aplikimi i proceseve transparente të konkurrencës në përputhje me parimet e barazisë gjinore, motivimi për ngritjen në detyrë sipas rezultateve të punës, rritja e luftës kundër korrupsionit si- një element shumë i rëndësishëm për ecjen përpara në përputhje me standardet e BE-së. Zhvillimi i politikave në sektorin e ekonomisë, kulturës dhe inovacionit në përputhje me standardet evropiane.

Janë realizuar rreth 2.71 miliardë lekë nga rreth 3.14 miliardë lekë të planit të miratuar ose rreth 87% (këtu përfshihet edhe fondi i veçantë i çelur sipas udhëzimit plotësues nr. 1). Kjo norma e realizimit ka qenë e ndikuar ndjeshëm nga zhvillimi i proceseve gjyqësore, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Aparati ka arritur të sigurojë burime financiare për realizimin e këtyre proceseve, duke kontribuar kështu në avancimin e tyre dhe uljen e detyrimeve të prapambetura ndër vite. Megjithatë, për një prej vendimeve gjyqësore më të rëndësishme dhe me ndikim, u pranua rekursi nga ana e Gjykatës së Lartë, pasi ishin çelur fondet.

Figura më poshtë paraqet ecurinë plan/fakt për vitin 2024.

Figura 4 Programi i Planifikimit Menaxhimit dhe Administrimi (Programi 01110)



Për periudhën Janar - Prill 2025, realizimi sipas artikujve buxhetore paraqitet në tabelën si më poshtë:

Fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve është realizuar në masën 55 %.

Fondi për shpenzimet operative të Aparatit të MEKI-it është realizuar në masën 30 % për arsyet që cituam më sipër. Shpenzimet janë realizuar për shlyerjen e detyrimeve prioritare, si energji elektrike, ujë, shërbime postare si dhe taksa makinash, blerje karburanti, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, shlyerja e detyrimeve kontraktuale, prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

- Realizimi sipas produkteve buxhetore

Staf i trajnuar

Për këtë produkt janë trajnuar sipas fushës së përgjegjësisë së MEKI-it rreth 28 punonjës.

Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara

Për këtë produkt janë realizuar akte ligjore dhe nënligjore të miratuara sipas fushës së përgjegjësisë së MEKI-it. Për vitin 2024 janë hartuar rreth 30 akte.

Investimet me financim të brendshëm

Tabela nr.3 Realizimi i Investimeve

në lekë

Emërtimi i Projektit	Plani	Obligim	Fakt	Fonde disponibel	Realizim ne %
F.V. Sistem ngrohje ftohje per ish ambjentet e MZHETTS sot MEKI	22,100,000	21,644,832	-	455,168	0%
Rikonstruksion i godinës për ish ambjentet e MZHETTS	47,900,000	47,900,000	-	-	0%
Blerje Pajisje	10,000,000	-	-	10,000,000	0%
Total	80,000,000	69,544,832	-	10,455,168	0%

Financimi i brendshëm

Gjatë periudhës raportuese, janë planifikuar gjithsej 80,000,000 lekë për projekte investimi, nga të cilat janë angazhuar 69,544,832 lekë. Megjithatë, nuk është realizuar asnjë pagesë faktike deri në këtë fazë, duke rezultuar në një nivel realizimi prej 0%. Pjesa më e madhe e fondeve janë të lidhura me dy projekte kryesore: sistemi i ngrohje-ftohjes dhe rikonstruksioni i godinës, aktualisht në përdorim nga MEKI. Këto projekte ndodhen në fazë prokurimi ose zbatimi dhe pritet të kenë përparim në muajt në vijim. Gjithashtu, janë të disponueshme 10,455,168 lekë për t'u angazhuar për blerje pajisjesh, proces i cili është në pritje të procedurave përkatëse.

Programi i Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë (Programi 08220)


Programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë është një nga programet e MEKI-it, i cili synon ruajtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e saj si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehje e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive. Trashëgimia kulturore përbëhet nga vlera materiale të luajtshme dhe të paluajtshme (dëshmi të arkitekturës, peizazhit, arkeologjisë) dhe vlera jomateriale që përbëjnë dijen dhe përvojën shpirtërore (ritet, zakonet, zejet tradicionale, folklori dhe gjuha) të krijuar dhe transmetuar nga populli përgjatë shekujve.

Ky program zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, pjesë e Ministrisë së Kulturës si dhe nëpërmjet 18 institucioneve në varësi të saj (si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Muzetë Kombëtarë, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Zyrat e KA Parqet Arkeologjike, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, etj.).

Objekti i këtij programi është rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara

Figura më poshtë paraqet një analizë të shpenzimeve korrente/kapitale plan dhe fakt 4 - muajor 2024

Figura 9 Programi i Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë (Programi 08220)



Plani fillestar është miratuar në vlerën 1,068,078,000. Pas shtese se fondi te veçantë dhe duke marre parasysh qe FH u be aktiv ne sistem ne muajin maj plani i këtij programi është 1,120,881,000 lekë. Me aktin normativ nr. 1, datë 21.02.2024, plani është rishikuar dhe vlera është 1,11 miliardë lekë dhe me aktin normativ nr. 5, date 19.12.2024 është rishikuar në vlerën 1.034 miliardë lekë. Gjatë muajit korrik-gusht u akorduar fonde për rritjen e pagave në vlerën 40.6 milion lekë. Në total plani i rishikuar për 12-mujorin, për këtë program duke përfshirë edhe fondin e veçantë është 1.08 miliardë lekë, ku përfshihet edhe fondi i veçantë.

Për arritjen e objektivave për vitin 2024 janë realizuar produktet me të dhënat si më poshtë vijon:

- Shpenzimet korrent

Është realizuar promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimisë dhe aktiviteteve në funksion të saj. Kështu, gjatë 4 M 2025 janë realizuar produktet:

- Me një kosto rreth 108.2 milionë lekë, janë kryer punime mirëmbajtje dhe restaurime 757 në objekte, si edhe ndërhyrje restauruese, konsoliduese, pastrime nga vegetacioni apo mirëmbajtje.
- Janë mirëmbajtur muze të vizitueshem nga publiku me një kosto prej 67.3 milionë lekë.
- Është realizuar produkti “Trashëgimia materiale e jo materiale e inventarizuar” me një numër kartelash faktike prej 216 me një kosto prej 4.75 milionë lekë.
- Janë zhvilluar 140 aktivitete edukuese/promovuese mbi trashëgiminë kulturore prej 21.5 milionë lekë.

Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ushtron aktivitetin buxhetor, në programin buxhetor “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë”, me kod programi 08220, kapitulli 01.

Për 4- mujorin e parë 2025 është bërë realizimi i fondeve buxhetore si vijon:

Llogaria 600, kod produkti 91202AH-akte ligjore/nënligjore të miratuara, celur në masën 3,786,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Llogaria 601, kod produkti 91202AH -akte ligjore/nënligjore të miratuara, celur në masën 1,724,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Llogaria 602, kod produkti 91202AD- aktivitete të fushës së trashëgimisë jomateriale, celur në masën 63,776,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Llogaria 604, kod produkti 91202AD - aktivitete të fushës së trashëgimisë jomateriale, celur në masën 92,219,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 17,413,800 lekë.

Llogaria 606, kod produkti 91202AG- kthimi i objekteve ne qendra historike, ne modele biznesi, celur në masën 113,000,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Referuar llogarisë 604, kod produkti 91202AD “Aktivitete të fushës së trashëgimisë jomateriale”, gjatë periudhës Janar- Prill 2025 janë realizuar:

- Ngjarje kulturore dhe krijuese- Festivale, Evente dhe Panaire.
Gjithsej projekte të mbështetura *110 projekte*

Kontraktuar deri në 30.04.2025 *61 subjekte*

- Mbështetje e Programeve Kulturore të Organizatave.

Gjithsej projekte të mbështetura *39 projekte*

Kontraktuar deri në 30.04.2025 *36 subjekte*

- Fondi i Artizanëve

Gjithsej projekte të mbështetura *43 projekte*

Kontraktuar deri në 30.04.2025 *15 subjekte*

- Fondi i Krijimtarisë

Gjithsej projekte të mbështetura *53 projekte*

Kontraktuar deri në 30.04.2025 *24 subjekte*

- Pjesëmarrja e Shqipërisë në Bienalen Ndërkombëtare të Arkitekturës

Në kuadër të projektit për pjesëmarrjen e Shqipërisë në edicionin e 18-te të Bienales Ndërkombëtare të Arkitekturës është kryer praktika për pjesëmarrjen e delegacionit/stafit të MEKI-t në inaugurimin e pavijonit shqiptar të mbajtur më datë 8 maj 2025.

Shpenzimet (të miratuara me vendim Kolegjiumi dhe Urdhër Ministri Nr. 606 datë 2.05.2025 dhe 3570/10, datë 2.05.2025) kanë përfshirë:

1. Miratimin e përzgjedhjes të subjektit Arlo Travel – Blu Tour Operator shpk, me NIPT: L01305031H, në vlerën **561,000 Lekë** me tvsh, si operatorin fitues i cili do të ofrojë shërbimin “Udhëtim ndërkombëtar / bileta avioni + siguracion shëndeti Tiranë – Treviso- Tiranë, transport i brendshëm (Aeroport Treviso- Venecia – Aeroport Treviso) dhe hoteleri / akomodim”, në kuadër të pjesëmarrjes së delegacionit/stafit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në inaugurimin e pavijonit shqiptar datë 8.05.2025, në Edicionin e 19-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Bienales së Arkitekturës në Venecia, Itali, 2025. (Kontratë shërbimi nr. 3570/12 prot, datë 5.05.2025 me Arlo Travel – Blu Tour Operator shpk me NIPT: L01305031H)
2. Miratimin e dietave, taksë qyteti, taksë turisti, shpenzime transporti të brendshëm, të stafit/delegacionit zyrtarë të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në vlerën e parashikuar prej **1,550 Euro**.

Vlerat e sipërcituara janë miratuar të mbulohen nga fondet e buxhetit të miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacioni për vitin 2025, **zëri 604**, programi “Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë”.

- Event promovues në kuadër të përfaqësimit të “K’cimi i Tropojës” në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit.

Ky projekt u mbështet financiarisht nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shumën 4.968.000 Lekë, me TVSH, dhe u zhvillua më datë 25.04.2025, pranë ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit, dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP).

Vallja “K’cimi i Tropojës”, u regjistrua në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit (Representative List of the Intangible Cultural Heritage of Humanity), në dhjetor 2024 gjatë punimeve të sesionit të 19-të të Komitetit Ndërqeveritar për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, të UNESCO-s, në Asuncion, Republika e Paraguit. Elementi më të ri në trashëgiminë kulturore jomateriale shqiptare, pjesë e UNESCO, tashmë të njohur në nivel global, si një thesar kulturor me vlera unike.

- Natë në Muze

Që prej 2001, ICOM në bashkëpunim me UNESCO dhe Këshillin e Europës kanë organizuar aktivitetin “Natë në Muze”, i cili përfshin orare më të zgjatura në gjithë ekspozitat e muzeut, hyrje falas dhe aktivitete të tjera argëtuese dhe kulturore. Ky aktivitet organizohet dhe në disa prej muzeve kombëtarë, me mbështetje financiare nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

DREJTORITË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

DRTK Gjirokastrë ushtron aktivitetin buxhetor, në programin buxhetor “Objekte monument kulture të ruajtura dhe mbrojtura”. Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 44,069,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 14.383.171,16 lekë. Për vitin 2025 është bërë shpërndarja sipas zërave dhe realizimi i fondeve buxhetore përkatësisht:

Llogaria 600-paga, celur në masën 24,500,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 9,303,622 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 4,100,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 1.556.355 lekë.

Llogaria 602 - mallra dhe shërbime, celur 15.200.000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 3,523,194.16 lekë.

Referuar llogarisë 602, në Art. 91202AA “Evidentimi, ruajtja, mirëmbajtja, restaurimi, dhe promovimi i Monumenteve të Kulturës, pjesë e Trashëgimisë Kulturore, si dhe Qendrën Historike dhe zonën e mbrojtur të qytetit, pasuri e Trashëgimisë Botërore, UNESCO-s” janë realizuar:

- *Ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe restauruese ne objektet Monument Kulture- 32*
- *Hartim projektesh per mirëmbajtjen e Monumenteve te Kulturës- 3*
- *Inspektive në objekte Monument Kulture- 30*
- *Vendime të KKR-së, të miratuara për objektet Monument Kulture- 7*
- *Aktivitete social -kulturore, organizuar në objekte Monument Kulture, ose në funksion të tyre- 8*
- *Trainime të ndryshme, kryer në funksion të objektit të aktivitetit- 1*

Referuar aktivitetit të DRTK Gjirokastrë, për katër mujorin e parë të vitit 2025, rezulton të ketë një realizim total të Buxhetit në masën 23.18 %, referuar fondeve të alokuara dhe atyre të realizuara. Gjatë vitit 2025, DRTK Gjirokastrë nuk ka pasur fonde për Shpenzime Kapitale. Gjatë katër mujorit të parë të vitit 2025, DRTK Gjirokastrë ka realizuar të Ardhura në masën 8.089.320 lekë.

DRTK Berat ka për mision gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e Trashëgimisë Kulturore në territorin e qarkut Berat. Objektivi i programi është të sigurojë restaurimin, mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, hartimin e projekteve si edhe vazhdimin e programit “Edukimi përmes Kulturës”. Buxheti i alokuar i DRTK Berat për vitin 2025 është 29,087,200 ALL. Përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2025, janë realizuar 12 ndërhyrje mirëmbajtje/restaurime; janë hartuar 8 projekte si edhe janë kryer 10 aktivitete kulturore dhe edukuese si vijon:

Ndërhyrje restaurimi dhe mirëmbajtje

1. Restaurim i dy ikonave “Krishti” dhe “Shën Mëria” me autor Vëllezërit Çetiri në vlerën 99.200 lekë.
2. Mirëmbajtje e strehës së portës hyrëse në banesën e Z. Harmanak Badajani, në vlerën 10,050 leke.
3. Mirëmbajtje në fasadën e banesës së familjes Prroj, në vlerën 13,881 leke.
4. Mirëmbajtje e portës hyrëse në banesën e Znj. Olimbi Zanati, në vlerën 21,370 leke.
5. Mirëmbajtje në çatinë e banesës së familjes Droboniku me investim privat.
6. Restaurim i portës në banesën e familjes Xhimitiku në vlerën 47,934 leke.
7. Mirëmbajtje e tabelave informuese për monumentet kategori e parë në Qendrën Historike në vlerën 107,717 leke.
8. Mirëmbajtje e dritareve në Katedralen Fjetja e Shën Mërisë sot muzeu Onufri në vlerën 15,795 lekë.
9. Ndërhyrje restauruese në banesën e Z. Ëngjëll Koço në vlerën 4293 Lekë.
10. Restaurim dhe konservim i afreskut në kishën e Shen Triadhës në vlerën 95,000 lekë.

11. Ndërhyrje restauruese në banesën e Z. Kostandin Proj, në vlerën 13,881 Lekë.
12. Ndërhyrje emergjente në kishën e Shën Todrit në lagjen Kala, në vlerën 31,775 Leke.

Hartim projektsh

1. Projekt Restaurimi “Rrënojat e Urës së Palecit”.
 2. Projekt restaurimi dhe konservimi në muret e Kalasë.
 3. Hartim i projektit “Mirëmbajtje dhe konsolidim të mureve dhe strehës së çatisë në kishën e Shën Mëhillit”.
 4. Projekt restaurimi dhe konservimi i kishës së Shën Kollit në Perondi.
 5. Hartim i “Paketës së punimeve emergjente parandaluese (konservim, restaurim, mirëmbajtje)” në qytetin e Beratit e përreth.
 6. Hartim projekti për ndërhyrje emergjente në banesën “Nikolla Manestra”
 7. Hartimi i projektit të ndërhyrjeve restauruese në “Xhaminë e Vokopolës”.
 8. Hartimi i projekt restaurimi “Kisha Shën Mëri e Ujrave” në lagjen Mangalem.
- Projektet hartohen nga specialistët e DRTK Berat dhe kostoja e hartimit të tyre është zero lekë.

Aktivitete

- Edukimi nëpërmjet kujtesës historike në vlerën zero lekë.
- Edukimi përmes Trashëgimisë në vlerën 10.000 leke.
- Trashëgimia Kulturore përmes syve të nxënësve në vlerën zero lekë.
- Punëtori Veshjet Tradicionale në vlerën zero lekë.
- Vizitë në Laboratorin e Restaurimit në vlerën zero lekë.
- Punëtori “Monumentet e Qytetit tim” në vlerën 3000 leke në vlerën zero lekë.
- Folklori ynë, pasuri e çmuar në vlerën zero lekë.

Lista e Kontratave të Prokurimit Janar-Prill 2025

- Kontratë Prokurimi me objekt “Furnizim vendosje portë e jashtme druri” në vlerën 500 000 Lekë pa Tvsh. Ende në proces.
- Kontratë Prokurimi me objekt “Blerje derrasë pishe” në vlerën 352 000 Lekë Pa tvsh. Ende në proces.
- Kontratë Prokurimi me objekt “Berje materiale për Kishën e Shën Triadhës” në vlerën 96 600 Lekë Pa tvsh. E përfunduar.
- Kontratë Prokurimi me objekt “Materiale për restaurimin e Ikonave” në vlerën 96 200 Lekë Pa tvsh. E përfunduar.
- Kontratë Prokurimi me objekt “Sigurim i makinës” në vlerën 28 209 Lekë Pa tvsh. E përfunduar.

DRTK Vlorë ushtron aktivitetin e vet në Qarkun Vlorë dhe Fier, në 13 Bashki në zbatim të Ligjit 27/20, si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Institucionit. Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 49,864,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 15,795,000 lekë ose 32%. Numri i punonjësve në organikë është 36 punonjës. Programi “Monumente të mirëmbajtura dhe të vizitueshme nga publika” për vitin 2025 përbëhet nga një produkt, i cili është në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuara, për ruajtjen dhe rritjen e vizitueshërisë në parqet dhe kalatë që DRTK Vlorë ka nën administrim.

DRTK Korçë e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit 27/2018, VKM Nr. 581 Dt. 28/08/2019 dhe të statutit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Buxheti i alokuar për vitin 2025 për institucionin është 28,014,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 9,206,388 lekë ose 33%. Është bërë shpërndarja sipas zërave dhe realizimi i fondeve buxhetore përkatësisht:

Llogaria 600-paga, janë realizuar për periudhën raportuese në masën 7,446,212 lekë, 36%.

Llogaria 601-sigurimet shoqërore janë realizuar për periudhën raportuese në masën 1,246,318 lekë, 36%.

Llogaria 602 - mallra dhe shërbime të tjera janë realizuar për periudhën raportuese në masën 513,858 lekë, 13%. Referuar llogarisë 602 - Aktivitete të Trashëgimisë Jomateriale si vijon:

- Edukimi përmes Kulturës
- Orë të hapura mësimore
- Vizita në monumente
- Ekspozita dhe aktivitete të tjera kulturore

Numri i punonjësve buxhetorë i miratuar në organikë është 26 dhe dy punonjës me kontratë dhe aktualisht është një vend vakant. Numri faktik i punonjësve është 27.

DRTK Shkodër është institucion i specializuar, tekniko-administrativ buxhetor. Për periudhën janar – prill 2025 çështjet kryesore për t'u përmendur janë mirëmbajtja e monumenteve, hartimi i projekteve mirëmbajtëse dhe restauruese, mbarëvajtja e sezonit turistik, përmirësimi i infrastrukturës në shtet e vizitueshme si dhe zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të edukimit nëpërmjet kulturës. Plani fillestar i buxhetit për vitin 2025 është 31,774,000 lekë . Plani i rishikuar për vitin 2025 është 31,824,000 lekë. Ky plan përfshin fondet për të gjitha llogaritë, si paga, sigurime shoqërore dhe shëndetsore, mallra dhe shërbime, fondi i veçantë si dhe nga kapitulli 5. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 10,389,208 lekë. Është bërë shpërndarja sipas zërave dhe realizimi i fondeve buxhetore përkatësisht:

Llogaria 600-paga, janë realizuar për periudhën raportuese në masën 7,489,367 lekë.

Llogaria 601-sigurimet shoqërore janë realizuar për periudhën raportuese në masën 1,253,602 lekë.

Llogaria 602 - mallra dhe shërbime të tjera janë realizuar për periudhën raportuese në masën 1,596,239 lekë. Referuar Art. 602 Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër gjatë 4- muorit të parë të vitit 2025 ka kryer:

- Restaurim fasade e jashtme dhe ambiente të brendshme banesa "Pashko Vasa"
- Lyerje grila përgjate zonës Muzeale
- Pastrim shkalle guri Banesa Bushati – Gjyrezi

Referuar aktiviteteve DRTK Shkodër ka zhvilluar:

- Pesë aktivitete të "Edukim përmes Kulturës".
- Një video promovuese për karnevalet në Shkodër.
- Një aktivitet kushtuar gjuhës dhe kulturës Rome.
- Një aktivitet kushtuar Ditës Ndërkombetare të Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike.

DRTK Shkodër nuk ka të akorduar në buxhet fonde për aktivitete si edhe në llogarinë ekonomike 604. Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar është 22 punonjës në organikë. Ky ka qënë dhe numri i punonjësve gjatë këtij 4- muor.

Performanca jo- financiare e programit buxhetor:

Numri i vizitorëve për periudhën Janar-Prill 2025 është 33,304 vetë. Numri i inspektimeve në objekte monumente kulture është 75.

Në lidhje me ndryshime në buxhet është akorduar shtesë fondi në llogarinë 606 në vlerë 50,000 lekë për një ndërhyrje kirurgjikale të një punonjësi të DRTK Shkodër.

DRTK Tiranë ka në administrim 379 monumente dhe 32 zona të mbrojtura, të shpërndara në tre qarqe. Buxheti i alokuar për vitin 2025 për DRTK Tiranë është 28,314,000 lekë. Në planin e buxhetit përfshihen fondet për të gjitha llogaritë, si paga, sigurime shoqërore dhe shëndetsore, shpenzimet për administratën dhe shpenzimet për projektet. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 8,195,856 lekë. Shpërndarja sipas zërave dhe realizimi i fondeve buxhetore janë bërë si vijon:

Llogaria 600-paga, celur në masën 17,500,000 lekë, janë realizuar për periudhën raportuese në masën 6,412,557 lekë.

Llogaria 601-sigurimet shoqërore, celur në masën 2,940,000 lekë, janë realizuar për periudhën raportuese në masën 1,145,396 lekë.

Llogaria 602 - mallra dhe shërbime të tjera, celur në masën 7,800,000 lekë janë realizuar për periudhën raportuese në masën 628,767 lekë.

Llogaria 606 - transferta për buxhetet familiare dhe individët, celur në masën 24,000 lekë, janë realizuar për periudhën raportuese në masën 9,136 lekë.

Numri faktik i punonjësve është 20+7.

DRTK Tiranë ka zhvilluar aktivitetet:

- *"Edukimi përmes Kulturës"*
- *"Arkeologu i vogël"*

MUZE KOMBËTAR

MUZEU HISTORIK KOMBËTAR si institucioni muzeor kombëtar më madhi në shqipëri, ruan dhe studion, provat materiale dhe jo materiale të trashëgimisë historike dhe kulturore të vendit, të cilat i paraqet e ekspozon për vizitorët. Misioni i tij është që të nxiti njohjen, edukimin dhe argëtimin nëpërmjet vlerësimit të historisë së Shqipërisë për publikun vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen shqiptare. Për këtë qëllim ai ruan dhe studion, provat materiale dhe jo materiale të trashëgimisë historike dhe kulturore të Shqipërisë. Ai organizon dhe mundëson gjithashtu aktivitetet, të cilat përkrahin vizionin dhe misionin e tij. Buxheti total i miratuar për vitin 2025 i Muzeut Historik Kombëtar është 59,580,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 21,853,000 lekë. Është bërë shpërndarja sipas zërave dhe realizimi i fondeve buxhetore përkatësisht:

Llogaria 600-601, paga dhe sigurimet shoqërore janë realizuar për periudhën raportuese në masën 18,23,000 lekë.

Llogaria 602 - mallra dhe shërbime të tjera janë realizuar për periudhën raportuese në masën 3,591,435 lekë.

Buxheti i MHK për 4- mujin e vitit 2025 është realizuar në masën 37 % në total. Gjatë kësaj periudhe MHK është në fazën e zbatimit të planit të rikonstruksioni, për një periudhë 4-vjeçare. Ruajtja dhe siguria e godinës është shërbimi me peshën më të madhe në rreth të fondit të shpenzimeve operative 4- mujore, gjithashtu janë kryer edhe pagesat për shërbimet bazë si ujë, drita, telefon dhe shërbimin postar dhe disa aktivitete e shërbime të tjera.

Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar është 44 .

Gjatë periudhës 4-mujore 2025, janë realizuar 20-aktivitete me tematika të ndryshme të cilat janë kryer jashtë Muzeut Historik Kombëtar si dhe ekspozita lëvizëse duke ekspozuar objekte të historisë të vendit tonë në disa qytete. Nga këto 12 aktivitete janë organizuar vetëm nga Muzeu Historik Kombëtar dhe 8 aktivitete të organizuara po nga Muzeu por në bashkëpunim me të tretë.

Art. 605/606:

- Pagesa për anëtarësimin e Muzeut Historik Kombëtar, në ICOM Albania (300 Euro=30,510 lekë).
- Me shkresën nr.2503/3, datë 28.03.2025 është çelur plani i fondit të veçantë për vitin 2025 ku janë përfshirë daljet në pension dhe ndihma për fatkeqësi në familjet e punonjësve në vlerën 173,200 lekë.

Me shkresën nr.2503/3, datë 28.03.2025 “Akordim i fondit të veçantë” është akorduar fondi për daljen në pension të dy punonjësve dhe ndihma për fatkeqësi në familjet e punonjësve në vlerën 173,200 lekë.

Në muajin Mars 2025 nga Ministria është hequr fondi i parashikuar për shpenzimet nga të ardhurat zëri 602/5 në vlerën 3.200.000 lekë pasi Muzeu historik Kombëtar nuk realizon të ardhura për shkak të zbatimit të projektit “Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Muzealizimi i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë”.

MUZEU KOMBËTAR I ARTIT MESJETAR është institucion i specializuar me detyrë themelore, studimin, kërkimin, konceptimin, projektimin, mbikqyrjen, konservimin, restaurimin, promovimin, publikimin, konsulencën dhe bashkëpunimin me subjekte private, shqiptare dhe të huaja, në fushën e

ikonografisë. Buxheti total i miratuar për vitin 2025 i Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar është 20,104,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 6,904,640 lekë ose 34%. Është bërë shpërndarja sipas zërave dhe realizimi i fondeve buxhetore përkatësisht:

Llogaria 600- paga, celur në masën 12,700,000 dhe janë realizuar për periudhën raportuese në masën 4,730,880 lekë.

Llogaria 601- sigurimet shoqërore, celur në masën 2,130,000 lekë dhe janë realizuar për periudhën raportuese në masën 786,690 lekë.

Llogaria 602 - mallra dhe shërbime të tjera, celur në masën 4,200,000 lekë dhe janë realizuar për periudhën raportuese në masën 1,386,300 lekë.

Llogaria 602/5 - mallra dhe shërbime të tjera nga të ardhurat, celur në masën 1,000,000 lekë dhe nuk është realizuar për periudhën raportuese në masën 1,386,300 lekë.

Llogaria 606- transferata për buxhetet familiare dhe individët, celur në masën 74,000 lekë dhe është realizuar për periudhën raportuese në masën 750 lekë.

Referuar Art. 602, MKAM ka realizuar për periudhën raportuese Janar-Prill:

Restaurimi në vepra arti-3

Program edukimi mbi kulturen- 11

Ekspozita dhe aktivitete kulturore-2

Fotografim, dizifektim dhe plotesim i database me cilesi bashkekohore-168

Pjesmarres në projekte dhe bashkepunime (AADF “Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë” Projekti “ACT4PRESPA” i cili financohet nga BE)- 2

Gjatë kësaj periudhe të tre muzetë (MKAM, Muzeu i Arsimit dhe Muzeu Arkeologjik) kanë rritur dukshëm numrin e vizitorëve për periudhën 4 mujore janë vizituar nga 7733 vizitorë duke bërë që të ardhurat të rriten dhe të arrijnë shumën 12,417,700 lekë.

MUZEU KOMBËTAR I PAVARËSISË është institucion shtetëror buxhetor në varësi të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Misioni i tij është ruajtja, mbrojtja, hulumtimi, administrimi dhe ekspozimi i trashëgimisë kulturore. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë organizon prej vitesh, aktivitete edukimi përmes kulturës dhe aktivitete mbi ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Këto aktivitete synojnë në edukimin e brezit të ri dhe komunitetit për njohjen, promovimin, ekspozimin dhe ruajtjen e trashëgimisë tonë kulturore materiale dhe jo-materiale. Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 6,456,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 2,088,000 lekë. Numri i punonjësve në organikë është 3 punonjës. Programi “Muze të mirëmbajtura dhe të vizitueshme nga publiku” për vitin 2025 përbëhet nga një produkt, i cili është në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuara, për ruajtjen dhe rritjen e vizitueshërisë. Për vitin 2025 është bërë shpërndarja sipas zërave dhe realizimi i fondeve buxhetore përkatësisht:

Llogaria 600-paga, celur në masën 4,000,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 1,447,000 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 670,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 237,000 lekë.

Llogaria 602 - mallra dhe shërbime, celur 1,200,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 341,000 lekë.

Llogaria 602, kap. V - celur 500,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Gjate 4-mujorit të parë janë organizuar 6 aktivitete.

Referuar shpenzimeve kapitale për periudhën 4 mujore Janar-Prill 2025, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë nuk ka fonde për shpenzime kapitale.

Për 4 mujorin e vitit 2025, MKP ka realizuar të ardhura nga shitja e biletave në masën 351,000, ku 105,450 janë pjesë e institucionit dhe 246,050 pjesë e buxhetit.

MUZEU KOMBËTAR I PËRGJIMEVE “SHTËPIA ME GJETHE” është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore që mbart ky institucion, si dhe pritjen e vizitorëve, me qëllim njohjen dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi të kaluarën komuniste.

Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 16,015,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 3,784,017 lekë. Për vitin 2025, referuar alokimit të buxhetit fillestar, si dhe ndryshimeve të bëra gjatë periudhës, është bërë shpërndarja sipas zërave përkatësisht:

Llogaria 600-paga, celur në masën 7,500,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 2,375,000 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 1,250,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 397,000 lekë.

Llogaria 602-mallra dhe shërbime nga Buxheti, celur në masën 3,960,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 950,000 lekë.

Llogaria 602/5- Mallra dhe shërbime nga të Ardhurat, celur në masën 1,800,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0 lekë.

Llogaria 604- të tjera transfertë korrente të brendshme, celur në masën 1,316,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0 lekë.

Llogaria 605- transfertë korrente të huaja, celur në masën 65,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 54,000 lekë.

Llogaria 606- transfertë për buxhetet familjare dhe individët celur në masën 124,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 6,000 lekë.

Gjatë kësaj periudhe 4 mujore muzeu ka pasur 15,232 vizitorë dhe 8,023,370.00 lekë të ardhura. Muzeu organizoi 2 projekte të shtrira në kohë gjatë gjithë vitit shkollor me nxënës të shkollave 9 vjecare dhe gjimnazeve të quajtura “Mbresa” dhe “Kujtojmë për të mos harruar”.

MUZEU KOMBËTAR I FOTOGRAFISË “MARUBI” është institucion shtetëror buxhetor në varësi të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Misioni i tij është ruajtja, mbrojtja, hulumtimi, administrimi dhe ekspozimi i trashëgimisë kulturore. Muzeu është fokusuar në përmbushjen e objektivave për promovimin e trashëgimisë vizuale shqiptare dhe ndërkombëtare përmes ekspozitave, projekteve edukative dhe programeve publike, me qëllim angazhimin e publikut dhe ndërgjegjësimin mbi vlerat historike dhe artistike të fotografisë. Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 23,389,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 7,541,786 lekë.

Për vitin 2025, referuar alokimit të buxhetit fillestar, si dhe ndryshimeve të bëra gjatë periudhës, është bërë shpërndarja sipas zërave përkatësisht:

Llogaria 600-paga, celur në masën 13,500,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 533,860 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 2,260,000lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 899,520 lekë.

Llogaria 602-mallra dhe shërbime nga Buxheti, celur në masën 4,996,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 727,110 lekë.

Llogaria 602/5- Mallra dhe shërbime nga të Ardhurat, celur në masën 1,500,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Llogaria 604- të tjera transfertë korrente të brendshme, celur në masën 2,000,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 577,100 lekë.

Llogaria 606- transfertë për buxhetet familjare dhe individët celur në masën 129,000 lekë dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Gjatë periudhës 4-mujore, muzeu ka pritur 3,067 vizitorë dhe ka realizuar të ardhura në masën 1,136,610 lekë.

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar këto aktivitete:

1. Punëtorja: *Eksplorimi i botës vizuale të Gregory Creëdon*
2. Ekspozita: *Dinastia Marubi* – në Galerinë e Arteve, Tiranë
3. Ekspozita: *Venus!* – në Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi”
4. Bisedë publike: *Geg Marubi, Idilet e fundit* – Galeria e Arteve, Tiranë
5. Bisedë publike: *Tenda e takimit të një oborri* – Galeria e Arteve, Tiranë

QENDRA MUZEORE KRUIJË me përbërje Muzeun Kombëtar Skënderbeu dhe Muzeun Kombëtar Etnografik (QMK) është institucion shtetëror i ngarkuar me funksionin dhe misionin për transmetimin e vlerave historike dhe kulturore, vlerave të trashëgimisë nëpërmjet pritjes së vizitoreve në muze. Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 21,804,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 7,161,703 lekë.

Llogaria 600-paga, celur në masën 11,200,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 4,323,540 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 1,880,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 702,676 lekë.

Llogaria 602-mallra dhe shërbime nga Buxheti, celur në masën 3,800,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 2,135,487 lekë.

Llogaria 604- të tjera transfertë korrente të brendshme, celur në masën 124,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0 lekë.

Numri i punonjësve të institucionit është 11. Referuar art. 602 QMK ka përdorur fondin për të mbuluar shpenzime administrative ku përfshihen pagesa utilitare, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë, karburant, taksa vendore.

Referuar shpenzimeve kapitale për periudhën 4 mujore Janar-Prill 2025, QMK nuk ka fonde për shpenzime kapitale.

Gjatë periudhës Janar-Prill, QMK ka zhvilluar aktivitete si më poshtë:

- Aktivitet në kuadër të 557-vjetorit të vdekjes së Skenderbeut
- Aktivitet në kuadër të 581- vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës
- Dhënie titulli ‘Qytetar Nderi i Krujës’ për pesë artistë që kanë vepra në Muzeun Skënderbeu
- Edukimi nëpërmjet Kulturës

QENDRA MUZEORE BERAT është institucion shtetëror buxhetor në varësi të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Misioni i saj është ruajtja, mbrojtja, hulumtimi, administrimi dhe ekspozimi i trashëgimisë kulturore në Muzeun Ikonografik Onufri dhe Muzeun Etnografik Berat. QMB organizon aktivitete edukimi përmes kulturës dhe aktivitete mbi ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Këto aktivitete synojnë edukimin e brezit të ri dhe komunitetit për njohjen, promovimin, ekspozimin dhe ruajtjen e trashëgimisë tonë kulturore materiale dhe jo materiale. Buxheti fillestar i alokuar për vitin 2025 është në masën 25,624,000 lekë. Gjatë kësaj periudhe, institucioni ka patur rialokim fondesh në llogarinë 602/5 për mbulimin e shpenzimeve për ruajtje dhe sigurinë e objekteve dhe në llogarinë 606 duke e cuar buxhetin e rishikuar në masën 28,904,805 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 9,141,000 lekë. Numri faktik i punonjësve në organikë është 10 punonjës.

Llogaria 600-paga, celur në masën 10,800,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 3,998,665 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 1,800,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 659,580 lekë.

Llogaria 602/1-mallra dhe shërbime nga buxheti, celur në masën 13,000,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 4,477,948.00 lekë.

Llogaria 602/5-mallra dhe shërbime nga të ardhurat, celur në masën 3,200,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Llogaria 606- transferta për buxhete familiare dhe individë, pas rialokimeve celur në masën 104,850 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 4,800.00 lekë.

Për periudhën 4 mujore Janar- Prill 2025, QMB nuk ka fonde për shpenzime kapitale.

Për periudhën 4 mujore Janar- Prill 2025, QMB ka realizuar të ardhura nga shitja e biletave si më poshtë:

Të ardhura totale 2,625,730 lekë, nga të cilat 787,719 lekë janë pjesa e institucionit dhe 1,838,011 lekë pjesë e buxhetit. Limiti i përdorimit të të ardhurave nga ana e institucionit është 6,200,000 leke.

Për 4 mujorin Janar-Prill 2025 janë organizuar aktivitete “Për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore” dhe aktivitete të cilat konsistojnë në aktivitete të edukimit përmes kulturës dhe trashëgimisë si më poshtë:

- Aktivitete edukimi që konsistojnë në 6 projekte dhe 2 ekspozita
- Projekti Atelier në Trashëgiminë Kulturore
- Projektit Artizanati dhe Brezi i Ri
- Loja “Mos u nxeh”
- Projekti “Muzeu ne Puzzle”
- Projekti “Etnografi i Vogël”
- Projekti “Konservuesit e Vegjël”
- Aktivitete për promovimin e muzeut në kuadër të 18 Prillit
- 10 Aktivitete në bashkëpunim me institucionet arsimore

QENDRA MUZEORE DURRËS është institucion shtetëror buxhetor në varësi të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Misioni i saj është ruajtja, mbrojtja, hulumtimi, administrimi dhe ekspozimi i trashëgimisë kulturore në Muzeun Arkeologjik Durrës dhe Parkun Arkeologjik Durrës.

QMD organizon prej vitesh, aktivitete edukimi përmes kulturës dhe aktivitete mbi ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, Këto aktivitete synojnë në edukimin e brezit të ri dhe komunitetit për njohjen, promovimin, ekspozimin dhe ruajtjen e trashëgimisë tonë kulturore materiale dhe jo materiale.

Aktiviteti i QMD zhvillohet sipas programit Nr.1, Grup 12, Kapitull 001, kod programi 8220, kod projekti 91202AC.

Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 30,554,000 lekë. Gjatë kësaj periudhe, institucioni ka patur rialokim fondesh në llogarinë 606 duke e cuar buxhetin e rishikuar në masën 30,610,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 8,824,000 lekë. Numri faktik i punonjësve në organikë është 15 punonjës.

Llogaria 600-paga, celur në masën 16,300,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 5,118,00 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 2,730,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 849,375 lekë.

Llogaria 602/1-mallra dhe shërbime nga buxheti, celur në masën 5,500,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 2,840,986 lekë.

Llogaria 602/5-mallra dhe shërbime nga të ardhurat, celur në masën 6,000,000 lekë

Për periudhën vjetore 2025, QMD nuk ka fonde për shpenzime kapitale.

Për periudhën 4-mujore Janar-Prill 2025 janë organizuar aktivitete 4 aktivitete “Për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore” dhe 11 aktivitete, të cilat konsistojnë në aktivitete të edukimit përmes kulturës dhe trashëgimisë.

Aktivitete edukimi

- Aktivitet edukimi- këshillim kariere

- Aktivitet edukimi- pjesa e dytë e programit të edukimit me nxënësit e IT të shkollës profesionale Beqir Çela.
- Aktivitet edukimi informal
- Aktivitet edukimi në kuadrin e projektit Fast Forëard
- Aktivitet edukimi informal në Torrën Veneciane dhe Amfiteatër
- Aktivitet edukimi në bashkëpunim me Durrësi Aktiv dhe Muzeh Lab
- Aktivitete edukimi në total 4, në kuadrin e ekspozitës “Artizani i dritës”, për didaktikën e ekspozitës
- Aktivitet edukimi në kuadrin e Festivalit Kombëtar të Këngës Franceze për të rinj

Aktivitete promovimi të Trashëgimisë Kulturore:

- Promovim i librit “Epistolate” të prof Përparim Kabo
- Halil Myrto- emër i çmuar për trashëgiminë tonë arkeologjike
- Artizani i dritës- Gjurmë në kohë përmes lentes së Esat Hafizit. Ekspozitë me foto, video dhe instalacion mbi krijimtarinë e mjeshtrit të fotografisë
- Art Explora: bashkëpunim dhe ekspozim në kuadrin e ekspozitës të dy amforave të arkeologjisë nënujore të gjetura në Durrës dhe të administruara nga QMD

Z.A.K.P.A APOLONI DHE BYLIS është institucion shtetëror buxhetor në varësi të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për trashëgiminë kulturore dhe ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje sipas akteve ligjore dhe neligjore. Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 35,284,000 lekë. Gjatë kësaj periudhe, institucioni ka patur rialokim fondesh në llogarinë 606 duke e çuar buxhetin e rishikuar në masën 35,334,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 11,237,927 lekë. Numri faktik i punonjësve në organikë është 14 punonjës dhe numri i punonjësve me kontratë të përkohshme është 6 punonjës.

Llogaria 600-paga, celur në masën 8,900,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 5,266,356 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 1,100,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 875,874 lekë.

Llogaria 602/1-mallra dhe shërbime nga buxheti, celur në masën 8,000,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 3,948,697 lekë.

Llogaria 602/5-mallra dhe shërbime nga të ardhurat, celur në masën 11,500,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 1,147,000 lekë.

Për periudhën vjetore 2025, Z.A.K.P.A Apoloni dhe Bylis nuk ka fonde për shpenzime kapitale.

Për periudhën Janar-Prill 2025, Z.A.K.P.A Apoloni dhe Bylis ka organizuar aktivitete të shumta me qëllim “Ruajtjen dhe provovimin e vlerave të trashëgimisë tonë kulturore” si edhe aktivitete të cilat synojnë edukimin përmes kulturës dhe trashëgimisë.

Aktivitete të Z.A.K.P.A Apoloni dhe Bylis për periudhën Janar-Prill 2025:

- Muzeu në Valixhe
- Arkeologu i vogël
- Ciceroni i vogël
- Preke Trashëgiminë
- Apolonia në një libërth
- Skico monumentin
- Gjej thesarin
- Aktivitete edukuese me institucionet arsimore

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ent publik me statusin e personit juridik

që financohet nga buxheti i shtetit. IKTK është pjesë e Programit të Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë të Programit 08220, pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 335,311,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 31,071,782 lekë. Numri faktik i punonjësve në organikë është 58 punonjës.

Llogaria 600-paga, celur në masën 62,000,000lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 21,775,476 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 10,400,000lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 3,597,210lekë.

Llogaria 602-mallra dhe shërbime nga buxheti, celur në masën 20,000,000lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 4,721,696 lekë.

Llogaria 605-transferta të jashtme, celur në masën 303,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0 lekë.

Llogaria 606-transferta për buxhet familjar dhe individët, celur në masën 48,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Llogaria 231-kapitale të trupëzuara, celur në masën 242,500,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 977,400 lekë të ndara në shpenzime për investime në masën 928,530 lekë dhe garanci punimesh në masën 48,870 lekë.

Referuar art. 231, për periudhën Janar-Prill 2025 IKTK ka kryer “Ndërhyrje emergjente në pasuri kulturore” në masën 977,400 lekë.

Aktiviteti i IKTK-së gjatë periudhës raportuese Janar-Prill 2025

Hartim projekti- 16

Relacionet përmbledhëse për çdo aplikim të depozituar pranë IKTK-së. Prezantime në kuadër të mbledhjeve të organizuara për Këshillin Teknik dhe Këshillin Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale- 166

Shqyrtim i aplikimeve për pajisje me licenca individuale për person fizik/juridik për ndërhyrje në pasuritë kulturore materiale dhe veprimatrinë arkeologjike- 6

Mbikeqyrja dhe kolaudimi i punimeve të restaurimit- 16

Shqyrtim dhe Vërtetim në lidhje me kërkesat e individëve apo subjekteve mbi statusin e pasurive kulturore materiale- 6

Verifikim interesi kulturor- 3

Shërbim Arkivi Teknike (kërkesa nga Institucionet e Trashëgimisë dhe të tjerë)- 47

Arkivim pranë Arkivit Teknik i dosjeve të projekteve- 15

Arkivim pranë Arkivit Teknik i dosje supervizime/ kolaudime- 2

Skanim i dosjeve per procesin e Digjitalizimit të Arkivit Teknik- 281

Skanimi i filmave/negative per procesin e digjitalizimit te Arkivit teknik- 20

Verifikim në terren- 18

Ndjekje e gjetjeve rastësore- 6

Mbikeqyrje arkeologjike në terren- 20

Konferenca EAA - European Association of Archaeologists- 1

Rregjistrim i dokumentacionit, te marrë nga aplikimet nëpërmjet sistemit on-line i detajuar edhe sipas aplikanteve, shoqeri/individ të licensuar në arkeologji- 79

Pjesëmarrje e punonjesve në Trajnim ndërkombëtar për Trashëgiminë Kulturore- 1

Konferenca 2 ditore për arkeologjinë nënujore në bashkëpunim me ICUA Zadar, UNESCO - 2

Akt-marrëveshje të lidhura në kuadër të Monitorimit Arkeologjik nga IKTK- 16

Abonime ne programin Autocad- 15

Shqyrtimi dhe dhenia e konsulences teknike per PMI ne fushen e Trashegimise Kulturore- 1

Hartimi i FISH-projekteve per PBA 2026-2028- 16

Hartim Dokumente Standarte Teknike per investimet 2025- 2

Shqyrtimi dhe realizimi i projekteve ne kuader te Mareveshjes me AZHBR per programin IPARD-III- 2

INSTITUTI KOMBËTAR I RREGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE është një institucion i specializuar shkencor kombëtar, në varësinë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Në zbatim të ligjit, IKRTK është institucioni përgjegjës për menaxhimin e kësaj databaze në të cilën regjistrohen të gjithë pasuritë kulturore materiale/jomateriale të Republikës së Shqipërisë.

Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 14,284,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 4,747,139 lekë. Numri faktik i punonjësve në organikë është 15 punonjës.

Llogaria 600-paga, celur në masën 10,000,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 4,025,000 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 1,670,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 650,132 lekë.

Llogaria 602-mallra dhe shërbime nga buxheti, celur në masën 2,500,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 46,903 lekë.

Llogaria 605-transferta korente të huaja, celur në masën 40,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 24,528 lekë.

Llogaria 606-transferta për buxhetet familjare dhe individët, celur në masën 74,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0,000 lekë.

Për periudhën janar- prill 2025, janë kryer procedurat e përditësimit në Bazën e të Dhënave Shtetërore “*Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)*”, për 6942, si vijon:

- Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” – 3300 objekte;
- Muzeu Historik Mat – 758 objekte;
- Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”- 1322 objekte;
- Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë- 305 objekte;
- Muzeu Kombëtar “Onufri” – 196 objekte;
- Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë- 121 objekte;
- Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë – 940 objekte.

Për periudhën Janar-Prill 2025, janë kryer procedurat e regjistrimit/përditësimit në RKPK të Transaksione/Leje për 275 objekte.

Për 4 mujorin e parë të vitit 2025 (janar-prill) në portalin e-albania kanë kryer procedurën e aplikimit në shërbimin “*Aplikim për regjistrim, si dhe Aplikim për leje zhvendosje të veprave të artit*” 59 qytetarë për 216 vepra.

IKRTK ka ndjekur procesin e digjitalizimit të objekteve pasuri kulturore, pranë Njesisë së Digjitalizimit të Trashëgimisë Kulturore (EXPA), në zbatim të urdhërave të ministrit. Numri total i objekteve që janë digjitalizuar për periudhën e katër mujorit të parë të vitit 2025 është 145 objekte.

Aktivitete të IKRTK për periudhën Janar-Prill 2025:

- *Lufta kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore në Ballkanin Perëndimor*
- *Underëater archaeology and digital heritage training*

QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE FOLKLORIKE është institucioni i vetëm shtetëror që merret me veprimtaritë kombëtare në fushën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. QKVT synon promovimin dhe ekspozimin e kulturës tonë kombëtare dhe vlerave të saj të patjetërsueshme jomateriale. Buxheti i alokuar për vitin 2025 është në masën 14,144,000 lekë. Gjatë kësaj periudhe, institucioni ka patur rialokim fondesh në llogarinë 606 duke e cuar buxhetin e rishikuar në masën 14,194,000 lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese është 4,289,888 lekë. Numri faktik i punonjësve në organikë është 6+1 punonjës.

Llogaria 600-paga, celur në masën 6,700,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 2,743,798 lekë.

Llogaria 601-sigurimet, celur në masën 1,120,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 457,886 lekë.

Llogaria 602-mallra dhe shërbime nga buxheti, celur në masën 2,000,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 128,354 lekë.

Llogaria 604-transferta të brendshme, celur në masën 4,300,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 959,850 lekë.

Llogaria 606-transferta për buxhetet familjare dhe individët, pas rialokimit celur në masën 74,000 lekë, dhe realizuar për periudhën raportuese në masën 0 lekë.

Referuar aktiviteteve të zhvilluara për periudhën raportuese Janar-Prill 2025, QKVT ka kryer 2 nga 7 aktivitete të planifikuara përgjatë vitit si më poshtë:

- 1- *Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit "Një tufë proverbash", një botim anastatik i folkloristit Sotir Kolea*
- 2- *Panairi i Punës, Athinë*

Për realizimin e festivaleve u përdorën fonde nga llogaria 602 dhe llogaria 604.

- Projekte e investimeve me financim të brendshëm

Gjatë periudhës raportuese janë planifikuar 272,500,000 lekë për një sërë projektsh restauruese, rikonstruktive dhe studimore në fushën e trashëgimisë kulturore. Nga këto fonde, është kryer një angazhim në masën 25,053,746 lekë, ndërsa realizimi faktik ka qenë shumë i ulët, në vetëm 977,400 lekë, që përfaqëson një realizim prej 1%. Gjatë periudhës raportuese, pavarësisht alokimit të fondeve dhe hartimit të projekteve për investime kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore dhe infrastrukturës institucionale, realizimi financiar ka rezultuar minimal. Kjo situatë është kryesisht pasojë e një sërë faktorësh objektivë. Së pari, një pjesë e konsiderueshme e projekteve ndodhen në fazën përgatitore, ku janë në proces hartimi dokumentacionet tekniko-ligjore dhe po zhvillohen procedurat të prokurimit. Gjithashtu, për projektet e trashëgimisë kulturore, nevoja për miratime nga institucione specializuese ka zgjatur afatet e fillimit të ndërhyrjeve. Për këtë arsye, pavarësisht fondeve të alokuara dhe angazhimeve të pjesshme, pagesat faktike nuk janë realizuar deri në këtë fazë. Në muajt në vijim parashikohet përsheptimi i procedurave dhe nisja e disbursimeve në përputhje me zbatimin fizik të projekteve.

- Në shpenzimet kapitale me financim të huaj ishte parashikuar për realizim një projekt por nuk pati realizim.


Programi i Arti dhe Kultura (Programi 08230)

Programi "Arti dhe Kultura" është një nga programet e Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet të cilit zbatohen politikat e programit qeverisës, për evidentimin, promovimin, mbrojtjen, forcimin e vlerave kulturore Kombëtare dhe mbikëqyr format e realizimit të tyre sipas parametrave të përcaktuara në politikë si dhe bazuar në dokumentet strategjike të sektorit. Programi dikton dhe zhvillon politika në mbrojtje të krijimtarisë dhe industrive krijuese, skenës së pavarur, respektimit e genderit, të të drejtave të njeriut, në mbështetje të grupeve të marginalizuara dhe diversitetit kulturor në rang vendi. Ky program, zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën, si dhe Institucioneve në varësi të saj.

Në këtë program janë alokuar fonde për 9 institucione, si dhe Aparatit të MEKI: Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar, Galeria Kombëtare e Arteve, Biblioteka Kombëtare, Cirkull Kombëtar, Qendra Kulturore për Fëmijë, Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahi vogli", Qendra Kombëtare e Librit, Arkivi Shtetëror Shqiptar i Filmit.

Figura më poshtë paraqet një analizë të shpenzimeve korrente/kapitale plan dhe fakt 4 mujori /2025. Buxheti për FH është bere aktiv ne sistem ne muajin maj 2025.

Figura 10 Programi i Arti dhe Kultura (Programi 08230)



Programi “Arti dhe Kultura” ka për qëllim, edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenës artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka si objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike”. Realizimi i këtij objektivi gjatë 4 M 2024 është realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave paraqitet si më poshtë:

- 71 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorik kombëtar (186 mln lekë);
- 59 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit teatror klasik dhe bashkëkohor (43.77 mln lekë);
- 38 aktivitete për qytetarët përdorues e frekuentues të koleksioneve bibliotekare (45.47 mln lekë).
- 5 projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur (48.17 mln lekë),
- 46 veprimtari artistike në zhanrin e cirkut dhe eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike bashkëkohore (19.66 mln lekë).
- 82 veprimtari edukuese të teatrit me dhe për fëmijë (17.7 mln lekë),
- 147 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit teatror eksperimental klasik/bashkëkohor (12.92 mln lekë);
- 2 ekspozita me vepra pjesë e fondit të GKA, të përkohshme të traditës dhe bashkëkohore, autorë të diasporës dhe të huaj (12.99 milion lekë),
- 1 aktivitete me fokus promovimin e krijimtarisë letrare (8.8 mln lekë).
- 54 veprimtari promovuese të materialeve filmike, pjesë e fondit të kinematografisë shqiptare dhe asaj të huaj (7.29 mln lekë),
- 24 aktivitete në kuadër të javët kulturore të huaja në Shqipëri me (0.5 mln lekë),

Treguesit e performancës:

Rritje e treguesve të programeve mbështetëse, të aktiviteteve kulturore dhe punësimit të artistëve duke respektuar barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut. Arti dhe Kultura orientohet drejt programeve strategjike dhe kreative në art-kulturë e në veçanti mbështet Programin “Edukimi përmes Kulturës;

1. Rritja e aktiviteteve artistike:

- Programet kulturore ndërkombëtare në mbështetje edhe të Diasporës shqiptare.

- Mbështetja e skenës e pavarur artistike në vend
- Mbështetja e krijimtarisë letrare
- Mbështetja e krijimtarisë muzikore/skenike elitare
- Mbështetja e fondit teatrore, me fokus evidentimin e artistëve të rinj në këtë zhanër
- Pasurimi i kalendarëve të posaçëm artistik, në funksion të sezonit turistik veror në rang kombëtar. Nëpërmjet këtyre treguesve synohet të matet ndikimi i politikave të artit dhe kulturës në përmirësimin e jetës social kulturore, nxitjes së krijimtarisë artistike që në moshë të herët dhe reduktimin e fenomeneve negative tek të rinjtë, përmes programeve të edukimit kulturor. Treguesi është kumulativ nga viti 2023 dhe duhet të ketë trend rritës.

2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit strategjik dhe fiskal të institucioneve artistike:

- Krijimi i hapësirave të reja dhe mekanizmave transparente për financimin e subjekteve që veprojnë në fushat e artit, letërsisë dhe kulturës;
- Rritja e prurjeve artistike, aksesit, përmirësimit të kushteve infrastrukturore si dhe promovimit të vlerave kulturore;
- Intensifikimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për zgjerimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve kulturore. Matja e këtyre treguesve bazohet në numrin e aplikimeve/projekteve dhe bashkëpunimeve kulturore Brenda dhe jashtë vendit të mbështetura, të cilat trajtohen nëpërmjet skemave të financimit nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, program “Arti dhe Kultura”. Treguesi është kumulativ nga viti bazë 2023 dhe duhet të ketë trend rritës.

3. Investime Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore:

Ngritja e standarteve infrastrukturore dhe përmirësimit të shërbimit ndaj publikut. Krijimi i hapësirave të reja përformuese, skenike përmes investimeve dhe ndërtimeve të reja sipas modeleve më të mira të skenave bashkëkohore, ndërkombëtare. Rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi. Investimet kulturore synojnë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetës social -kulturore.

4. Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës:

Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike. Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike. Pasurimi i kalendarëve artistikë dhe shtrirja gjeografike në të gjithë territorin e RSH. Treguesi është kumulativ nga viti bazë 2023 dhe duhet të ketë trend rritës.

5. Veprimtari të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë, (aparati):

Mbështetja e skenës e pavarur artistike në vend përmes thirrjes vjetore si dhe projekteve të brendshme prioritare MEKI. Projekte të brendshme të realizuara nga DPAK.

Në kuadër të “Monitorimit të 4-mujorit të parë të vitit, përkatësisht periudhës janar-prill 2025”, Drejtoria e Politikave për Artin dhe Kulturën, ka administruar projektet si më poshtë vijon:

Projektet e realizuara si vijon:

Titulli i projektit/programit: Shfaqja artistike “Magjia e Skenës Fierake”, në kuadër të 85 vjetorit të lindjes së regjisorit Pëllumb Kulla

- Organizatori: Znj. Brunilda Belaj

- Vendi: Ambientetet e Teatrit Bylis në Fier,
- Data e realizimit: 16 Prill 2025
- Mbështetje financiare nga MEKI: 800,000 lekë, nga zëri 604, programi “art-kulturë”, për vitin buxhetor 2025
- Përshkrim i shkurtër narrative: Realizimi i aktivitetit/shfaqjes artistike, titulluar “Magjia e Skenës Fierake”, më datë 16 prill 2025, synoi promovimin dhe mirënjohjen e një prej artistëve më të spikatur të artit skenik shqiptar z. Pëllumb Kulla, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin e teatrit shqiptar, veçanërisht Teatrit të Bylisit, nëpërmjet organizimit të një shfaqje sa më të veçantë me qëllim dhe nxjerrjen në pah të botimit të kolanës shtatë vëllimëshe të artistit, në kuadër dhe të 85 vjetorit të lindjes së tij, ku të pranishëm ishin figura të shquara të artit shqiptar

- Titulli i Projektit/Programit: Konkursi i Parë Ndërkombëtar për Pianistët e Rinj me temë “J’adore Chopin”
- Organizatori: Shoqata “Frederik Shopen”, Vendi: Pranë ambienteve të TKOBAP
- Data e realizimit: 01 - 06 mars 2025
- Mbështetje financiare nga MEKI: 210,000 Lekë, nga fondet e buxhetit të miratuara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për vitin 2025, zëri 604
- Përshkrim i shkurtër narrative: Ky projekt u zhvillua në kuadër të 215 Vjetorit të lindjes së kompozitorit Frederik Shopen, si dhe 30 vjetorit të krijimit të shoqatës me emrin e tij, Shoqata “Frederik Shopen”, e cila organizoi për herë të parë në vendin tonë, Konkursin Ndërkombëtar për Pianistët e Rinj me temë “J’adore Chopin”. Konkursi Ndërkombëtar për Pianistët e Rinj me temë “J’adore Chopin”, kishte për qëllim përhapjen e krijimtarisë pianistike shqiptare tek të gjithë konkurentët, kryesisht tek artistëve të rinj, duke e veshur me një stil kulturor European nëpërmjet figurës së qytetarit të botës *Frederik Chopin*. Ky konkurs i adresohet fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë, si edhe atyre të Diasporës të cilët kishin interes kryesor të tyre formimin kulturor, mësimin e të luajturit në pianos të cilët aspirojnë për një karrierë pianistike. Në përfundim të konkursit pjesëmarrësit u vlerësuan me disa çmime.

Pakti për Universitetin

Pakti për Universitetin, në vitin 2019 u zhvillua për herë të parë me qëllimin e plotësimit të angazhimeve të identifikuar gjatë procesit të dialogut mes studentëve, institucioneve arsimore dhe qendrore dhe për të krijuar zgjidhje më të mira brenda fokusit të fushës së veprimit të palëve, i cili solli progres në fushën e artit dhe kulturës duke promovuar kapacitetet e reja krijuese dhe artistike.

Në zbatim të marrëveshjes kuadër të bashkëpunimit mes ish Ministrisë së Kulturës, sot Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Universitetit të Arteve, datë 08.05.2019, me nr. 3018 prot, për Implementimin e Dokumentit "Pakti për Studentin", procesi që vijon me 8 nën-marrëveshjet sektoriale si më poshtë:

- Galerinë Kombëtare të Arteve;
- Teatrin Kombëtar;
- Teatrin Kombëtar Eksperimental Kujtim Spahivogli;
- Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë Teatri i Kukullave,
- Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit;
- Teatri Kombëtar i Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor;
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

- Qendra Kombëtare e Kinematografisë (përditësim i përvitshëm)

Për sa më sipër referuar 4 mujorit të parë të vitit 2025 janë realizuar disa aktivitete nga institucionet e varësisë, në të cilin janë angazhuar studentë, sipas treguesve të mëposhtëm:

Nr.	Institucion i	Nr. i projekteve aktiviteteve, shfaqjeve, punësimeve, etj.	Nr. i studentëve të angazhuar	Femër	Mashkull
1	TKOBAP	5	16	12	4
2	QKK	0	0		0
3	TKEKS	2	3	2	1
4	TK	0	0		0
5	GKA	0	0		0
6	QKKFTK	0	0		0
7	AQSHF	0	0		0
8	IKRTK	0	0		0
TOTALI		7	19	14	5

Përfaqësime në programe dhe evenimente ndërkombëtare/Diplomacia Kulturore:

Përfaqësimi i produktit artistik elitare në arenën ndërkombëtare, si dhe lëvizshmëria e artistëve shqiptarë dhe anasjelltas, përmes institucioneve qendrore të artit dhe kulturës në vend, përmes marrëveshjeve kulturore ndërkombëtare si dhe artistëve shqiptar që jetojnë në Diasporë. Treguesi është kumulativ nga viti bazë 2023 dhe duhet të ketë trend rritës.

- Titulli i projektit/programit: Pjesëmarrja e balerinit Ergi Imeraj, në “Young America Grand (PRIX)”- Ensuring the Future of Dance, në Tampa, Florida, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përgjatë datave 18-28 prill 2025”.
- Organizatori: Youth America Grand Prix (YAGP), në Tampa, Florida
- Vendi: Tampa - Florida, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- Data e realizimit: 18 deri më 28 Prill 2025
- Mbështetje financiare nga MEKI: 500.000 lekë, nga zëri 604, programi “art-kulturë”, për vitin buxhetor 2025
- Përshkrim i shkurtër narrative:Pjesëmarrja e artistit Ergi Imeraj në konkursin e kërcimit ”YAGP” në Tampa, Florida përgjatë qëndrimit të tij nga data 21 deri më 27 Prill 2025, përfshiu një gamë të gjerë aktiviteteve që u organizuan në kuadër të këtij eventi prestigjioz.

Kjo pjesëmarrje erdhi në mbështetje të edukimit kulturor dhe zhvillimit të audiencave, duke nxitur skenën e pavarur për krijimtarinë artistike brenda dhe jashtë vendit. Përgjatë pjesëmarrjes në “Young America Grand (PRIX)”-Ensuring the Future of Dance, Ergi Imeraj arriti të përfaqësojë Shqipërinë në konkursin ndërkombëtar prestigjioz të baletit klasik/kontemporan, me rezultate të kënaqshme duke promovuar një nga talentet e reja shqiptare si dhe duke hapur ura të reja bashkëpunimi në drejtim të skenës ndërkombëtare, për disiplinën e baletit klasik.

Më datë 27 prill 2025, Ergi Imeraj u bë pjesë e Awards Ceremony, ku i janë ofruar tre bursa studimi, nisur spikatja e talentit të tij dhe përkushtimi i shprehur gjatë konkurrimit:

1. *Canada’s National Ballet School (Summer Program Scholarship);*
2. *Zurich Dance Academy (Short term Scholarship);*
3. *European School Of Ballet (Full Year Admission).*

- Titulli i Projektit/Programit: “Javët Kulturore Ndërkombëtare 2025”, edicioni IV-të

- Organizatori: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (organizatori kryesorë dhe kordinatori i programit), në bashkëpunim me Ambasadat e huaja në Shqipëri, si dhe Bashkitë në vend Botë.
- Vendi: Përgjatë të gjithë territorit të Shqipërisë
- Data e realizimit: 1 Prill – Dhjetor 2025
- Mbështetje financiare nga MEKI: Fondi i shpenzuar për projektin ‘Javët Kulturore Ndërkombëtare’ për periudhën janar-prill 2025 është në vlerën 20,878,687 lekë, mbuluar nga fondet e miratuara të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me kod 91203 AL, “Javët Kulturore të Huaja në Shqipëri”, programi Art-Kulturë, sipas PBA 2025-2027.
- Përshkrim i shkurtër narrative: Nisma “Javët Kulturore Ndërkombëtare” në Shqipëri, për vitin 2025, u rikthye me edicionin e saj të katërt, duke sjellë një program dinamik dhe gjithëpërfshirës nga shtetet pjesëmarrëse. Kjo nismë, e cila ka fituar një vend të veçantë në kalendarin kulturor të vendit, pati një impakt të dukshëm tek publiku, falë atmosferës së jashtëzakonshme dhe mesazheve të fuqishme për paqen dhe pranimin e ndërsjellë që u përcollën gjatë aktivitetit. Ashtu si në edicionet e mëparshme, “Javët Kulturore Ndërkombëtare” shërbyen si një platformë e shkëlqyer për njohje, bashkëpunim dhe shkëmbim mes artistëve vendas dhe të huaj, duke kontribuar ndjeshëm në pasurimin e jetës kulturore, jo vetëm në kryeqytet, por në të gjithë Shqipërinë.

Për sa i përket draft kalendarit të JKN-së, përgjatë periudhës janar-prill të realizuara deri më tani të shteteve pjesëmarrëse në projektin “Javët Kulturore Ndërkombëtare 2025” janë si më poshtë:

1. Polonia 14-19 Prill
2. Republika e Maqedonisë së Veriut 23-30 Prill

Referuar shërbimeve të nevojshme në kuadër të realizimit të projektit “Javët Kulturore Ndërkombëtare 2025”, janë angazhuar si më poshtë vijon:

- Subjekti ‘PIK shpk’ për reazliimin e zërit “Brandim/kreativ, promocion dhe marketing”, në kuadër të realizimit të aktiviteteve të “JKN 2025”, i cili referuar kontratës respective është likuiduar në vlerën 60%, (paradhënie).
- Staf i shtesë, i cili do të merret me organizimin, komunikimin, takimet, realizimin e aktiviteteve, menaxhimin e grupeve, ndjekjen e kontratave, preventivave të aktiviteteve, buxhetimin dhe monitorimin e tyre, etj, janë:
 1. Znj. Brisilda Trojka, Koorditore,
 2. Znj. Ledina Jakimi, As/Koorditore
 3. Z. Arbër Xhaferaj, As/Koordinator
 4. Znj. Suela Laska, As/Koorditore

Për periudhën janar-prill 2025 është likuiduar 50% e kontratave të stafit të sipërcituar.

Fondi i shpenzuar për periudhën janar-prill 2025 është në vlerën 20,878,687 lekë

- Titulli i Projektit/Programit: “Ditët Shqiptare në Botë - CulturAlb 2025”, edicioni I-rë
- Organizatori: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (organizatori kryesorë dhe kordinatori i programit), në bashkëpunim me MEPJ dhe Ambasadat Shqiptare në Botë.
- Vendi: Përgjatë 10 Shteteve në Botë. (Itali / Greqi / Francë / Zvicër / Gjermani / Izrael / Amerikë / Spanjë / Angli / Poloni)
- Data e realizimit: Prill – Tetor 2025

- Mbështetje financiare nga MEKI: Fondi i shpenzuar për projektin ‘Ditët Shqiptare në Botë – CulturAlb, edicioni i I-rë’ për periudhën janar-prill 2025 është në vlerën 6,410,400 lekë dhe 20,000 euro, mbuluar nga fondet e miratuara të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me kod 91203 AL, “Javët Kulturore të Huaja në Shqipëri”, programi Art-Kulturë, sipas PBA 2025-2027.
- Përshkrim i shkurtër narrative:Projekti "Ditët Shqiptare në Botë" konsiderohet një zgjerim natyror i “Javëve Kulturore Ndërkombëtare”, duke e çuar më tej misionin e shkëmbimit kulturor. Në kuadër të përpjekjeve për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe forcimin e marrëdhënieve me vende të tjera, “Ditët Shqiptare në Botë” pasqyrojnë angazhimin për të zgjeruar dhe përforcuar lidhjet kulturore dhe diplomatike, ky model i shkëmbimit kulturor shndërrohet në një strategji të jashtme, ku Shqipëria jo vetëm promovon, historinë e saj, gjuhën, traditat, artin, muzikën, kulinarinë dhe arritjet bashkëkohore duke krijuar dhe konceptuar një qasje më moderne, gjithmonë në ruajtje të trashëgimisë dhe vlerave shqiptare, por edhe krijon mundësi konkrete për artistët shqiptarë që të performojnë dhe të bashkëpunojnë në skenën ndërkombëtare. Ky angazhim rrit ndërgjegjësimin për kulturën dhe identitetin shqiptar në botë, por gjithashtu e pozicionon Shqipërinë si një destinacion kulturor tërheqës. Si rezultat, kjo iniciativë ndikon pozitivisht në zhvillimin e turizmit kulturor, duke tërhequr vizitorë të huaj dhe duke forcuar imazhin e vendit si një qendër dinamike arti dhe tradite. Implementimi i këtij projekti në vendet/shtetet e sipërcitura, aktivitetet do të realizohen në një hapësirë kohore prej 2 javësh maksimumi, ku do të shtrihet programi i secilit vend.Për sa i përket draft kalendarit të CulturAlb-së, përgjatë periudhës janar-prill të realizuara deri më tani të shteteve pjesëmarrëse në projektin “Ditët Shqiptare në Botë-CulturAlb” janë si më poshtë:

1. Itali 07-24 Prill

Referuar shërbimeve të nevojshme në kuadër të realizimit të projektit “CulturAlb 2025”, janë angazhuar si më poshtë vijon:

- Subjekti ‘KUBE Studios shpk’ për reazliimin e zërit “Shërbime Kreative, Zhvillimi dhe Menaxhimi”, në kuadër të realizimit të aktiviteteve të “CulturAlb 2025”, i cili referuar kontratës respective është likuiduar në vlerën 60%, (paradhënie).
- Stafi shtesë, i cili do të merret me organizimin, komunikimin, takimet, realizimin e aktiviteteve, menaxhimin e grupeve, ndjekjen e kontratave, preventivave të aktiviteteve, buxhetimin dhe monitorimin e tyre.

Për periudhën janar-prill 2025 është likuiduar 50% e kontratave të stafit të sipërcituar.

Fondi i shpenzuar për periudhën janar-prill 2025 është në vlerën 6,410,400 lekë dhe 20,000 euro.

- Titulli i Projektit/Programit: Edicioni i 20-të i Bienales së Artistëve të Rinj nga Evropa dhe Mesdheu
- Organizatori: Rrjeti i “Bienales së Artistëve të Rinj nga Evropa dhe Mesdheu” BJCEM
- Vendi: Nova Gorica, Slloveni
- Data e realizimit: 30 maj – 03 qershor 2025
- Mbështetje financiare nga MEKI: Përgjate periudhës janar –prill nuk është shpenzuar një fond në kuadër të projektit në fjalë
- Përshkrim i shkurtër narrative: Përgjatë periudhës janar-prill, DPAK ka vijuar procedurat administrative në kuadër të pjesëmarrjes së dy artistëve shqiptarë të përzgjedur nga Komisioni/juria e përbërë nga ekspertë të fushës e ngritur nga organizatoret e BJCEM, referuar aplikimit në thirrjen publike, në kuadër të Edicionit të 20-të të Bienales së Artistëve të Rinj

nga Evropa dhe Mesdheu, titulluar “Pa kufij”, me kuratorë Tia Cicek dhe Misal Adnan Yildiz. Ky event është një ngjarje ndërkombëtare multidisiplinare, që do të zhvillohet në Nova Gorica, Kryeqyteti Evropian i Kulturës, nga ku pritet të bashkojë rreth 100 artistë euro-mesdhetar. Dy artistët përfaqësues të vendit tonë të vlerësuar janë: Znj. Redina Qose, e cila do të prezantohet me një video art (multimedia) titulluar “*Ku do të shkojnë dallëndyshet?*” dhe Z. Armando Ducellari, i cili do të prezantohet me një video art (multimedia) titulluar “*Vizatimi i vijave përmes pasaportës sime*”. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në cilësinë e një prej anëtarëve të rrjetit BJCEM, do të mbështesë pjesëmarrjen e dy artistëve shqiptarë të përzgjedhur në Edicionin e 20-të të Bienales së Artistëve të Rinj nga Evropa dhe Mesdheu, 2025si me poshte:

- Pagësen e një fee si shpërblim artistik në vlerën 250 euro për secilin artist përfaqësues të vendit të tyre.
 - Udhëtimin e artistit nga vendbanimi i tij në Nova Gorica – Gorica e anasjelltas.
- Titulli i Projektit/Programit: Pagesa e tarifës së anëtarësimit në rrjetin e “Bienales së Artistëve të Rinj nga Evropa dhe Mesdheu” për vitin 2025
 - Organizatori: Rrjeti i “Bienales së Artistëve të Rinj nga Evropa dhe Mesdheu” BJCEM
 - Vendi: Itali
 - Data e realizimit: Mars 2025
 - Mbështetje financiare nga MEKI: 2.480,00 Euro (pa përfshirë transaksionet bankare), nga fondet e buxhetit të miratuara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për vitin 2025, zëri 605.
 - Përshkrim i shkurtër narrative: Falë anëtarësimit në rrjetin BJCEM, Shqipëria ndër vite ka qenë pjesëmarrëse në aktivitete të rëndësishme kulturore, ku edhe është përfaqësuar denjësisht, të cilat promovojnë artin dhe kulturën duke nxitur respektin dhe mirëkuptimin për diversitetin, përmes zbulimit të vlerave të kulturave të ndryshme. Projektet dhe aktivitetet e kësaj organizate ofrojnë trajnime, lëvizshmëri dhe mundësi shkëmbimi që, nga ana tjetër, mbështesin proceset krijuese të artistëve, përmes rritjes personale dhe profesionale.
- Titulli i Projektit/Programit: Shkodra Elektronike në Eurovision Song Contest 2025
 - Organizatori: Kolë Laca / (Eurovision Song Contest)
- Vendi: Basel, në Zvicër,
- Data e realizimit: 02 - 17 Maj
 - Mbështetje financiare nga MEKI: Aktualisht përgjatë periudhës prill është likujduar vlera e 60% të kontratës 1,980,000 Lekë, nga fondet e buxhetit të miratuara nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për vitin 2025, zëri 604.
 - Përshkrim i shkurtër narrative: Në kuadër të zhvillimit të edicionit të 69-të, të Festivalit Ndërkombëtar të Këngëve, “*Eurovision Song Contest*”, i cili është një ndër festivalet më të mëdha dhe të njohur të muzikës, që organizohet çdo vit nga Radio dhe Televizioni Evropian (EBU), për të promovuar unitetin kulturor dhe muzikor. Ky event i rëndësishëm ndërkombëtar për vitin 2025 u zhvillua në datat 2 - 17 Maj, në qytetin Basel, në Zvicër, në të cilin Shqipëria u përfaqësua nga grupi muzikor “Shkodra Elektronike” i krijuar nga kantautori-producenti Kolë Laca dhe kantautorja Beatrice Gjergji. Me interpretimin e tyre unik dhe të veçantë, i cili kombinon elemente të muzikës elektronike, pop dhe muzikës tradicionale shqiptare, u përfaqësua Shqipëria në mënyrë dinjitoze me këngën e titulluar “Zjerrm”, e cila paraqiti një kombinim mes motiveve tradicionale dhe muzikës elektronike, si një produkt muzikor i

ndërthurur me modernen dhe elemente të identitetit kulturor shqiptar. Gjithashtu ky projekt kishte për qëllim promovimin e artistëve shqiptarë dhe rrymave të reja muzikore në skenën ndërkombëtare, si një mënyrë për rritjen e njohjes dhe vlerësimin e kulturës shqiptare dhe artistëve të rinj për të eksperimentuar me identitetin e tyre artistik. Grupet e synuara i përkasin kryesisht grupeve të interesit, institucionet qendrore të art-kulturës në vend, skenës së pavarur artistike në vend, operatorëve kulturor, artistëve profesionistë shqiptar brenda dhe jashtë vendit, grupeve vunerabël, duke respektuar barazinë gjinore, etj.

Treguesit e performances

Treguesit e performancës në nivel objektiv për programin e art-kulturë janë, përkatësisht:

1. Përqindja e programeve artistike të realizuara;
2. Përqindja e nismave të ndërmara për përmirësimin e sistemit të menaxhimit strategjik dhe fiskal të institucioneve artistike;
3. Përqindja e Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore;
4. Përqindja e veprimtarive të realizuara me institucionet e art-kulturës;
5. Përqindja e veprimtarive të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë, (aparati);
6. Përqindja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimeve në programe dhe evenimente ndërkombëtare/Diplomacia Kulturore;

Treguesi i parë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e programeve artistike të realizuara, të cilat kanë krijuar hapësira krijuese në funksion të zhvillimit të artit dhe kulturës në vend që nga viti 2023, kur ka filluar edhe zbatimi i Strategjisë së Kulturës, (SKK 1019-2025). Ky tregues është kumulativ dhe duhet të ketë trend rritës. Mbështetur në këtë Strategji, synohet që deri në 2025, të jetë rritur ndikimi i politikave të artit dhe kulturës në përmirësimin e jetës social kulturore, nxitjes së krijimtarisë artistike që në moshë të herët dhe qasja/integrimi i shumë të rinjve përmes programeve të edukimit kulturor.

Treguesi i dytë i performancës në nivel objektiv mat përqindjen e numrit aplikimeve/projekteve dhe bashkëpunimeve kulturore brenda dhe jashtë vendit të mbështetura, të cilat trajtohen nëpërmjet skemave të financimit nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, program “Arti dhe Kultura”. Gjithashtu mat trendin e masave të marra për hapësirat e reja dhe mekanizmat transparente për financimin e subjekteve që veprojnë në fushat e artit, letërsisë dhe kulturës.

Treguesi i tretë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e numrit të ambienteve / godinave të rikonstruara infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësirate e reja të rikualifikuara.

Treguesi i katërt i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e trendit në përmirësimin e shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike. Mat trendin rritës të pasurimit të kalendarëve artistikë si dhe zgjerimin e shtrirjes gjeografike në të gjithë territorin e RSH.

Treguesi i pestë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen e numrit të aplikimeve të mbështetura nga thirrja vjetore si dhe numrin e projekteve të realizuara si prioritet të brendshme.

Treguesi i gjashtë i performancës në nivel objektiv, mat përqindjen përfaqësimeve ndërkombëtare të produktit artistik shqiptar elitar në arenën ndërkombëtare, përmes institucioneve qendrore të artit dhe kulturës në vend, në zbatim të marrëveshjeve kulturore ndërkombëtare si dhe artistëve shqiptar që jetojnë në Diasporë.

Barazia Gjinore

Në programin buxhetor Arti dhe Kultura, ka patur një vëmendje më të madhe në drejtim të Genderit, duke mbështetur, projekte të cilat trajtojnë barazinë gjinore, të drejtat e gruas, emancipimin e saj etj. Më konkretisht elementi gjinorë është vendosur në nivel tregues performance përkatësisht në “Rritja dhe zhvillimi i audiencave në funksion të mbrojtjes së krijimtarisë dhe cilësisë artistike duke respektuar genderin dhe të drejtat e njeriut” dhe “Mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi”.

VIZITUESHMËRIA NË SITET E TRASHËGIMISË KULTURORE GJATË MUAJIT JANAR – PRILL 2025, TË KRAHASUESHME ME MUAJT JANAR – PRILL 2022, 2023 & 2024

Në relacionin në vijim janë paraqitur dhe analizuar të dhënat statistikore të numrit të shfaqjeve, premierave, spektatorëve dhe aktiviteteve kulturore kombëtare/rajonale të organizuara nga Institucionet Qendrorë të Art-Kulturës, për muajt Janar-Prill 2025.

Analiza interpretuese

Institucionet e Art-Kulturës, gjatë muajve Janar-Prill 2025, kanë zhvilluar 426 shfaqje, 29 premiera, kanë pasur 68,700 spektatorë, si dhe kanë organizuar 264 aktiviteteve kulturore kombëtare/rajonale

Institucionet e Art-Kulturës, gjatë muajve Janar-Prill 2024, kanë zhvilluar 414 shfaqje, 28 premiera, kanë pasur 47,234 spektatorë, si dhe kanë organizuar 289 aktiviteteve kulturore kombëtare/rajonale.

Institucionet e Art-Kulturës, gjatë muajve Janar-Prill 2023, kanë zhvilluar 334 shfaqje, 39 premiera, kanë pasur 40,973 spektatorë, si dhe kanë organizuar 115 aktiviteteve kulturore kombëtare/rajonale.

Institucionet e Art-Kulturës, gjatë muajve Janar-Prill 2022, kanë zhvilluar 275 shfaqje, 35 premiera, kanë pasur 35,343 spektatorë, si dhe kanë organizuar 83 aktiviteteve kulturore kombëtare/rajonale.

Në periudhën janar–prill 2025 janë regjistruar 264 njësi aktiviteti, që ndonëse paraqet një rënie të lehtë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (289), mbetet dukshëm më e lartë në raport me vitet 2022 dhe 2023 (83 dhe 115 përkatësisht). Ky trend pasqyron një rritje të ndjeshme të aktivitetit në dy vitet e fundit, si rezultat i rritjes së kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimit në rritje për ofrimin e shërbimeve. Ulja e lehtë në vitin 2025 mund të lidhet me faktorë sezonalë apo me ngarkesën procedurale në fazën e parë të vitit, por nëse trendi mbetet i qëndrueshëm në muajt në vijim, pritet që viti të mbyllet me një nivel të krahasueshëm ose më të lartë se viti 2024.(tabela dhe grafikët krahasues më poshtë)

Tabela: Veprimtaria e Institucioneve të Art-Kulturës (Janar–Prill 2022-2025)

Treguesi	2022	2023	2024	2025
Numri i shfaqjeve të zhvilluara	275	334	414	426
Numri i premierave	35	39	28	29
Numri i spektatorëve	35,343	40,973	47,234	68,700
Aktivitete kulturore kombëtare/rajonale	83	115	289	264

Gjatë katër viteve të fundit, veprimtaria e institucioneve të Art-Kulturës ka njohur një rritje të vazhdueshme në shumicën e treguesve kryesorë. Numri i shfaqjeve të realizuara është rritur nga

275 në vitin 2022 në 426 në vitin 2025. Po ashtu, është vënë re një rritje e ndjeshme në pjesëmarrjen e spektatorëve, nga rreth 35 mijë në vitin 2022 në mbi 68 mijë në vitin 2025, çka tregon një rritje të interesit të publikut. Ndërsa numri i premierave ka shënuar luhatje nga viti në vit, pjesa tjetër e treguesve pasqyron një përmirësim të dukshëm të veprimtarisë kulturore. Numri i aktiviteteve kulturore kombëtare dhe rajonale gjithashtu ka pësuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitet e mëparshme, pavarësisht një uljeje të lehtë në vitin 2025 krahasuar me 2024.

Shpenzimet Kapitale me financim të brendshëm

Gjatë periudhës janar–prill 2025, zbatimi i projekteve të investimeve në fushën e Artit dhe Kulturës ka qenë i kufizuar, me një nivel të ulët realizimi në raport me fondet e planifikuara. Nga një total prej 1,467,500,000 lekësh të planifikuara për këtë periudhë, janë realizuar në total vetëm mbi 142 milion lekë, duke përfaqësuar një realizim të pjesshëm të fokusuar kryesisht në projekte që vijojnë nga viti paraardhës.

Konkretisht, projekti për rikonstruksionin e godinës së Teatrit të Tiranës ka arritur një realizim prej 44%, për shkak të vijimësisë së kontratës dhe progresit të punimeve. Në të kundërt, pjesa më e madhe e projekteve të tjera si: ndërtimi i Qendrës Kulturore për Fëmijë, rikonstruksioni i Teatrit Aleksandër Moisiu, blerje pajisjesh, restaurimi i muzeve apo fondet për vepra arti dhe projekte, nuk kanë pasur realizim financiar gjatë kësaj periudhe.

Arsyet kryesore të mungesës së realizimit lidhen me:

- Procesin e zgjatur të përgatitjes së dokumentacionit teknik dhe miratimeve institucionale, veçanërisht për projektet e reja;
- Afatet e prokurimeve publike, të cilat shpesh ndikohen;
- Fondet e ngrira, të cilat janë përcaktuar gjatë muajit maj për t'u çelur;
- Specifikën e lartë të projekteve të kulturës, që shpesh kërkojnë koordinim me institucione të trashëgimisë kulturore, miratim nga autoritete mbrojtëse të monumenteve dhe procese më të kujdesshme zbatimi për shkak të natyrës delikate të ndërhyrjeve.

Gjithashtu, vlen të theksohet se investimet në sektorin e kulturës kërkojnë shpesh planifikim shumëvjeçar, përgatitje të hollësishme projektimi dhe kapacitete të specializuara për zbatimin teknik, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ritmin e realizimit brenda një viti buxhetor.


- Në shpenzimet kapitale me financim të huaj ishte parashikuar për realizim një projekt por nuk pati realizim.

Programi për Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji (Programi 01150)

Programi ka si qëllim, promovimin dhe nxitjen e inovacionit në Administratën Publike dhe në Shqipëri. Objektivi i politikës së këtij programi që është organizimi dhe koordinimi i iniciativave, programeve dhe aktiviteteve në fushën e inovacionit, gjatë 4 M 2025 është realizuar nëpërmjet produktit:

- Shërbime dhe procese inovatore të zbatuara”, i cili është realizuar me një kosto faktike prej 64.29 milion lekë për 3 produkte.

Figura 11 Programi Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji (Programi 01150)



Në këtë program janë alokuar fonde për Agjencinë Inovacionit dhe Ekselencës dhe për Aparatin. Fondet e parashikuara për këtë program sipas planit janë në vlerën rreth 1.39 miliardë lekë, nga të cilat janë realizuar në vlerën e rreth 907.8 milion lekë për 4 mujorin 2025. Në përqindje është realizuar rreth 67 % e planit. Ndërkohë, realizimi i ulët mund të shpjegohet me disa faktorë, si vonesat në planifikim, vështirësitë në koordinimin e burimeve, ose pengesat që kanë lindur gjatë implementimit të aktiviteteve operationale. Këto faktorë mund të kenë ndikuar në ngadalësimin e përmbushjes së objektivave të planifikuara brenda periudhës së parashikuar.

Aparati MEKI

Në llogarinë 602 është miratuar buxheti për krijimi i Qendrës Shqiptare për Inovacion dhe Zhvillim e cila konstiton me marrjen e një ambienti me qera (Kubi) pranë Qendrës Piramida. Detyrimet vjetore që rrjedhin nga kontrata e qirasë nr. 11829/4 prot, datë 14.11.2024, ku përfshihet vlera mujore e qirasë dhe kostot e mirëmbajtës, për periudhën Janar-Prill 2025 janë në vlerën e shpenzimeve prej 960,692 lekë. Ky është një projekt që ka nisur në vitin 2024 me krijimin e Qendrës dhe do të vazhdojë dhe në vitet më pas. Me qëllim promovimin e Inovacionit, njohjen me teknologjitë e reja, vlerësimin dhe testimin e zgjidhjeve inovatore përpara aplikimit të tyre, është shumë e rëndësishme krijimi i Qendrës për Inovacion dhe Zhvillim në Shqipëri si epiqendra shqiptare dhe bërthama e orientimit për këtë sektor, ku përfshirja të do jetë publike, private dhe akademike. Kjo Qendër Inovacioni do të japë një mbështetje multifunksionale për individë dhe për kompanitë e reja inovative, të cilat do të jenë pjesë e punës së qendrës. Shërbimet që do të ofrohen nga qendra janë: Mbështetje ndërmjetësimi, networking, capacity building, ekspozim me investiturë, grante, programe akselerimi, pilotimi dhe inkubimi për produkte të caktuara etj. Me Aktin normativ nr. 3, datë 29.04.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 :Për buxhetin e vitit 2025”. Ky fond prej 1 000 milion lekësh është bërë transfertë kapitale për Korporatën e Investimeve Shqiptare me qëllim pjesëmarrjen e qeverisë shqiptare, të përfaqësuar nga Korporata e Investimeve Shqiptare në startup-in “Thinking Machines Lab”.

AGJENCIA E INOVACIONIT DHE EKSELENCËS

Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, e krijuar me VKM nr. 620, datë 1.11.2023, ka për mision të nxisë dhe të promovojë inovacionin dhe përfshirjen e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë në administratën publike, përmes zbatimit të politikave të përparuara në bashkëpunim me ministrinë e linjës. Në funksion të këtij misioni, Agjencia organizon dhe koordinon iniciativa në nivel sektorial, kombëtar dhe rajonal, si dhe ofron mbështetje për aktorët publikë dhe privatë në fushën e inovacionit. Agjencia ka përgjegjësi për:

- Zhvillimin e programeve dhe politikave inovative në bashkëpunim me institucionet publike;
- Identifikimin e teknikave dhe proceseve novatore për përmirësimin e shërbimeve publike;
- Asistimin me ekspertizë për zgjidhjen e problematikave komplekse;
- Pjesëmarrjen në përgatitjen e akteve ligjore dhe rregullatore për fushën e inovacionit;
- Propozimin dhe nxitjen e reformave për modernizimin e administratës publike.

Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës gjatë periudhës janar – prill 2025, ka alokuar fonde në masën 174.02 milionë lekë dhe ka përdorur 39.6 milionë leke që përfaqësojnë rreth 23% të planit vjetor. Realizimi i pjesshëm i fondit lidhet me fillimin e aktivitetit operativ në muajin prill dhe përfundimin e procesit të ndërtimit të strukturës gjatë prill – gushtit. Niveli i ulët i realizimit shpjegohet me vonesa në planifikim, vështirësi në koordinimin e burimeve dhe pengesa gjatë implementimit të aktiviteteve.

- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore

Në strukturën e shpenzimeve buxhetore zëri i shpenzimeve të personelit zë 95.3 % të totalit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2025.

Për periudhën janar –prill 2025 shpenzimet e personelit në raport me buxhetin e vjetor plan për këtë periudhë është realizuar në masën 22 %. Buxhet plan për këtë periudhë janë realizuar në fakt 37.812 mijë lekë, me një mosrealizim prej 22.188 mijë lekë.

Mos realizimi shpenzimeve të personelit, ka ardhur si rezultat i vakancave në strukturën e miratuar me Urdhrin nr. 34, datë 13.02.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikes se Agjencisë se Inovacionit dhe Ekselencës”. Vakanca të krijuar edhe nga ndalesat ligjore për rekrutime në prag të zgjedhjeve, bazuar në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Numri i punonjësve të Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës është plotësuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 34. datë. 13.02.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës se Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës”, me një personel prej 75 punonjësish. Institucioni ka aktualisht të emëruar 37 punonjës, dhe 38 vakanca.

- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera Operative


Në strukturën e shpenzimeve buxhetore zëri i shpenzimeve mallra dhe shërbime të tjera operative, zë 5 % të totalit të buxhetit vjetor plan për vitin 2025. Për periudhën janar –prill 2025 shpenzimet për mallrat dhe shërbimet e tjera operative janë realizuar në masën 23 % në raport me buxhetin. Ndër faktorët që kane ndikuar në këtë masë realizimi mund të përmendim menaxhimin me efikasitet të fondeve, si dhe nga vakancat në strukture gjë që reflektohet dhe në kërkesat për mallra e shërbime të ndryshme.

Programi për Mbështetje për Zhvillim Ekonomik (Programi 04130)

Ky program ka për qëllim t'i shërbejë krijimit të një klime pozitive për zhvillimin e biznesit, për krijimin e vendeve të reja të punës, reduktimit të informalitetit në ekonomi, krijimit të një mjedisi konkurrues për zhvillimin e investimeve, krijimit të kushteve të barabarta për konkurrencë si dhe një treg të sigurtë për

konsumatorin; përmirësimin e cilësisë së menaxhimit dhe performancës ekonomike të shoqërive tregtare, krijimit të një sistemi që garanton realizimin e detyrimeve kontraktore ndërmjet bizneseve. Në këtë program gjatë hedhjes së AFMIS të të dhënave, janë shfaqur probleme, duke dështuar regjistrimi i treguesve. Fondet e parashikuara për këtë program sipas planit janë në vlerën rreth 511.99 milionë lekë, nga të cilat janë realizuar në vlerën e rreth 118.66 milionë. Në përqindje është realizuar rreth 23 % e planit.

Figura 12 Programi për Mbështetje për Zhvillim Ekonomik (Programi 04130)



Në këtë program janë të përfshira 3 institucione.

- AAparati MEKI

Në këtë program është i përfshirë edhe Aparati MEKI me një projekt “TVSH për projekte me financim te huaj” dhe financimit te huaj. Gjithashtu ka edhe te detajuar fonde ne 602.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe Mënyrën e Funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve” ka për qëllim të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit.

Informacioni buxhetor i agreguar

AIDA, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga 2(dy) burime:
Buxheti i Shtetit në masën 264,221,000 lekë, ku përkatësisht në masën 227,221,000 lekë për shpenzime korrente lidhur me objektin e veprimtarisë së AIDA-s, konkretisht:

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;
- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Shpenzime kapitale për investime 37,000,000 lekë.

Fondet në fjalë gjatë periudhës raportuese kanë pësuar këto shtesa:
Performanca e AIDA-s gjatë periudhës raportuese Janar – Prill 2025

Gjatë periudhës Janar – Prill 2025, AIDA ka shënuar rritje në nivel performance, si në aktivitetet përfaqësuese me palë të treta, ashtu edhe në përkrahjen e investitorëve vendas dhe të huaj.

a) Performanca e produktit: *“Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit”.*

Gjatë periudhës Janar – Prill 2025, AIDA ka realizuar aktivitete në kuadër të zbatimit të objektivave dhe funksioneve të veta, si më poshtë:

- Pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare.

Në kuadër të promovimit të kompanive shqiptare në tregjet e huaja dhe me synim nxitjen e eksportit, AIDA ka marrë pjesë me stende në disa panaire ndërkombëtare:

- **“Biofach 2025”, datat 11-14 Shkurt 2025, Nuremberg, Gjermani.**

Në këtë panair morrën pjesë 8 kompani, 6 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 2 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 467 kontakte me kompani të huaja.

- **“Wine Paris”, në datat 10-12 shkurt 2025, Paris, Francë.**

Në këtë panair morën pjesë 3 kompani të sektorit të verës. Kompanitë realizuan 20 kontakte me kompani të huaja.

- **“Food Expo”, në datat 8-10 mars 2025, në Athinë.**

Në këtë panair morën pjesë 6 kompani, 2 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 3 kompani nga sektori i verës dhe një kompani e kafes. Kompanitë realizuan 209 kontakte me kompani të huaja.

Në kuadër të nxitjes së investimeve të huaja, zhvillimin e potencialeve turistike në vend dhe promovimin e Shqipërisë, AIDA ka marrë pjesë me stande, në disa panaire ndërkombëtare:

- **“ITB Berlin”, në datat 4-6 mars 2025, Berlin, Gjermani**

Më këtë panair, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, mori pjesë si bashkë-ekspozuese krahas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. ITB Berlin (Internationale Tourismus-Börse Berlin) është panairi më i madh i turizmit në botë, i cili tërheq shumë ekspozues dhe pjesëmarrës dhe mbetet një platformë kyç për rrjetëzimin, inovacionin dhe turizmin global. Gjithashtu luan një rol jetik në formësimin e trendeve, politikave dhe partneriteteve në sektorin e turizmit. Kompanitë e përfaqësuara në panair përfshijnë hotele, struktura akomoduese, operatorë turistikë, linja ajrore etj. Shqipëria në këtë panair kishte vendin e nderit si Host Country dhe AIDA mernte pjesë në rolin e institucionit përgjegjës për tërheqjen e IHD-ve në sektorin e turizmit si një ndër sektorët prioritarë dhe strategjikë në zhvillimin e vendit. Përmes pjesëmarrjes synohej dhe prezantimi i paketave më të reja incentivuese në sektor. Gjithashtu dhe koordinimi i takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet dhe mbështetja e kompanive shqiptare për takimet e planifikuara.

- **“Panairi i Punës”, në datën 2 mars 2025, Athinë, Greqi.**

Në këtë datë, AIDA mori pjesë në Panairin “Puno & Jeto Aty Ku Ke Zembrën”, i cili u mbajt në Athinë, Greqi. Panairi kishte si qëllim informimin dhe ofrimin e mundësive të reja për punësim, investim dhe kthimin në Shqipëri të shqiptareve që jetojnë dhe punojnë në Greqi, për të kontribuar në zhvillimin e vendit.

Synimi i pjesëmarrjes në këtë panair ishte tërheqja e investimeve nga diaspora dhe informimi mbi mundësitë për zhvillimin e biznesit në Shqipëri.

Në panair morën pjesë kompani të ndryshme shqiptare që operojnë në fusha të ndryshme si bujqësi, ndërtim, turizëm dhe teknologji, etj. Përpos subjekteve private, pjesë e panairit ishin dhe institucionet shtetërore si: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Albanian Investment Corporation (AIC), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), etj.

• **“Panairi i MIPIM”, në datat 11-14 mars 2025, Kanë, Francë.**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në përmbushje të funksionit të saj si institucioni kyç për tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh, mori pjesë në panairin MIPIM 2025, gjatë datave 11 – 14 Mars 2025. MIPIM (Marché International des Professionnels de l'Immobilier) event i madh dhe më prestigjioz në botë për industrinë e real estate, i cili mbahet çdo vit në qytetin e Kanës, Francë.

AIDA zhvilloi një sërë takimesh me investitorë dhe operatorë ndërkombëtarë të sektorit, duke shkëmbyer informacione mbi potencialet dhe avantazhet konkurruese të Shqipërisë.

Gjatë panairit, AIDA nënshkroi një Marrëveshje me Miami Association of Realtors, shoqata më e madhe e profesionistëve të pasurive të paluajtshme në SHBA.

Evente

- **“Match Maker Albania 2024” me fokus nxitjen e investimeve**

Në muajin Mars 2025, për herë të parë, AIDA organizoi eventin Match Maker Albania, një nga ngjarjet më të rëndësishme për nxitjen e investimeve dhe bashkëpunimit ekonomik në Shqipëri. Kjo platformë unike synon të lidhë investitorë të huaj me mundësi konkrete në tregun shqiptar, duke ofruar hapësira për takime direkte B2B (biznes me biznes) dhe B2G (biznes me qeveri).

Fakte kryesore të eventit:

- Të pranishëm përfaqësues nga 37 shtete, duke reflektuar interesin e gjerë ndërkombëtar.
- Mbi 500 investitorë të huaj morën pjesë për të eksploruar mundësitë që ofron Shqipëria.
- Event i mbledhur me shumë se 1000 pjesëmarrës, përfshirë sipërmarrës, diplomatë, përfaqësues institucionesh dhe media.
- U prezantuan 30 kompani eksportuese shqiptare, të cilat ofruan partneritete të mundshme për tregjet ndërkombëtare.
- 30 projekte konkrete investimi, kryesisht në sektorin e turizmit dhe real estate.
- 10 institucione publike dhe mbështetëse ishin të pranishme me info desk për të ofruar informacion dhe asistencë për investitorët.

- **“Zan’Art” me fokus nxitjen e bizneseve kreative**

Eventi “Zan’Art”, u mbajt në datën 30 prill 2025, në Tiranë.

Qëllimi kryesor i eventit “Zan’Art” ishte të promovojë trashëgiminë kulturore përmes artizanatit dhe të krijojë mundësi konkrete për rritjen e vizibilitetit dhe shitjeve të produkteve artizanale. Ky event kishte për qëllim jo vetëm promovimin por ndërveprimin me target grupe të interesuara për produktet e tyre duke menduar zgjerimin e tregjeve. Nga ana tjetër, në këtë event u organizuan tavolina diskutimit/panelet me aktoreve të sektorit dhe institucioneve shtetërore për të adresuar sfidat e artizanatit në Shqipëri dhe planet strategjike. Një mundësi kjo unike promovimi, ndërveprimi dhe diskutimi.

Ky event lindi si një nevojë për të ofruar një hapësirë të dedikuar, ku artizanët tanë mundën të prezantojnë produktet e tyre autentike, ku arritën të ndërveprojnë me publikun dhe aktorë të tjerë të tregut, si dhe mundësinë për krijimin e partneriteteve të reja për zhvillimin e mëtejshëm të

aktiviteteve të tyre. Zan'Art krijon një urë të gjallë ndërmjet brezave, duke i rikthyer artizanatit shqiptar vendin që meriton në shoqëri – jo thjesht si mjeshtëri, por si një formë e gjallë e trashëgimisë kulturore. Ky event shërbeu si një pedestal për duar-artët, ata që me pasion dhe durim ruajnë dhe përcjellin vlerat tona kombëtare. Çdo qepje, gdhendje, thurje apo ngjyrosje mbart një histori – një frymë të hershme që flet për identitetin tonë, për rrënjët dhe shpirtin e këtij vendi. Zan'Art ishte një thirrje për ta vlerësuar të bukurën e krijuar me dorë, për të dëgjuar zërin e heshtur të zanateve dhe për të rindërtuar lidhjen emocionale me atë që është autentike, e thellë dhe e trashëguar.

Eventi Zan'Art krijon një hapësirë të dedikuar për promovimin dhe fuqizimin e artizanëve shqiptarë, duke i vendosur ata në qendër të vëmendjes si bartës të trashëgimisë sonë kulturore. Përmes këtij aktiviteti arritëm të rrisim ndërgjegjësimin publik mbi vlerat e artizanatit tradicional, nxitjen e blerjeve direkte dhe krijimin e mundësive të reja ekonomike për artizanët pjesëmarrës. Gjithashtu, Zan'Art kishte si synim ruajtjen dhe transmetimin e mjeshtërisë tradicionale tek brezat e rinj, duke i kthyer këto profesione në mundësi të qëndrueshme punësimi, përmes workshopeve dhe demonstrimeve të shfaqura gjatë gjithë eventit.

Në këtë event ishte i pranishëm Titullari i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përfaqësues nga Ministria e Turizmit, Ministria e Bujqësisë, Kryetarja e Unioinit të Dhomave të Tregëtisë, përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, përfaqësues nga Bashkitë e qyteteve me trashëgimi kulturore, përfaqësues të institucioneve kulturore si, Muze, Akademi Artesh. Aktiviteti u organizua në formën e një panairi të mirëfilltë, ku ekspozuan produktet e tyre rreth 35 biznese artizane, të sektorëve të kostumeve popullore, drurit, qeramikës, poçerisë, xhamit, pikturës, maskave artizanale, qëndisjes, bizhuterisë etj.

Ky aktivitet pati fokus ndërgjegjësimin e bizneseve që kanë në fokus artizanët, dyqane që tregtojnë produktet e artizanatit, struktura elitare akomoduese, partnerët dhe mbështetësit e këtij sektori, përfaqësuesit e tregjeve ndërkombëtare, përfshirë shpërndarësit, retailer-at, dhe organizatat ndërkombëtare, institucionet mbështetëse, si dhomat e tregtisë, ambasadat, dhe organizatat zhvillimore.

Përkujdesja ndaj investitorëve (Takime aftercare)

Përgjatë periudhës Janar – Prill 2025 janë organizuar 10 takime aftercare. 7 prej tyre janë në kuadër të fushatës në sektorin e ICT/BPO, e cila ka vijuar edhe në muajin Maj. Ndërsa 3 kompanitë e tjera i përkasin sektorit të manifakturës.

Nxitja dhe tërheqja e Investimeve të Huaja Direkte (Forume biznesi)

Përgjatë periudhës Janar – Prill 2025, Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit ka organizuar Forumin e Biznesit Shqipëri – Francë dhe Forumin e Biznesit Shqipëri – Egjipt.

- Forumi i Biznesit Shqipëri – Egjipt u organizua në muajin Shkurt dhe qëllimi ishte identifikimi dhe krijimi i mundësive për bashkëpunim ekonomik të ndërsjelltë me kompanitë shqiptare në sektorë si pasuria e paluajtshme, energjia e rinovueshme dhe prodhimi e distribucioni i pajisjeve laboratorike, mjekësore e më gjerë.
- Në muajin Mars, AIDA, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Shqipëri, organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri-Francë, me pjesëmarrjen e një delegacioni të rëndësishëm nga MEDEF International.

Gjatë forumit u prezantuan potencialet e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve dhe roli i Shqipërisë si një destinacion atraktiv për investime, në sektorë si pasuria e paluajtshme, aktivitetet financiare, ndërtimi etj.

Projekte të vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë periudhës raportuese për vitin 2025

Me hyrjen në fuqi të paketës ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përshpejtuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS)
- Agjent asistues i investitorit strategjik

Misionet e mësipërme realizoheshin nga Sektori One Stop Shop brenda Drejtorisë së Investimeve, por duke qenë se puna para dhe pas vlerësimit të një projekti investimi është masive, lindi nevoja për krijimin e Drejtorisë së Investimeve Strategjike, e krijuar rishtazi me miratimin e strukturës së re të AIDA, e cila përbëhet nga 2 sektorë:

- Sektori i One Stop Shop
- Sektori i Monitorimit

Në këtë aspekt, Drejtoria e Investimeve Strategjike:

- kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjikë (pra dy statuse të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planin kombëtar të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucioneve njëkohësisht);
- koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.
- monitoron zbatimin e planit të veprimit të Vendimeve të KIS nga ana e subjekteve dhe institucioneve.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndër-institucional shumë funksional. Ligji i investimeve strategjike nr.55/2015, i ndryshuar, ka shtyrë afatin e aplikimeve deri në 31.12.2026.

Në katër mujorin e parë të vitit 2025 rezulton se:

- Kërkesat e ardhura nga subjektet të cilat janë në fazë asistimi pranë AIDA për vitin 2025 janë 16 projekte në total. Këto projekte përfshijnë projekte të ardhura në fund të vitit të kaluar dhe këtë fillim viti. Aktualisht, subjektet janë takuar në mënyrë periodike nga stafi i AIDA duke u asistuar mbi procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës që duhet të dorëzohet.

- Projekte të aplikuara për përfshirjen në procedura administrative të legjislacionit të investimeve strategjike me qëllim përfitim statusi strategjik, të cilat janë në proces vlerësimi janë 3 projekte në total.
- Numri i projekteve të miratuara me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) në tre muajt e fundit janë 3 projekte në total.

VITI	2025
Projekte në fazë vlerësimi nga grupi operacional	3
Projekte të miratuara nga KIS	3
Projekte të refuzuara	0
Projekte në fazë asistimi	16
Total	22

- Lidhur me monitorimin e projekteve:

Aktualisht, vazhdon procesi i komunikimeve me subjektet të cilat kërkojnë asistencë lidhur me zbatimin e vendimeve të KIS. Ndërkohë ka filluar puna për ndjekjen e zbatimit të Planit të Veprimit të KIS nga subjektet dhe janë përgatitur shkresat për monitorimit e tyre. Këto shkresa do ti drejtohen 13 subjekteve të cilat kanë përfituar statusin investim/investor strategjik.

b) Performanca e produktit “Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” (shpenzime korrente) dhe 2 (dy) projekteve të financimit: “Fondi i Konkureshmërisë” dhe “Fondi i Ekonomisë Kreative” (shpenzimeve kapitale).

AIDA për vitin 2025, po menaxhon Fondin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” i cili synon rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

Vlera totale e këtij fondi e vënë në dispozicion për NVM-të ka qenë në masën 131,830,000 lekë. AIDA ka publikuar në faqen e saj zyrtare, thirrjen për “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, për vitin 2025. Thirrja për aplikime qëndroi e hapur për 30 ditë kalendarike, nga data 30 janar 2025 deri me datë 28 shkurt 2025. Gjithsej aplikuan 443 subjekte.

Skema 1

- Fondi i Shpenzimeve Korrente

Aplikime në total 250 dosje, nga të cilat: Dosje me mangësi 79; Dosje të plota 171 të vlerësuara nga bordi vlerësimeve; Dosje fituese 57 nga të cilat 25 subjekte fituese janë femra (44%).

Skema 2

- Fondi Artizanatit (Biznesi Kreativ). Aplikime në total 19 dosje, nga të cilat: Dosje me mangësi 6; Dosje të plota 13 të vlerësuara nga bordi vlerësimeve; Dosje fituese 10 nga të cilat 7 subjekte fituese janë femra (70%).

- Fondi i Konkurrueshmërisë. Aplikime në total 174 dosje, nga të cilat: Dosje me mangësi 54; Dosje të plota 120 të vlersuara nga bordi vlerësimeve; Dosje fituese 19 nga të cilat 6 subjekte fituese janë femra (32%).

Aktualisht kemi përfunduar disbursimin e kështit të I, për skemën 2 dhe jemi në process lidhje marrëveshjes me subjektet e shpallura fituese për Skemën 1.

c) Përformanca e projektit “Përmirësim sistemesh”, nga zëri shpenzime kapitale (llogaria 231). Fondi në dispozicion prej 1,170,000 lekë për projektin “Përmirësim sistemesh”, nuk ka mundur të hidhet në regjistrin për prokurim publik në vitin 2025 pasi ky zë lidhet me mirëmbajtjen e sistemit të Regjistrit të Investimeve Strategjike, i cili nuk u finalizua vitin e kaluar. Me shkresë nr.320, datë 17.02.2025 “Kërkesë për ndryshim destinacioni të fondit të akorduar për projektin me financim të brendshëm ‘Përmirësim sistemesh’, pjesë e programit ekonomik ‘Mbështetje për zhvillim ekonomik’”, kemi kërkuar ndryshim destinacioni të këtij fondi. Konkretisht u kërkuua alokimi i fondit prej 1,170,000 lekë për projektin “Blerje pajisje zyre AIDA”. Kjo kërkesë erdhi në kuadër të riskstrukturimit të AIDA-s, proces i cili u shoqërua me shtesë stafi me rreth 12 punonjës të rinj. Kërkesa jonë u miratua nga MEKI (me shkresën me nr. 2772/3, datë 08.04.2025) fondit ju ndryshua destinacioni. Në vijim, kemi nisur procedurën për shtimin e zërit në regjistrin e prokurimeve publike të AIDA-s për vitin 2025 dhe ndjekjen e procedurës të prokurimit të fondit prej 1,170,000 lekë me TVSH sipas sasive dhe specifikimeve të kërkuara nga AIDA.

d) Përformanca e projektit me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro”, “EEN Albania” dhe projekti “TVSH për projekte me financim të huaj” nga zëri shpenzime kapitale (llogaria 231).

✓ **Projektet me financim të huaj.**

Përsa i përket projekteve me financim të huaj për periudhën raportuese Janar – Prill 2025, sqarojmë si më poshtë:

- Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtim “Skills for jobs Albania - Montenegro” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 u parashikuar financimi 1,300,000 lekë. Ndërkohë fondet e shpenzuara për këtë projekt për periudhën raportuese janë në masën 372,250 lekë. Projekti në fjalë është mbyllur dhe pritët konfirmimi nga donatori.
- Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtim “EEN Albania” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 janë parashikuar financim 4,000,000 lekë. Ndërkohë fondet e disbursuara nga donatori janë në masën 1,791,231.45 lekë. Gjatë periudhës raportuese nuk është kryer ende asnjë pagesë lidhur me aktivitetet e kryera nga ky projekt, pasi kalimi i fondeve në llogarinë e thesarit të AIDA-s është mundësuar në fund të muajit prill 2025.

✓ **TVSH për projekte me financim të huaj**

Në zbatim të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projektit me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro”, gjatë periudhës raportuese është kompensuar nga projekti “TVSH për projekte me financim të huaj” detyrimi lindur për pagesë fature me vlerë të TVSH-s në masën **16,250 lekë**, pra nga plani për këtë zë prej 4,000,000 lekë, realizimi ishte i ulët nga fakti se aktivitetet referuar projektit me financim të huaj në fjalë nuk gjeneruar fatura me TVSH për të sjellë nevojë për kompensim nga ky fond.

Performanca e treguesve me bazë gjinore, në nivel produkti

Objekti i veprimtarisë të AIDA-s, në buxhetin e akorduar për mbështetje me grante për vitin 2025, konkretisht produkti jo projekt “Grante për mbështetjen e bizneseve” dhe në produktet të ndarë në 2(dy) projekte, ka parashikuar trajtime me bazë gjinore. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes të subjekteve përfituese të granteve, nga analiza e kryer nga Drejtoria e Projekteve, NVM dhe Eksporteve, rezulton se nga 86 përfitues të dy skemave të mbështetjes me grante për vitin 2025, 57 prej tyre kanë drejtuese femër. Ndërkohë pjesa tjetër e aktiviteteve që zhvillon AIDA në rolin e promovueses të Shqipërisë si destinacion për investime, lidhet me targetimin dhe asistencën që ofrohet për investitorët vendas dhe të huaj, praktikë e cila nuk bën diferencim me bazë gjinore.

4. Përformanca e buxhetit në nivel programi - AIDA

Gjatë periudhës raportuese, ecuria (performanca) e realizimit të shpenzimeve korrente dhe kapitale sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas burimeve të financimit, ka patur këtë rezultat:

- **Shpenzime për paga (artikulli 600):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 25% të fondit të miratuar për vitin 2025. Ky nivel realizimi vjen si pasojë e mos plotësimit të strukturës së re të miratuar në nëntor të vitit 2024 për AIDA-n. Shkak ka qenë mungesa e logjistikës akomoduese për stafin e ri (mos akordim fonde për investime), si dhe pezullimin me VKM të shpalljeve zyrtare të pozicioneve vakante për gjithë administratën publike nga data 3 Mars 2025 deri në 11 Maj 2025, në kuadër të mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare në Republikën e Shqipërisë.
- **Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore (artikulli 601):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 30% të fondit të miratuar për vitin 2025.
- **Shpenzime për mallra dhe Shërbime të Tjera (artikulli 602):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 47% të fondit të rishikuar për vitin 2025. Përpos nevojave dhe prokurimeve përkatëse, në këtë zë janë realizuar shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca dhe panaire, realizimin e aktiviteteve dhe të tjera në përputhje me veprimtarinë dhe fokusin e agjencisë.
- **Grante për mbështetje të bizneseve (artikulli 604):** Realizimi i këtij zëri është 0 (zero) pasi lidhet me procesin e disbursimit të granteve i cili aktualisht gjendet në fazën e shpalljes të listës të subjekteve fituese nga procesi i konkurimit, hapur gjatë muajit janar – shkurt 2025. Me finalizimin e lidhjes së marrëveshjeve me subjektet fituese dhe lëshimin e faturave elektronike të kështit të parë nga këta subjekte, do nisi procesi i disbursimit të granteve që përkon me realizimin e këtij zëri.
- **Transferta për Buxhetet Familjare & Individ (artikulli 606):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 9% të fondit të rishikuar për vitin 2025. Aktualisht nga ky fond janë kryer pagesa që lidhen me kompensimin e shpenzimeve të telefonis celulare për Drejtorin Ekzekutiv. AIDA nuk ka patur raste për shpërbllim nga Fondi i Veçantë gjatë kësaj periudhe raportimi.
- **Shpenzimet kapitale në artikullin 231:**
 - I. Me financim të brendshëm: Fondet e parashikuara për këtë artikull janë të ndara në:
 - 2 (dy) projektet e financimit për mbështetjen e NMVM-ve për projekte kapitale për mbështetjen me grante për fuqizimin e NVMV-ve. Fondet e parashikuara për këto projekte është realizuar në masën 15%. Gjatë periudhës raportuese është arritur disbursimi i kështit të parë të granteve nga këto projekte për një pjesë të mirë të subjekteve të shpallur fitues. Por finalizimi i pagesave është mbyllur në muajin Maj 2025.

- *Investimin e brendshëm në masën 1,170,000 lekë, e cila u kanalizua gjatë muajit prill 2025 për zërin “Blerje pajisje zyre AIDA” është në proces prokurimi, ndaj realizimi i këtij zëri është 0%.*
- *Tvsh për projektet me financim të huaj, u parashikua në masën 4,000,000 lekë në fillim të vitit dhe ka patur realizim gjatë periudhës raportuese në masën 0.4%.*

II. Me financim të huaj për projektet:

- Me emërtim “Skills for jobs Albania - Montenegro” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 u detajua financimi i huaj prej 1,300,000 lekë. Deri në fund të periudhës raportuese realizimi i këtij zëri është në masën 7%.
- Me emërtim “EEN Albania” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 u detajua financimi i huaj prej 4,000,000 lekë. Deri në fund të periudhës raportuese realizimi i këtij zëri është në masën 35%.

REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – PRILL 2025

Në zbatim të ligjit nr 55/2015 "Për investimet strategjike ne Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 1027, date 16.12.2015 "Për tarifat e shërbimeve per investimet strategjike" përfiton të ardhura nga shërbimet e asistencës së kryera pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për aplikimet për investitor strategjik. Referuar këtyre tarifave, Agjencia për 4-mujorin e vitit 2025, për shërbimet e kryera ka përfituar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit nga shoqëritë aplikuese për investitor strategjik tarifa në vlerën totale prej 425,005 lekë.

5. Performanca jo - financiare e programit buxhetor - AIDA

Nga analiza sasiore e realizimit të objektivit në nivel produkti, për disa tregues AIDA ka arritur nivelet e pritshme.

Më poshtë po ju paraqesim analizën e performancës të produktit jo – projekt “*Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit*”, në nivel treguesish.

- *Mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë (IS);*

Gjatë periudhës raportuese realizimi i treguesevë të performancës krahasuar me planin për këtë objektiv janë në një mesatare prej 15%. Ky realizim është në këto norma pasi deri në muajin mars 2025, ligji i ri ‘Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë’, ende nuk kishte hyrë në fuqi, ndaj gjatë kësaj periudhë (janar - mars 2025) nuk pati asnjë aplikim për Investitor Strategjik, duke sjellë kështu normë të ulët realizimi në këtyre indikatorëve.

Theksojmë se gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Investimeve Strategjike, specifikisht sektori i One Stop Shop ka punuar maksimalisht për ndjekjen e projekteve me status të miratuar dhe atyre në fazë asistimi. Gjithashtu aplikimet e reja janë ndjekur në çdo hap si nga shprehja e interesit deri në fazën përfundimtare të marrjes ose jo të statusit.

- *Suportin e kompanive SME nëpërmjet fondeve;*

Gjatë periudhës raportuese treguesit e performancës për këtë objektiv janë tejkaluar pritshmëritë, me rreth 57 aplikante femra të mbështetura me grante nga 26 që ishte plani dhe 86 aplikant të shpallur fitues nga fondet e vitit 2025, krahasimisht me 65 aplikant që ishte plani.

- *Nxitjen e Investimeve të Huaja direkte (IHD)*

Gjatë periudhën raportuese Janar –Prill 2025, referuar dhe indikatorëve tregues të zbatimit të këtyre objektivave, AIDA ka arritur një realizim të kënaqshëm të këtyre indikatorëve. Aktualisht ka përfunduar targetimi i investitorëve të mundshëm që pritet të takohen gjatë fushatës outreach që do mbahet në muajin qershor 2025. Mesatarja e realizimit të këtyre treguesëve për periudhën Janar – Prill 2025 është në një normë prej 50%.

	Objektivat e politikës	*Objektivat e politikës*:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emërtimi i Treguesit te Performances/Produktit	PLANI 2025	Fakti 4 4M 2025	Drejtoria pergjegjese
1	Mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë	1.1	Numri i aktiviteteteve promovuese	91205AE	Numri i aktiviteteteve promovuese	12	4	IHD
		1.2	Nr. i kompanive aplikuese për status	91205AE	Nr. i kompanive aplikuese	35	5	IS
		1.3	Nr. i kompanive përfituese te statusit	91205AE	Nr. i kompanive përfituese	20	3	IS
2	Nxitja e Investimeve të Huaja direkte (IHD)	2.1	Numri i takimeve after care te organizuara	91205AE	Numri i aktiviteteteve te organizuara	100	10	IHD
		2.2	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkëpunimi me partnere	91205AE	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkëpunimi me partnere	10	7	IHD
		2.3	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	91205AE	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	50	30	IHD
3	Suportin e kompanive SME nëpërmjet fondeve	3.1	Numri i NVMV-ve te mbështetura me fonde publike	91205AB	Numër përfituesish	65	86	SME
		3.2	Numri i NVMV me drejtuese femër qe ka përfituar nga fondet publike	91205AB	Numër përfituesish	26	38	
		3.3	Numri i kompanive te asistuar ne Panaire brenda dhe jashtë vendit	91205AE	Numër përfituesish	50	23	
4	Suporti i kompanive NVM (Projekti EEN ALBANIA)	4.1	Ofrimi i shërbimeve kundrejt NVM-ve	91205AB	Numër	70	107	Sektori projektit SME
		4.2	Klientët (NVM) unike ne shërbime te specializuara	91205AB	Numër	7	99	
		4.3	Krijimi i partneriteteve nga NVM-t	91205AB	Numër	7	2	

Qendra Kombëtare e Biznesit

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ushtron aktivitetin buxhetor në programin “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”. Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat e QKB-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, sipas programimit të miratuar për vitin 2025. Fondet buxhetore për vitin 2025 për QKB-në në total janë 149,855,000 lekë prej të cilave 144, 855,000 lekë janë shpenzimet korrente dhe 5.000.000 lekë për shpenzime kapitale . Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për vitin 2025.

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente për 4 mujorin e vitit 2025, realizimi (Janar –Prill) 2025 është në masën 25%. Më poshtë analizojmë të detajuar këtë realizim:

Shpenzime Operative ku buxheti 12 mujor prej 22,627,000 lekë, është realizuar në shumën 2,090,300 lekë ose në masën 9.24 % .

Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqërore janë realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar në shumën 35,582,223 ose 29.4 %. Për vitin 2025 , nga aktiviteti i QKB- se për periudhën Janar- Prill 2025:

1. 91205 AC nga 273 000 produkte në 45 413 në masën 16,63%

2. 91205 AD nga 7 700 produkte në 4 999 në masen 64.9%

Tabela “ Realizimi i produkteve”

Shërbimi	Aplikimet Janar - Prill 2025			Totali
	QKR	QKL	RPP	
Aktivizim i Aktivitetit te Pezulluar	1666			1666
Aplikim për likuidim të thjeshtëzuar	2			2
Bilanci vjetor	2794			2794
Çregjistrim Person Fizik	3123			3123
Çregjistrim Person Juridik	98			98
Fillim Procedures se Likuidimit	94			94
Korrigjim Dege e Shoqerise se Huaj	6			6
Korrigjim Person Fizik	22			22
Korrigjim Shoqeri Anonime	38			38
Korrigjim Shoqeri Anonime me Oferte Publike	4			4
Korrigjim Shoqeri Komandite	6			6
Korrigjim Shoqëri Kursim Krediti	4			4
Korrigjim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	163			163
Korrigjim Zyre Perfaqesimi e Shoqerise se Huaj	1			1
Miratimi i Bashkimit me Perthithje per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	11			11
Miratimi i Ndarjes Ne Shoqeri Ekzistuese per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	25			25
Miratimi i ndarjes ne shoqeri te re per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	1			1
Ndryshim Dege e Shoqerise se Huaj	108			108
Ndryshim Person Fizik	6692			6692
Ndryshim Shoqeri Aksionare	568			568
Ndryshim Shoqeri Anonime me Oferte Publike	9			9
Ndryshim Shoqeri e Bashkepunimit Bujqesor	16			16
Ndryshim Shoqeri e Thjeshte	15			15
Ndryshim Shoqeri Komandite	2			2
Ndryshim Shoqeri Kursim Krediti	17			17
Ndryshim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	9190			9190
Ndryshim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per efekt te ndarjes	14			14
Ndryshim Zyre Perfaqesimi e Shoqerise se Huaj	14			14
Pa sherbim	4			4
Pezullim Aktiviteti	3894			3894

Plotesim Ekstrakti Historik per Person Fizik	24			24
Plotesim Ekstrakti Historik per Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar	1			1
Printo Certificate	5			5
Projekt Bashkimi me Perthithje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar	12			12
Projekt Ndarje ne Shoqeri te re per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	3			3
Projekt Ndarjeje ne Shoqeri Ekzistuese per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	3			3
Regjistrim Dege e Shoqerise se Huaj	29			29
Regjistrim fillestar per efekt te ndarjes per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	2			2
Regjistrim Person Fizik	6038			6038
Regjistrim Shoqeri Aksionare	24			24
Regjistrim Shoqeri Anonime me Oferte Publike	5			5
Regjistrim Shoqeri e Bashkepunimit Bujqesor	17			17
Regjistrim Shoqeri e Bashkepunimit Reciprok	5			5
Regjistrim Shoqeri e Thjeshte	8			8
Regjistrim Shoqeri Kolektive	4			4
Regjistrim Shoqeri Komandite	1			1
Regjistrim Shoqeri Kursim Krediti	8			8
Regjistrim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	2209			2209
Regjistrim Zyre Perfaqesimi e Shoqerise se Huaj	15			15
Regjistrimi me kërkesë të çdo të treti të vendimeve të autoritetit	5099			5099
Rezervim Emri	46			46
Shndërrimi i Shoqerise Aksionare ne Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	3			3
Shndërrimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ne Shoqeri Aksionare	7			7
Shpallja I per Shndërrimin e Shoqerise Aksionare	1			1
Shpallja I per Shndërrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar	3			3
Shpallja II per Shndërrimin e Shoqerise Aksionare	1			1
Shpallja II per Shndërrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar	2			2
Aplikim i ri		3400		3400
Ndryshim		1372		1372
Revokim Vullnetar		155		155
Shtyrje Afati		7		7
Terheqje aplikimi		65		65
Aplikim për regjistrim fillestar në Regjistrin e Pronarëve Përfutues			2230	2230
Aplikim për ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfutues			1007	1007
Aplikim për konfirmimin e të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfutues			0	0
TOTALI	42176	4999	3237	50412

Referuar tabelës realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale periudha Janar- Prill 2025 është në masën 0%.

Për 4 mujorin e vitit 2025, QKB ka realizuar këto të ardhura, si vijon:

Tabelës : “Të ardhurat”

Në lekë

Llogaria	EMERTIMI	PLAN	FAKT Janar-Prill 2025	Diferenca	%
7110900	Te ardhura nga qiratë	11,000	5,528.00	5,472.00	50.25%
7113099	Te ardhura nga shërbimet	755,000	214,970.00	540,030.00	28.47%
7115655	Gjoha për deklarim te vonuar ne RPP	109,400,000	19,024,000.00	90,376,000.00	17.39%
7115499	Gjoha (kundravajtje administrative)	40,510,000	15,941,110.00	24,568,890.00	39.35%
II	TE ARDHURAT	150,676,000	35,185,608	115,490,392	23.35%

Këto të ardhura janë realizuar në masën 23.35 % për periudhën Janar –Prill 2025 të cilat janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) është një institucion buxhetor, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit që ka si mision të nxisë dhe asistojë Autoritetin/et Kontraktor në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve/partneriteteve publike private. ATRAKO ushtron funksionet e Njesisë së Trajtimit të Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private, të ngarkuara sipas ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet/PPP”, i ndryshuar. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve asiston autoritetet kontraktuese me qëllim:

- Përgatitjen e studimit të fizibilitetit;
- Përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit;
- Vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;
- Kryerjen e negociimeve dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.

Objektivat e politikës së programit për ATRAKO-n:

- Studime fizibiliteti për projekte koncesione/PPP nëpërmjet pjesëmarrjes në Komisionin e Dhënies të Koncesionit/PPP duke dhënë asistencë për studimin e fizibilitetit, hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, vlerësimin e ofertave të projekteve, negocimin e kontratës.
- Kontrata Koncesioni/PPP të publikuara në Regjistrin Elektronik të Koncesioneve, Autoritetet Kontraktuese përcjellin pranë ATRAKO-s për publikim kontratat e Koncesionit/PPP, 15 ditë pas nënshkrimit të tyre.

Gjatë periudhës janar-prill 2025 janë shpenzuar fondet buxhetore si më poshtë:

Tabela: Shpenzimet Operative për periudhën janar – prill 2025 në leke

Emërtimi i Produktit	Plani	Obligim	Fakt	Fonde te disponushme
Studime Fizibiliteti per projektet Koncesionare/PPP	25,161,000	-	5,988,545	19,172,455
Studime Fizibiliteti per projektet Koncesionare/PPP	4,000,000	-	987,626	3,012,374
Studime Fizibiliteti per projektet Koncesionare/PPP	2,652,000	-	19,288	2,632,712
Kontrata Koncesione/ PPP te publikuara ne regjistrin elektronik te koncesioneve	1,300,000	-	-	1,300,000

Studime Fiizibiliteti per projektet Koncesionare/PPP	98,000	-	9,478	88,522
---	--------	---	-------	--------

Performanca me bazë gjinore, në nivel produkti

ATRAKO, ka objekt kryesor të veprimtarisë asistencën pranë Autoriteteve Kontraktuese dhe nuk ka target grupe me bazë gjinore dhe as nuk bën trajtime me bazë gjinore, ndaj është e vështirë të bëhet analizë e treguesve gjinorë.

1. Performanca e Buxhetit

Për periudhën raportuese Janar – Prill 2025, ATRAKO ka pasur vijimësi dhe ecuri të realizimit të shpenzimeve korrente, në nivelin 21 % të fondeve totale të akorduara për vitin 2025.

Detajimi i llogarive ekonomike sipas zërave të buxhetit:

- Shpenzime për paga (artikulli 600) është realizuar në masën 24 % të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2025;
- Shpenzime për sigurime shoqërore, shëndetësore (artikulli 601) është realizuar në masën 25 % të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2025;
- Shpenzime për mallra, shërbime (artikulli 602) është realizuar në masën 1 % të fondit të rishikuar për vitin 2025;
- Transferrat për buxhetet familjare dhe individ (artikulli 606) është realizuar në masën 10% të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2025;
- Për vitin 2025 nuk ka të akorduara fonde për shpenzime kapitale.

Në lidhje me procedurat e prokurimit për vitin 2025, procedura “Mirëmbajtje Regjistri elektronik të koncesioneve/PPP”, e cila do të zinte një pjesë të konsiderueshme të fondit për mallra, shërbime, nuk është realizuar pasi nuk kemi marrë përgjigje nga AKSHI apo dhe nga institucione të tjera për të vazhduar apo jo me kryerjen e kësaj procedure.

Përsa i përket Procedurës së prokurimit me vlerë të vogël gjatë këtij 4 muaji , është realizuar 1(një) procedurë për shërbimin e mirëmbajtjes së printerit dhe fotokopjes dhe janë zhvilluar 3 tre procedura në sistemin dinamik për blerjen e biletave për transportin ajror, ndërkohë pritet të zhvillohen të tjera përgjatë vitit.

Të ardhurat

Në zbatim të VKM nr.285, datë 10.04.2020 “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e nivelit të tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga ATRAKO”, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve përfiton të ardhura nga shërbimet e asistencës së kryera pranë Autoriteteve Kontraktore, për procedurat e dhënies me koncesion/PPP të projekteve nëse këto procedura rezultojnë të suksesshme. Shuma që paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), shpallet në dokumentet e garës dhe paguhet nga koncesionari fitues, si më poshtë vijon:

Vlera e projektit/leke	Tarifa/LEKE
Për projektet koncesionare deri në 700,000,000 lekë	700, 000 lekë

Për projektet koncesionare mbi 700,000,000 lekë deri në 2,100,000,000 lekë	1,400,000 lekë
Për projektet koncesionare mbi 2,100,000,000 lekë deri në 7,000,000,000 lekë	2,800,000 lekë
Për projektet koncesionare mbi 7,000,000,000,000 lekë	4,200,000 lekë

Performanca jo-financiare

Në përputhje me misionin e saj, me qëllim rritjen e transparencës, respektimin e procedurave për dhënien me koncesion/PPP nga të gjithë Autoritetet Kontraktuese dhe Standardizimin e tyre, në 4-mujorin e vitit 2025:

- Agjencia është marrë me asistimin në hartimin e studimit të fizibilitetit për 2 projekte koncesionare PPP.

Është duke Asistuar autoritetet kontraktuese, me qëllim:

- përcaktimin e procedurës së zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe hartimin e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit, për 2 projekte.
- shqyrtimin dhe vlerësimin e 4 ofertave të pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje pasi AK ka dorëzuar një projekt;
- kryerjen e negociimeve të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për 2 (dy) projekte;

Me qëllim rritjen e transparencës mbi kontratat e koncesionit/PPP, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 211 datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të koncesioneve/PPP” sipas informacionit të përcjellë nga Autoritetet Kontraktuese, ATRAKO ka për të publikuar 1 kontratë dhe 3 anekse/shtesa kontratash të cilat për arsye teknike ende nuk janë publikuar dhe me korrigjimin e problemeve teknike nga ana e AKSHIT do të vijohet me publikimin e tyre.

Propozime për përmirësimin e situatës, me qëllim arritjen dhe përmbushjen e objektivave:

- Standardizimi i procedurave për monitorimin e kontratave të Koncesionit/PPP-ve;
- Ristrukturimi i ATRAKO-s nëse do të ketë ndryshime në ligjin e koncesioneve /PPP-ve;
- Funksionimi në mënyrë efikase i regjistrit të Koncesioneve/PPP-ve.

Programi i Mbështetjes për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilësisë & Pronësia Industriale (Programi 04160)

Objektivat e programit konsistojnë në zbatimin e kërkesave ligjore nëpërmjet vlerësimit të konformitetit, sigurisë së produkteve jo ushqimore, të drejtës të pronësisë Industriale dhe verifikimit të instrumenteve ligjorisht të kontrolluar, duke garantuar mbrojtjen e konsumatorit në:


Për vitin 2024, për arritjen e këtij objekti janë realizuar produktet kryesore me të dhënat si më poshtë.

Ky program nëpërmjet mbështetjes dhe promovimit të përdorimit të i) standardeve europiane e ndërkombëtare, ii) akreditimit si njohje e besueshmërisë së rezultateve të organeve të vlerësimit të

konformitetit, iii) metrologjisë për matje të sakta dhe të sigurta për konsumatorët si dhe iv) mbështetjes së inspektimeve në treg, synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së jetës, shëndetit, interesave ekonomike të konsumatorëve, nëpërmjet inspektimeve në treg dhe rritjen dhe zhvillimin e tregtisë dhe konkurrencës së ndershme.

Fondet e parashikuara për këtë program sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 390 milion lekë, nëpërmjet aktit normativ nr. 1, datë 21.02.2024 dhe 1.05 milion lekë çelje nga fondi i veçantë. Këto fonde janë për 12-mujorin e 2024 janë realizuar në vlerën e 237.9 milion lekë. Plan i është realizuar në masën 57 %.

Figura 13 Programi i Mbështetjes për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastruktura e Cilësisë & Pronësia (Programin 4160) Industriale (Programi 04160)



Ky program përfshin 4 institucione në mijë lekë:

ART.	Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (3535)		Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise (3535)		Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit (3535)		Inspektoriati Shteteror i Mbikqyrjes se Tregut (3535)		Total	Total
	Plani	Fakt	Plani	Fakt	Plani	Fakt	Plani	Fakt	Plani	Fakt
231	-	-	12,000	-	-	-	-	-	12,000	-
600	30,000	11,323	105,000	37,391	23,000	7,925	95,000	35,483	253,000	92,121
601	5,000	1,786	17,222	6,238	4,000	1,261	16,000	5,906	42,222	15,192
602	4,000	1,153	32,200	7,025	3,000	758	22,308	5,547	61,508	14,483
605	2,500	1,871	4,500	2,090	14,000	8,203	-	-	21,000	12,163
606	98	13	248	179	605	12	141	-	1,092	204
Tot.	41,598	16,145	171,170	52,923	44,605	18,159	133,449	46,936	390,822	134,164

- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM)

Objekti i këtij institucioni synohet rritja e shkallës së mbrojtjes të konsumatorit dhe shtetit nga matjet e pasakta nëpërmjet kryerjes së kalibrimeve dhe verifikimeve të mjeteve matëse që përdorin subjektet. Sigurimi i trasmetueshmërisë, gjurmueshmërisë së matjeve. Zhvillimi i infrastrukturës së integruar të matjeve duke marrë parasysh nevojat e Biznesit, Konsumatorit, Qeverisë dhe Industrisë. Për arritjen e objektivit është realizuar përdorimi i buxhetit për 4 M 2025 rreth 52.9 milionë lekë. Plani i rishikuar është rreth 170.17 milion lekë dhe është realizuar rreth 31 % me të dhënat si më poshtë:

- Produkti- Kalibrime dhe verifikime të mjeteve matëse (numër verifikimesh – 13,306).
- Produkti- Anëtarë me të drejta të plota në organizata ndërkombëtare EUROMED, BIPM, WELMEC, OIML, IMECO. Janë kryer pagesa për 4 organizata ndërkombëtare.
- Sensor (Blerje pajisje për kompletimin e laboratorëve të DMSHI) me plan 12,000,000. Po vijohet me procedurat sipas parashkimeve.

- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)

Objekti i këtij institucioni është zbatimi i kërkesave ligjore nga subjektet/operatorët ekonomikë konform legjislacionit në fuqi për ofrimin e produkteve, pajisje/ instalime të sigurta për konsumatorin si dhe për respektimin e të drejtave të industrisë industriale si dhe rritjen e transparencës së tregut dhe praktikave tregtare për mbrojtjen e interesit ekonomik të konsumatorëve.

Për arritjen e objektivit është realizuar përdorimi i buxhetit në vlerën rreth 46.9 milion lekë gjatë kësaj periudhe. Plani prej rreth 133.44 milion lekë është realizuar në masën 35%, duke realizuar produktet me të dhënat si më poshtë:

- Produkti- Inspektime për mbikëqyrjen e tregut në të gjithë territorin e vendit. Janë kryer rreth 445 inspektime.

- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)

Objekti i këtij institucioni është ndjekja e ritmit të adaptimit të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të publikuara nga organizmat përkatëse të standardizimit si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare (DS), miratimi, shitja dhe shfuqizimi i atyre të vjetëruara.

Për arritjen e objektivit është realizuar përdorimi i buxhetit në vlerën rreth 18.16 milion lekë gjatë kësaj periudhe. Plani i rishikuar për DPS është rreth 44.6 milion lekë, nga të cilat janë realizuar rreth 41 % duke realizuar produktin:

- Standarde evropiane dhe ndërkombëtare të adaptuara, miratuara si SSH, miratuara si SSH. Janë adoptuar 399 standarde.

- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA).

Objekti i këtij institucioni është fuqizimi i funksionit menaxhues, në funksion të implementimit të suksesshëm të programit, konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.

Për arritjen e objektivit është realizuar për vitin 2024 fondi në vlerën 48.06 milion lekë. Plani prej rreth 48.8 milion lekë është realizuar në masën 98 % duke realizuar produktet me të dhënat si më poshtë:

- Produkti Administratë funksionale. Për të vlerësuar konformitetin DPA ka të akredituar 23 organe, 4 laboratorë testues, 2 laboratorë mjekësorë, 1 laborator kalibrues, 5 organe certifikuese personi, 5 organe certifikuese të sistemeve të menaxhimit, 6 organe inspektuese. Janë lëshuar 22 certifikata të akredituara.

Treguesit e performancës janë si më poshtë:

Numri i OVK të akredituar deri më 30 prill 2025 janë:

- 115 Organe të Vlerësimit të Konformitetit, nga të cilët:
- 52 Laborator testues
- 1 Laborator Kalibrues
- 7 Laborator Mjekësor
- 29 Trupa Inspektuese
- 14 Trupa Çertifikim Personi
- 12 Trupa për Sistemet e Menaxhimit
-

Programi i Sigurimeve Shoqërore (Programi 10220)

Misioni i Sistemit të Sigurimeve Shoqërore është mbulimi me elementë të sigurimeve shoqërore, i gjithë popullsisë së vendit e i rezidentëve ekonomikisht aktiv dhe akordimi për këta persona i përfitimeve pensionale, përfitime në rast sëmundje, në rast të aksidentit në punë, në rast barrë lindje, përfitime suplementare apo nga programe të veçanta të Qeverisë, në momentin e lindjes së të drejtës dhe nevojës për ato.


Sistemi i sigurimeve shoqërore administrohet nga ISSH dhe misioni i tij është administrimi i Sigurimeve Shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj tyre në qendër të veprimtarisë, mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore atje dhe në atë kohe kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave kontributive nga personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

Në këtë kontekst, Institutit i Sigurimeve Shoqërore është fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të skemave aktuale, nëpërmjet forcimit të shtyllës publike të pensioneve, forcimit të elementeve të lidhjes më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, futjes graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuara nga subjekte jo publike, zhvillimi i forcimit i skemave të sigurimeve suplementare profesionale dhe vullnetare, rritjes së efikasitetit dhe përmbushjes së funksioneve të ISSH nëpërmjet shtimit të kapaciteteve drejtuese, informatizimit të sistemit në përgjithësi të proceseve të punës dhe të informacionit arkivor në veçanti dhe thellimit të masave për përmirësimin e shërbimit pro klient.

ISSH, për të arritur objektivat e mësipërme, përveç të ardhurave të veta, si pjesë e strukturës shtetërore, financohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përmes transfertave nga llogaria 604 nga buxheti i MEKI-it, si pjesë e përgjegjësi të kësaj ministrie.

Fondet e parashikuara për këtë program sipas planit vjetor janë në vlerën rreth 46.22 miliardë lekë, të cilat janë realizuar me rreth 31 % të planit të rishikuar.

Figura 14 Programi i Sigurimeve Shoqërore (Programi 10220)



Ky program ka peshën më të madhe në buxhetin e MEKI, duke qënë se përfshin mbulimin e skemave për kompensime dhe trajtime të veçanta. Informacion më të detajuar mbi produktet e këtij programi paraqitet tabela më poshtë:

Tabela 3 Produkte të realizuar 10220 te realizuara nga grup 12

Kodi I Produktit	Emërtimi i Produktit	Sasia plan	604 Plan	Sasia fakt	604 Fakt
91210AA	Transferte buxhetore per te mbuluar diferencon midis te ardhurave dhe shpenzimeve te skemes se Pensioneve publike	730,174	27,459,252,000	724,228	8,332,846,000
91210AB	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për Trajtim i vecante i punonjësve të nëntokës	15,152	500,461,000	14,853	327,306,000
91210AC	Perfitime te llogaritura e te shperndara per sigurimin suplementar te personave me statusin Profesor	1,081	134,893,000	1,063	41,781,000
91210AD	Përfitime të llogaritura e të shpërndara për sigurimin shtetëror suplementar	4,582	168,324,000	4,333	52,136,000
91210AE	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për sigurimin suplementar të ish policeve	5,845	311,978,000	3,307	96,631,000
91210AF	Përfitime të llogaritura e shpërndara për sigurimin suplementar për persona mëm statusin Metalurg	1,989	54,678,000	1,915	16,935,000
91210AG	Përfitime të llogaritura e shpërndara për sigurimin suplementar për persona nën statusin Naftëtar	10,047	444,356,000	9,819	137,632,000
91210AH	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për programin e Kompensimit të Çmimeve	423,570	4,793,229,000	376,321	1,484,638,000
91210AI	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për programin e pensioneve të posacme shtetërore	276	294,393,000	276	91,185,000

91210AJ	Perfitime te llogaritura dhe shperndara per shperblime per Pensionet e Vetereaneve	824	30,062,000	615	9,311,000
91210AK	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për shpërblime për Invalidët e Punës	348	43,939,000	351	13,609,000
91210AL	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për të ardhurat e pensionistëve	237,270	3,272,164,000	258,438	1,013,509,000
91210AM	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për pensionet sociale	2,491	238,960,000	2,339	74,012,000
91210AN	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime mbi statusin Dëshmor i Atdheut	315	27,117,000	321	8,399,000
91210AO	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë për shpenzime varrimi	20,524	165,232,000	14,965	51,178,000
91210AR	Akte ligjore/nenligjore te hartuara	1	-	1	-
91210AU	Shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit	72,000	2,855,522,000	68,805	884,459,000
	Total	1,526,489	40,794,560,000	1,481,950	2,635,567,000

Programi i Tregut të Punës (Programi 10550)

Objektivi kryesor i Programit të Tregut të Punës është nxitja e mundësive për punë të denjë, rritja e punësueshmërisë së forcave të punës nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës, përputhjes së kërkesës me ofertën për punë, nga shërbimet e punësimit, rritja e formimit profesional, mbështetja me të ardhura për të papunët nëpërmjet pagesës së papunësisë.

Plani i rishikuar aktiv nw sistem për programin Tregu i Punës për vitin 2025 është 2,927,647.000 leke, ndërsa financimi i huaj u be aktiv ne muaji maj. Struktura e planit te rishikuar ne % sipas produkteve eshte :

- produkti 91211AA -Ndërmjetësim, Këshillim te realizuar ne Zyrat e Punësimit është 18% ndaj totalit,
- produkti 91211 AB-Te punësuar ne programe Nxitje punësimi është 15% ndaj totalit,
- produkti 91211AC - Kursante ne Formimmi profesional është 12% ndaj totalit,
- produkti 9121 IAG- Persona te trajtuar me Pajese Papunesia eshte 27% ndaj totalit,
- produkti 91211 AE- Kursante ne program in e Kodimit eshte 3% ndaj totalit,
- produkti 91211 AD - Te rinj pjesëmarrës ne nismën Garancia Rinore është 7% ndaj totalit,
- produkti 91211AF- Leje pune, raporte statistikore, financiare etj ne Administrata Qendrore AKPA është 10 %,
- produkti 91211AL - Plani i rritjes përcaktuar nga axhenda kombëtare e reformave është 7%
- investimet janë 6% ndaj total it.

Për sa me sipër, shikohet se për programet aktive janë financuar nga buxheti i shtetit 53% e fondeve te programit Tregu i Punës, 27% për programet pasive (Papunësia), 7% për investime , 6% për Administratën Qendrore AKPA dhe 7% për "Plani i Rritjes".

Plani fillestar i akorduar për programin 10550 "Tregu i Punës" për vitin 2025 është 2,926,547,000 leke. Gjate kësaj periudhe është kryer akordimi i fondit te veçantë ne shumen 1.000.000 leke.

Shërbimet e punësimit

Drejtoria Rajonale te Punësimit zbaton shërbime punësimi, këshillimi, orientimi për formim profesional, programe nxitje punësimi me qëllim rritjen e aftësive të punëkërkuarve të papunë për integrimin e tyre në tregun e punës. Realizimi i treguesve të buxhetit është 30% në krahasim me planin vjetor të rishikuar.

Objekti vjetor është realizimi i 25.000 ndërmjetësime dhe gjetje pune vete, numri i subjekteve të regjistruar për herë të parë në Zyra Punësimi të jetë 3,700, numri i subjekteve unike që shpallin YLP të jetë 10.000. Gjatë periudhës janar- prill janë realizuar 7,448 ndërmjetësime.

Realizimi i treguesve të buxhetit për administrimin e 12 Drejtorive Rajonale të Punësimit është:

- Plan vjetor 518,403,900 leke
- Plan i rishikuar 518,403,900
- Shpenzuar 4 muhori I-rë 155,759,498 leke realizimi 30%.

Pagesa e Papunësisë

Programi funksionon në bazë të Ligjit Nr. 7703 dt. 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore" i ndryshuar, VKM nr.161 datë 21.03.2018 "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia", VKM 113 datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi". Programi i papunësisë, ka patur pakesim të numrit të personave që trajtohen me të ardhurën e papunësisë gjatë periudhës dhjetor 2024- mars 2025, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Gjatë kësaj periudhë janë trajtuar me të ardhurën nga papunësia mesatarisht 2524 punëkërkuar të papunë.

Realizimi i treguesve të buxhetit është:

- Plan vjetor 800,000,000 leke
- Plan i rishikuar 800,826,926 leke
- Shpenzuar 4 muhori I-re 227,031,387 leke realizimi 28%.

Programi i Nxitjes së Punësimit, produkti 91211AB

Programi i nxitjes së punësimit vepron në zbatim të Ligjit të Nxitjes 15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si:

- VKM nr.17, datë 15.01.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale" i ndryshuar
- VKM nr. 348, datë 29.4.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet Vetëpunësimit"
- VKM nr. 535, datë 8.7.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Puneve Publike në Komunitet"

Realizimi i treguesve të buxhetit për produktin 91211AB paraqitet si më poshtë:

- Plan vjetor 450,000,000 leke
- Shpenzuar 4 muhori I-re 152,049,647 leke realizimi 34%.

Programi i Formimit Profesional, Programi i Kodimit. Produkti 91211AE

Programi synon të zhvillojë dhe përmirësojë aftësitë e personave të interesuar në fushën e programimit duke u integruar në tregun e punës. Gjatë vitit 2025 synohet që numri i aplikimeve për këtë program të jetë 700 persona. Fondi për programet e mbartura nga vitit 2024 është 26,757.000 leke. Fondi për programet e reja për vitin 2025 janë 73.242,000 leke.

Realizimi i treguesve të buxhetit paraqitet si më poshtë:

Plani vjetor	100,000,000 leke	
Shpenzime 4 mujori -re	11,729,925 leke	realizimi 12%

Programi i Garancise Rinore, Produkti 91211AD

Programi i Garancise Rinore mbështetet në zbatimin e VKM nr.264 dt 27.04.2023, dhe synon të mbështesë dhe të krijojë mundësi për të rinjtë në Shqipëri, duke përfshirë punësim, arsim, dhe formim profesional. Ky program ka për qëllim të ndihmojë të rinjtë e mashës 15-29 vjeç në përgatitjen dhe intergrimin e tyre në tregun e punës. Ky program po pilotohet në tre Tiranë, Shkoder dhe Vlorë. Plani vjetor për nismën Garancia Rinore është pjesë e 400 të rinjve në programet e ndërtimit të punësimit.

Plani vjetor	200,000,000 leke	
Shpenzuar 4 mujori I- re	13,095,178 leke	realizimi 7%

Programi i Formimit Profesional Publik, Produkti 91211AC

Programet e formimit profesional synojnë në:

- Rritjen e numrit të p.u.pa- ve pjesëmarrës në kurse të formimit profesional në QFP-te publike në 7,000 persona. Gjatë vitit 2025 do të trajtohen 9,600 persona, nga të cilat 7,000 veta do të marrin pjesë në kurse të formimit profesional dhe 2,600 veta në kurset për aftësi digjitale. Rritja e cilësisë së mesimdhënie, organizimit të proceseve të provimit dhe certifikimit për të rritur besueshmërinë dhe njohuritë e fituara në këto institucione. Rritjen e nivelit të punësueshmërisë në masën 50% pas përfundimit të kurseve të formimit
- Permisimi i sistemit të QFP-ve dhe skema e ndërlidhjes midis Sistemit të Shërbimit të Punësimit. Popullimi i modulit të formimit profesional, krijimi i regjistrat elektronik të të diplomuarve në sistemin SMTP, mbajtja e databazave të bizneseve që ofrojnë praktikë profesionale.


Plani vjetor	339,049,174 leke	
Shpenzuar 4 mujori I-re	120,919,632 leke	realizimi 36%

Buxheti i akorduar për investime për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive janë për Ndërtimin e Kampusit të Formimit Profesional në shumën 134,800,000 leke dhe investimi me objekt "Rikonstruksion Zyra Punësimi , Qendra të Formimit Profesional" në shumën 16,200,000 leke. Për objektin "Ndërtimi i Qendres Multifunksionale Kampusi pranë Qendres së Formimit Profesional nr.4 Tiranë", është lidhur kontrata nr.22 t 5/3 datë 26.12.2024 me bashkimin e operatorëve "Lis Konstruksion" sh.p.k& "Sireta 2F" sh.pk në shumën 182,604, 309 leke, investim i cili është i shtrirë në vitet 2025, 2026. Jemi në pritje për marrjen e lejes së ndërtimit dhe me pas fillimin e punimeve.

Për Objektin "Rikonstruksion Zyra Punësimi , Qendra të Formimit Profesional" jemi në fazën e përgatitjes së dokumentave për fillimin e procedurës së prokurimit.

Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Periudha Rapotuese		Periudha Rapotuese	
		Sasia (sipas planit të rishikuar 2025)	Shpenzimet (sipas nplanit të rishikuar 2025)	Sasia Faktike 2025	Shpenzimet Faktike (në fund të vitit 2025)
91211AA	Ndermjetesime te realizuara nga Zyrat e Punesimit AKPA	25,000	518,403,900	7448	155,759,499
91211AB	Te punesuar/ te trajnuar nepermjet pjesemaries ne programet e nxitjes se punsesimit	2,200	450,000,000	2093	152,049,647
91211AC	Te trajnuar ne Qendrat e Formimit Profesional Publik	9,600	339,049,174	3605	120,919,632
91211AD	Te rinj perfitues te nismes Garancia Rinore	400	200,000,000	114	13,095,178
91211AE	Kursante ne formimim profesional sipas VKM nr.646 dt 5.10.2022(Kodimi)	700	100,000,000	184	11,729,925
91211AF	Leje pune per shtesait e huaj, raportime statistikore, financiare, procedura prokurimi	10,000	168,267,000	2583	41,057,597
91211AG	Persona te trajtuar me pagese papunesie	3,300	800,826,926	2524	227,031,387
91211AK	VR Digi VET AKPA		0		900
91211AL	Plani i rritjes e percaktuar nga Agjenda kombetare e reformave	1,006	200,000,000		0
	Total		2,776,547,000		721,643,765

Figura 15 Programi i Tregut të Punës Programi 10550



Programi i Inspektimi në Punë (Programi 04170)

Objekti i programit është që nëpërmjet inspektimit të punës, të synohet realizimi i procesit të inspektimit, promovimit të një kulture parandaluese për kushtet e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës si dhe të qasjes së një pune të siguruar nga ana shoqërore e shëndetësore. Buxheti total i miratuar për vitin 2024 Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është 238.21 milionë lekë ku përfshihet edhe 900 mijë plani për fondin e veçantë. Nga këto janë realizuar fondet në vlerën 80.91 milionë leke ose 28.5% e planit të rishikuar.

Në funksion të objektivit, gjatë kësaj periudhe raportuese është realizuar produkti si më poshtë:

- 3,064 Inspektime me kosto faktike 80.91 milion lekë.

Në këtë program bën pjesë Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), i cili është autoriteti shtetëror i ngarkuar me funksionet e inspektimit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shërbimeve shoqërore.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) është autoriteti shtetëror i ngarkuar me funksionet e inspektimit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shërbimeve shoqërore. Misioni i ISHPSHSH është të garantojë vende pune të denja, të sigurta dhe të shëndetshme nëpërmjet një sistemi inspektimi profesional dhe të përgjegjshëm, si dhe të promovojë një kulturë në zbatim të legjislacionit të punës.

ISHPSHSH-ja në zbatim të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës” (i ndryshuar me ligjin nr. 57/2017) ka përgjegjësi të sigurojë:

- zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, përfshirë kohën e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë që inspektorët e punës janë ngarkuar të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;
- ofrimin e informacionit teknik dhe këshillave për punëdhënësit dhe punëmarrësit në lidhje me mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore që mbulojnë çështjet e punës;
- sjellje në dijeni të autoriteteve përgjegjëse për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të specifikë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë masat dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e situatës.

Në kuadër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit, por edhe të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, buxheti është 283,384 mijë lekë. Në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për 4-mujorin e vitit 2025, për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Shpenzime Korrente.

- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 për zërin paga dhe sigurime është 226,979 mijë lekë. Fondi i pagave për 4-mujorin e vitit 2025 është realizuar në vlerën 72,642 mijë lekë të shprehur në përqindje është në masën 32%. Planifikimi i fondit të pagave është bërë sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023” Për Miratimin e Strukturës së Pagave, Niveleve të Pagave dhe Shtesave të tjera mbi Pagë të Zëvendësministrit, Funkionarëve të Kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civilë dhe Nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike” Personeli mbështetës përbëhet nga 7 punonjës administrata qendrore dhe 3 punonjës ne drejtorinë rajonale Tiranë. Për personelin mbështetës planifikimi i pagave është bërë sipas VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 “Për Pagat e Punonjësve Mbështetës dhe Punonjësve të tjerë të Specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”.

Numri i punonjësve për vitin 2025.

Plotësimi i numrit të punonjësve është kryer sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 174, Datë 10.09.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore” me një personel prej 163 punonjësish nga të cilët 46 punonjës janë në drejtorinë qendrore dhe 117 punonjës janë në drejtoritë rajonale”. Institucioni ka aktualisht të emëruar 159 punonjës, dhe 4 vakanca. Gjatë 4-mujorit të 2025 janë rekrutuar vetëm 11 punonjës. Bazuar në VKM nr. 19, datë 9.01.2025 “Për Përcaktimin e Numrit të Punonjësve me Kontratë të Përkohshme, për vitin 2025, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore, ISHPSHSH- së i

janë miratuar 9 (nëntë) punonjës. Për 4-mujorin e 2025 Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka rekrutuar 9 (nëntë) punonjës, 5 (pesë) arkive dhe 4 (katër) sanitare me kontratë të përkohshme. Për nevojat e institucionit në Drejtorinë Rajonale këta punonjës kanë një kontratë deri në 1-vit, me 6 orë /ditë. Pagesa e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025 do të bëhet nga buxheti i miratuar.

Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera Operative.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 është 33,957 mijë lekë. Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si drita, ujë, telefon, elektricitet, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë, karburant, taksa etj. Në këtë artikull janë kryer shpenzime për dieta brenda vendit ku si pasojë e urdhrave të ndryshëm të punës për të realizuar inspektime në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë e bënë të nevojshëm përdorimin me efikasitet të këtij zëri në buxhetin e 2025. Gjatë 4-mujorit ky zë buxhetor 602 është realizuar nga 33,957 mijë lekë në vlerën 8,261 mijë lekë të shprehur në përqindje 25%.

Transferta, Fond i Veçantë. Llogaria 606

Bazuar në tavanet buxhetore të çelura për vitin 2025 ISHPSHSH-së për fondin e veçantë i janë miratuar 48 lekë për pagesa të telefonisë celulare dhe është shtuar dhe vlera 400 lekë për pagesat e daljes në pension të punonjësve, në raste sëmundieje etj. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore për 4- mujorin e vitit 2025 realizoi këtë fond në vlerën 10 lekë, në një përqindje 2.2%.

Shpenzime për Investime kapitale

Fondi i investimeve për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për vitin 2025 është 22.000 mijë lekë, i cili është shpërndarë në zëra si më poshtë:


- Blerje pajisje kompjuterike/elektronike me një vlerë prej 1,500 mijë lekë për plotësimin e nevojave të inspektorëve për ecurinë normale dhe funksionale të punës së tyre të përditshme. Duke qenë se vlera e këtij projekti e kalon kufirin e prokurimeve me vlerë të vogël zhvillimin e kësaj procedure e kryen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në cilësinë e organit qendror për pajisjet elektronike. Për sa më lart ISHPSHSH ka përgatitur specifikimet dhe fondin limit sipas standardeve të miratuara nga organi qendror duke nisur kërkesën për miratim dokumentacioni dhe zhvillim procedure prokurimi.
- Blerje pajisje të ndryshme për zyra dhe mbrojtje ndaj zjarrit (kondicioner, mobilje, pajisje të ndryshme zyre), me një vlerë 500 lekë. Për këtë projekt është zhvilluar procedura e prokurimit gjatë muajit Maj dhe është në fazën e lidhjes së kontratës midis palëve kontraktuese.
- Blerje automjete me një vlerë 20,000 mijë lekë, është një projekt që për ISHPSHSH përbën mjetin kryesor të arritjes së misionit të saj, i cili është “Inspektimi i Punës” në vendin ku zhvillon aktivitetin ekonomik subjekti. Nëpërmjet këtij projekti institucioni synon të mundësojë trupës inspektuese pajisjen me 7 ose 8 automjete. Mbas çeljes së fondeve ISHPSHSH ka ngritur grupet e punës të cilët kanë përcaktuar specifikimet teknike, dhe aktualisht janë në fazën e testimit të tregut për të përcaktuar sasinë finale të automjeteve që mund të blihen. Në ditët në vijim e gjithë praktika e përgatitur nga grupet e punës do të dërgohet pranë Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara në cilësinë e organit qendror për zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore për 4 mujorin e vitit 2025 nuk ka pas të ardhura jashtë limitit të buxhetit të shtetit.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore gjatë 4 mujorit të vitit 2025 ka realizuar buxhetin në vlerën 80,913 mijë lekë dhe të shprehur në përqindje 28.5 %.

Figura 16 Programi i Inspektimi në Punë (Programi 04170)



Programi i Arsimit të Mesëm Profesional (Programi 09240)

Programi buxhetor Arsimi i Mesëm Profesional gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2025 ka vijuar të mbështesë qëllimin dhe objektivat e vendosura në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 për “Ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit”. Aktualisht, arsimi profesional ofrohet në 29 shkolla publike të arsimit profesional ku janë ofruar rreth 90 kualifikime të nivelit II-V të KSHK (drejtime mësimore, profile dhe programe pas të mesëm). Në total, numri i nxënësve që ndoqën arsimin profesional publik për vitin 2024-2025 ishte 15,459, nga të cilët 2,583, janë vajza. Buxheti i planifikuar për vitin 2025 në programin 09240 Arsimi i Mesëm Profesional është 3,943,939,000 lekë. Buxheti i realizuar për 4 mujin është 22.2% e totali vjetor të buxhetit të planifikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente është 28%, ndërsa shpenzimet në zërin shpenzime kapitale në total (të brendshme dhe të huaja) ishte 2%. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm kishin një realizim 1 %. Realizimi i objektivave dhe produkteve të programit 09240 “Arsimi mesëm profesional” për 4-mujorin 2025 janë si më poshtë:

Objektivi I: “Rritja e aksesit në arsimin profesional”, i cili synon të rrisë pjesëmarrjen e nxënësve në arsimin profesional nëpërmjet rritjes së imazhit të AFP-së (promovimi, ditët e hapura në shkolla, rritjen e aksesit të vajzave dhe grupeve në nevojë). Në këtë kuadër, prej vitesh nxënësit nga grupet në nevojë, vajzat që zgjedhin AP dhe kategori të tjera, subvencionohen me bursa dhe tekste falas sipas akteve ligjore në fuqi. Gjithashtu, në funksion të këtij objekti është dhe rritja e përmirësimi i kapaciteteve fizike të godinave të shkollave dhe reparteve të praktikave profesionale. Për 4-mujorin 2025 ka këto rezultate në realizimin e produkteve:

Produkti: nxënës që ndjekin shkollat e AP

15,459 nxënës kanë ndjekur shkollat e arsimit profesional me një kosto faktike rreth 834.4 milion lekë ose 32% në krahasim me planin. Vitin shkollor 2024-2025 në 29 shkollat publike të arsimit profesional e ndoqën 15,459 nxënës, nga të cilët 2,583 janë vajza. Të dhënat e vitit shkollor 2024-2025 tregojnë një rritje të numrit të nxënësve në AP si në total dhe në numrin e vajzave. Gjithashtu, janë realizuar treguesit e vendosur për rritjen e aksesit në arsimin profesional për grupet e marginalizuara, ku për vitin 2025 e ndoqën arsimin profesional

188 nxënës me nevoja të veçanta, 539 nxënës nga komuniteti rom/egjiptian si dhe 50% e nxënësve ishin nga zonat rurale. Në programet e arsimit pas të mesmes niveli V i kualifikimeve, në vitin shkollor 2024-25 u regjistruan 268 nxënës nga të cilat 127 femra

Produkti: Bursa të përfituara nga nxënësit e AP

700 nxënës kanë ndjekur shkollat e arsimit profesional me një kosto faktike rreth 19.5 milion lekë. Gjatë 4 muajve të parë të vitit 2025, rreth 700 nxënës nga grupet në nevojë, vajzat që zgjedhin AP, nxënësit me nevoja të veçanta, nxënësit romë dhe egjiptianë, nxënësit e degëve parësore të ekonomisë, nxënës me rezultate 9-10, etj., kanë përfutur bursa me një kosto faktike prej 19.5 milionë lekë. Të dhënat për kategoritë e veçanta (të cilat përfitojnë direkt bursë dhe ½ e bursës) tregojnë se vitin shkollor 2023-2025 e ndoqën 639 nxënës romë dhe egjiptianë, nga të cilët 169 vajza, 160 nxënës me nevoja speciale, si dhe 2,583 vajza. Realizimi i këtij produkti ka qene i ulët për arsye të vonësve nga NJQV në dërgimin e dokumentacionin për çeljen e fondeve.

Produkti: Nxënës që përfitojnë subvencion për tekste mësimore

Ky produkt nuk ka realizim për 4 muajin, pasi ky produkt realizohet në muajt tetor -dhjetor 2025, për arsye se vitit shkollor fillon në shtator dhe rimbursohen tekstet e nxënësve për vitin shkollor 2026-2027.

Objektivi II: “Sigurimi i cilësisë në AFP”. Sigurimi i cilësisë ka rol kyç në modernizimin e sistemeve të arsimit dhe formimit profesional (AFP). Në sistemin e AFP-së për sigurimin e cilësisë zbatohen një sërë procesesh në AFP (hartimi i akteve ligjore, zhvillimi dhe mirëmbajtja e kualifikimeve profesionale, vetëvlerësimi, trajnimi, akreditimi dhe inspektimi i ofruesve të AFP-së (publikë dhe privatë), përmirësimi i infrastrukturës së ofruesve të AFP-së, etj.). Sigurimi i cilësisë në AFP, i cili ka një rol kyç në zhvillimin e sistemit të AFP-së, ishte në qendër të vëmendjes gjatë vitit 2025. Gjatë këtij viti janë zhvilluar një sërë procesesh për sigurimin e cilësisë në sistemin e AFP-së, duke përfshirë hartimin e akteve ligjore, licencimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, vetëvlerësimin, trajnimin e mësimdhënësve të AFP-së, akreditimin dhe inspektimin e ofruesve të AFP-së.

Për vitin 2025, realizimi sipas produkteve paraqitet si vijon:

Produkti: Skeletkurrikula dhe programe të kurseve të unifikuara dhe materiale mësimore të hartuara.

10 skeletkurrikula dhe programe të kurseve të unifikuara dhe materiale mësimore, me një kosto faktike prej 10,2 milionë lekë.

Nisur nga zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës për kualifikime profesionale, si dhe nga informacionet, komentet dhe kërkesat e marra nga shkollat profesionale në lidhje me ecurinë e zbatimit të skeletkurrikulave të Arsimit Profesional, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) ka hartuar 10 skeletkurrikula për kualifikime të reja /dhe të rishikuara.

Produkti: Standarde profesionale dhe kualifikimesh të miratuara.

27 standarde profesionale dhe kualifikimesh me një kosto faktike prej 6,6 milionë lekësh.

Gjatë 4 muajve të vitit 2025, AKAFPK, bazuar në zhvillimet dhe pritshmëritë e tregut të punës, studimet e ndryshme lidhur me nevojat për kualifikime profesionale, si dhe tendencat e globalizimit, me qëllim përshtatjen e kualifikimeve profesionale të ofruara në sistemin e arsimit profesional me kërkesat e tregut të punës, ka rishikuar, hartuar dhe miratuar 27 kualifikime profesionale, Gjithashtu, 2 Komitetet Sektoriale të TIK dhe Mikpritjes e Turizmit kanë funksionuar në mënyrë të plotë si dhe kanë validuar standardet e

profesioneve dhe kualifikimeve në fushat përkatëse. Komiteti I trete sectorial per Energji ne process ngritje.

Produkti: Mësues të trajnuar dhe atestuar. 25 mësime u trajnuan/atestuan me një kosto prej 1.2 milion lekësh.

Produkti: Ofrues të mbështetur për sigurimin e cilësisë. 40 ofrues të AFP-së të mbështetur për procesin e vetëvlerësimit dhe 3 në proces miratimi akreditimi me një kosto faktike prej 188 mijë lekësh.


Gjatë 4 – muorit të vitit 2025, AKAFP ka mbështetur 40 ofruesit e AFP-së për procesin e vetëvlerësimit dhe ka hartuar raportin kombëtar të vetëvlerësimit dhe ka kryer monitorime për vetëvlerësimin . Gjithashtu, AKFPK ka monitoruar ofruesit e akredituar. Gjatë këtij 4 muori nuk ka patur akreditim te reja (pritje te miratimit te rregullores se ndryshuar te akreditimit).

Produkti: Akte ligjore të hartuara dhe miratuara. Gjatë vitit 4 muorit te 2025, janë hartuar dhe miratuar 4 akte ligjore dhe nënligjore si dhe raporte të monitorimit të politikave të AFP-së, si dhe raporte për PKIE dhe procesin e screening.

Produkti: Inspektive te Ofruesve te AFP-se Gjatë vitit 4 muorit te 2025, janë kryer 2 si dhe janë hartuar raportet përkatëse.

Gjatë 4 muorit te vitin 2025 projektet e investimeve të brendshme në ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave dhe bazave prodhuese dhe pajisjen e reparteve të praktikave profesionale me pajisje dhe makineri, pajisje për laboratorë, kompjuter dhe pajisje digjitale janë realizuar në masën 2%.


Figura 17 Programi i Arsimit të Mesëm Profesional (Programi 09240)



Programi i Strehimit (Programi 06190)

Programi i strehimit konsiston në hartimin, mbështetjen, zbatimin dhe monitorimin e politikave për sigurimin e strehimit të përballeshëm dhe të përshtatshëm për individë e familje që nuk përballojnë dot kostot e strehimit në treg, duke përcaktuar rregulla të përgjithshme, norma e standarde, si dhe duke siguruar financime për realizimin e politikave të programit.

Figura 18 Programi i Strehimit (Programi 06190)



Bazuar në Strategjinë Sociale për Strehimin 2016-2025, si dhe në synimin e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm, është përcaktuar si qëllim i politikës së programit “Përfshirja sociale dhe ekonomike nëpërmjet ofrimit të alternativave të strehimit të cilat janë të gatshme, të arritshme, të përballueshme dhe të përshtatshme, për individë e familje që nuk kanë mundësi financiare të përballojnë strehimin në treg dhe në veçanti grupet të cilat janë në pozita të pafavorizuara”.

Në zbatim të qëllimit të programit dhe në mbështetje të ligjit të buxhetit janë akorduar fondet për programet e strehimit në zërin e shpenzimeve korrente dhe Investimeve Publike.

Nëpërmjet këtij raporti do të prezantojmë situatën lidhur me realizimin e fondeve buxhetore, realizimin e treguesve të performancës, evidentimin e numrit të përfituesve për çdo program strehimi si dhe faktorët që kanë ndikuar në nivelet e caktuara të realizimit.

Performanca e treguesve kyç të performancës

Objekti i programi është të sigurojë, deri në vitin 2030, strehim të përshtatshëm e të përballueshëm për rreth 35,000 individëve/familjeve që kanë aplikuar për strehim dhe që nuk përballojnë dot kostot e tregut të banesave. Ky tregues llogaritet në mënyrë kumulative nga viti bazë 2016, dhe deri në fund të 4-mujorit të parë të vitit 2025 janë adresuar nevojat e 24,019 familjeve, duke realizuar objektivin afat-gjatë në masën 68.6%. Në këtë shifër nuk përfshihen familjet e mbetura të pastreha si pasojë e situatës së shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.20219, të cilat trajtohen me subvencionim qiraje.

Objekti i programit të strehimit matet dhe vlerësohet nëpërmjet treguesve të performancës si vijon:

Treguesi i performancës 1:

Përqindja e familjeve që kanë përmirësuar kushtet e jetesës si rezultat i përfitimit nga programet sociale të strehimit.

Ky tregues llogaritet në mënyrë kumulative duke marrë si baseline të dhënat mbi numrin e familjeve që kanë aplikuar për strehim në vitin 2016 dhe objektivin për adresimin e 35,000 familjeve deri në vitin 2030. Deri në fund të 4-mujorit të parë 2024, ky tregues është realizuar në vlerën 68.6% .

Treguesi i performancës 2:

Përqindja e përfituesve të kategorisë "Viktima të dhunës në familje" dhe "gra kryefamiljare" Ky tregues llogaritet gjithashtu në mënyrë kumulative nga viti 2018 dhe bazuar në "Strategjisë e Strehimit Social 2016-2025. Realizimi i këtij treguesi performance, deri në fund të 4-mujorit të vitit 2025 është 1,722 përfitues.

Tregues i performancës 3:

Përqindja e përfituesve të kategorisë Rom dhe Egjiptian.

Për këtë tregues merren për bazë të dhënat nga studimi i Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros, në vitin 2014, nga ku rezultojnë rreth 3000 familje të pastreha rome dhe egjiptiane. Ky tregues është llogaritur në mënyrë kumulative duke marrë të dhënat mbi numrin e familjeve që kanë aplikuar për strehim nga vitin 2016. Deri në fund të 4-mujorit të parë të vitit 2025 janë adresuar nevojat e rreth 3,440 familjeve të synuara. Duhet përmendur fakti se ende nuk ka një studim të mirfilltë mbi numrin e familjeve rome dhe egjiptiane që kanë nevojë për strehim.

Tregues i performancës 4:

Adresimi i jo me pak se 5% te familjeve te minoritetit Rom dhe Egjiptian në secilin program .

Në zbatim të nenit 31 pika 6 e ligjit nr.48/2023, datë 22.06.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", Njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikojnë që në programet sociale të strehimit jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program të plotësohen nga familje të minoriteteve rome egjiptiane. Familjet e minoriteteve rome dhe egjiptiane konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit për të gjitha kriteret e parashikuara në ligj, si dhe për përparësitë ose pikëzimet e vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në zbatim të këtij ligjit"

Përqindja e përfituesve të kategorisë Rom & Egjiptian që futen rishtas në skemën e kredive të reja.

Realizimi i këtij treguesi performance nuk është arritur sipas nivelit të parashikuar sepse pas procesit të vlerësimit që bankat bëjnë për familjet e përzgjedhura nga bashkitë, familjet e minoritetit Rom dhe Egjiptian nuk plotësojnë kushtet për shlyerjen e kredisë. Nga ky Minoritet ka përfituar vetëm 1 Familje.

Përqindja e përfituesve të subvencionit të qirasë të kategorisë Rom & Egjiptian.

Në terma sasiorë, për 4-Mujorin, nga totali i përfituesve prej rreth 721 familje, 155 familje i përkasin minoritetit rom dhe egjiptian, ose rreth 21.5%.

Përqindja e përfituesve të kategorisë Rom and Egjiptian për projektet e përmirësimit të banesave ekzistuese dhe rikonstruksionit të godinave.

Ky tregues performance u realizua në vlerën 6% .

Tregues i performancës 5:

Numri i të punësuarve në administratën publike që përfitojnë kredi të subvencionuar nga shteti. Programi synon të trajtojë me kredi të lehtësuara punonjësit e Administratës Publike, në zbatim të VKM nr.468, datë 26.07.2023 "Për trajtimin me kredi të lehtësuara të të punësuarve të administratës publike për blerjen e banesës". Për vitin 2025 janë planifikuar 530 kuota dhe 12 Institucionet përfituese janë në fazën e shpalljes së punonjësve që do të përfitojnë nga ky program.

Procesi për 300 kuotat e shpallura ne vitin 2024 është në proces dhe punonjësit e administratës kanë kohë deri në 3 mujorin e fundit të vitit 2025 për të lidhur kontratat e kreditimit. Aktualisht kanë përfituar 64 punonjës të administratës publike.

Performanca e buxhetit

Performanca financiare shpenzime korrente

Në mbështetje të ligjit 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, për programin e strehimit janë akorduar 745 000 mijë lekë në shpenzimet korrente në artikullin buxhetor 606 “Transferata për Buxhetet Familjare dhe Individët”.

Subvencionimi i interesave për kreditë ekzistuese

Me anë të këtij instrumenti financiar janë subvencionuar interesat e kredive për rreth 5,923 familje, me vlerë të realizuar 41,760 mijë lekë ose 10% e fondit vjetor të planifikuar për këtë program. Subvencionimin e interesave të kredive të reja

Gjatë 4- mujorit të vitit 2025 janë bërë pjesë e skemës së kreditimit të lehtësuar 100 familje të reja me një vlerë fondi të realizuar prej 19,036 mijë lekë, ose 21% e fondit të planifikuar. Nga nr.familjeve përfitues 64 i përkasin programit të trajtimit me kredi të lehtësuar të administratës publike. Kosto për njësi për produktin subvencionimi i interesave të kredisë, ndikohet si nga normat e interesit në momentin që familja lidh kontratën e kredisë me institucionin financiar ashtu edhe nga periudha e lidhjes së kontratës së kredisë, pasi kosto nuk shpërndahet në mënyrë të barabartë për çdo përfitues.

Subvencionim qiraje në tregun e lirë

Në buxhetin e vitit 2025 janë miratuar 200,00 mijë lekë për produktin e subvencionimit të qirasë, nga të cilat 190,000 mijë për subvencionimin e qirasë në tregun e lirë të dhe 10,000 mijë lekë të planifikuar për Entin Kombëtar të Banesave për trajtimin me pagesën e qirasë për familjet që preken nga zbatimi i projekteve të Investime Publike, për Tiranën dhe Vlorën

Thirrjes për aplikim për subvencionimin e qirasë në tregun e lirë i janë përgjigjur 30 NJVV. Pasi janë shqyrtuar praktikat dhe pas plotësimeve të dokumentacionit, fondet janë planifikuar të ndahen për 29 NJVV dhe transferuar fondet në vlerën 194 milionëlekë, për 2,163 familje totale të planifikuara.

Kërkesat totale të paraqitura nga NJVV, për pjesën e bashkëfinancimit nga buxheti i shtetit janë 240 milionë lekë, duke lënë të pambuluar financimin prej 50.8 milionë lekë.

Në fund të 4-Mujorit janë realizuar 76,523 mijë lekë dhe kanë përfituar 721 familje.

Për vitin 2025, kërkesa për subvencionimin e qirasë në treg të lire ishte më e lartë se tavani buxhetor i parashikuar për këtë vit. Për këtë arsye shpërndarja e fondeve në fillim të vitit u bë sipas pikës 7 të udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, ku thuhet që, financimi nga buxheti i shtetit për cdo njësi të vetëqeverisjes vendore do të bëhet në varësi të të ardhurave për frymë të NJVV dhe në raport të drejtë me numrin e aplikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore përkundrejt totalit të aplikimeve në shkallë vendi. Pjesa tjetër e fondit do të paraqitet si kërkesë shtesë në rast se do të plotësohet gjatë vitit me anë të rishikimit të buxhetit.

Granti i Menjëhershëm

Thirrjes për aplikim i janë përgjigjur 3 NJVV (Bashkia Durrës, Bashkia Korçë dhe Bashkia Vlorë), me nr.aplikuesish 16 familje dhe fond i kërkuar 3,198 mijë lekë.

Fondet e kërkuara i janë transferuar bashkive dhe bashkitë në vijim do të transferojnë fondin në llogari të Entit Kombëtar të banesave për uljen e detyrimit që këto familje përfituese kanë për blerjen e banesave.

Subvencionim qiraje për banorë të shpronësuar nga Unaza Madhe, Tiranë

Në zbatim të VKM nr. 409, datë 16.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen” buxheti i shtetit do të subvencionojë qiranë e familjeve të cilat preken

që preken nga projekti “Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Shkozë”. Viti i parë finncimi do të jetë 100% nga buxheti i shtetit, vitin e dytë 60% nga buxheti i shtetit dhe 40% nga buxheti i bashkive Tiranë dhe Kamëz dhe vitin e tretë 30% nga buxheti i shtetit dhe 70% nga buxheti i bashkive. Për vitin 2025, Bashkia Kamëz paraqiti kërkesën për fonde buxhetore në vlerën 17,258 mijë lekë për 198 familje ndërsa bashkia Tiranë ka paraqitur kërkesën për 13,671 mijë lekë për 133 familje. Fondet janë alokuar sipas kërkesave dhe në 4 mujorin e parë janë realizuar 5,062 mijë lekë, për 110 familje.

Performanca financiare shpenzime kapitale

Në zbatim të ligjit 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Ligjit nr.22/2018 “ Për strehimim social”, i ndryshuar, për programin e strehimit janë akorduar 550,000 mijë lekë në zërin e shpenzimeve kapitale.

Financimi i brendshëm

Fondet për secilin vit buxhetor ndahen në fonde për financimin e projekteve në vazhdimësi nga viti i kaluar dhe hapsira fiskale parashikohet për financimin e projekteve të reja të Investimeve, bazuar në thirrjen për aplikim për mbështetje buxhetore, dërguar 61 NJVV çdo vit nga ministri përgjegjës për strehimin.

Procedura realizohet nëpërmjet grantit konkurrues, ku në termat e referenës përcaktohen llojet e projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit pjesërisht apo plotësisht sipas përqindjes së bashkëfinancimit, kufijtë e financimit dhe kushtet që duhet të plotësojë Bashkia për t’u kualifikuar; formati i Aplikimit si dhe kriteret e vlerësimit për projektet e investimit.

Këto projekte adresojnë përmirësimin e kushteve të banimit për familje që i përkasin kryesisht familjeve të minoritetit rom dhe egjiptian, familje me ndihmë ekonomike, PAK, të moshuar të vetmuar në moshë pensioni, si dhe gra kryefamiljare në ngarkim fëmijë të mitur etj.

Për vitin 2024 referuar thirrjes për aplikim, Komisioni i Vlerësimit të Projekteve, përzgjedhi fituese 22 NJVV, me vlerë kontate të projekteve fituese 542,610 mijë lekë, ku bazuar në % e bashkëfinancimit, 135,481 mijë lekë financohen nga Bashkitë, ndërsa 407,129 mijë lekë nga buxheti i shtetit.

Bazuar në buxhetin në dispozicion, për vitin 2024, për këto 22 NJVV u transferuan fonde në vlerën 300,055 mijë lekë. Njësitë u njofuan të vijnë me procedurat e prokurimit dhe lidhjen e kontratave. Fondi i mbetur prej 107,073 mijë lekë u transferua në vitin 2025 dhe aktualisht projektet janë në fazën përfundimtare të tyre Pra nga buxheti në dispozicion 550,000 mijë lekë akorduar për vitin 2025, janë alokuar në muajin Mars 107,073 mijë lekë për projektet që janë në vijim nga viti i kaluar 2024, dhe pjesa tjetër prej 441,370 mijë lekë janë për projektet e reja që do të shpallen fituese në vitin 2025.

Afati i aplikimit për projektet e reja ka qenë data 31 Janar dhe gjatë kësaj kohe është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i 55 projekteve të dërguara nga 43 njësi të vetëqeverisjes vendore, me një vlerë totale fillestare investimi prej 2,271,280,207 lekë dhe nga buxheti i shtetit kërkohet një fond prej 1,732,192,302 lekë, që përbën rreth 76% të vlerës totale të investimit. Kjo shumë është rreth 3.9 herë më e lartë nga shuma e vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (440 mln lekë), planifikuar për projektet e reja të strehimit për vitin 2025. Sipas propozimeve të ardhura nga bashkitë, me këtë vlerë adresohen nevojat për përmirësimin e kushteve të banimit për 2844 familje gjithsej, nga të cilat rreth 7% i përkasin minoritetit Rom dhe Egjiptian, dhe pjesa tjetër i përkasin kategorive të familjeve me ndihmë ekonomike, të moshuar pa përkrahje, PAK, familje me një prind, familje me gra kryefamiljare dhe të tjera sipas nenit 16, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar.

Në muajin Maj Komisioni i Vlerësimit të projekteve do të marrë vendimin mbi projektet fituese dhe në vijim do të alokohen edhe fondet në dispozicion për këto projekte.

Rikonstruktion i godinave në pronësi të NJVV për Strehim Social (Kodi: M100397)

Për këtë projekt alokuar 12,457 mijë lekë për Bashkinë Mat, fituese në vitin 2024. Punimet fizike janë në përfundim dhe pritet që objekti të merret në dorëzim gjatë 6 muajve të parë të vitit.

Nga projekti kanë përfituar 35 familje, nga të cilat 2 familje janë pensionistë; 2 përfitues janë gra kryefamiljare, 31 familje me Ndihmë Ekonomike dhe të papuna.

Përmirësimi i infrastrukturës kryesisht për zonat informale (Kodi: 18AY404)

Për këtë projekt alokuar 21.9 milionë lekë për Bashkitë fituese Shkodër dhe Fier në vitin 2024. Realizuar 1.8 milionë lekë. Realizimi i punimeve fizike është në fazën përfundimtare dhe priten të merren në dorëzim brenda 6 muajve të parë të vitit.

Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara (Kodi: M100399)

Për këtë projekt alokuar 47.8 milionë lekë për 15 Bashkitë fituese në vitin 2024. Realizuar 1.8 milionë lekë. Realizimi i punimeve fizike është në fazën përfundimtare dhe priten të merren në dorëzim brenda 6 muajve të parë të vitit.

Referuar performancës financiare për periudhën 4-Mujore raportuese mund të shprehem se niveli i realizimit në zërin e Shpenzimeve korrente dhe kapitale lidhet me faktin se gjatë 4 -Mujorit të parë, bëhet vlerësimi dhe shqyrtimi i aplikimeve lidhur me produkte si Subvencionim qiraje në tregun e lirë, grantin e menjëhershëm dhe produkti i Investimeve (përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara).

Produktet priten të realizohen gjatë 4- muajve të dytë.

Ndërkohë treguesi i performancës lidhur me adresimin e jo me pak se 5% të familjeve të minoritetit Rom dhe Egjiptian në secilin program, është realizuar duke tejkaluar edhe objektivin. Gjithashtu është mundur përfshirja më e madhe në programet sociale të strehimit edhe për kategorinë "Viktima të dhunës në familje" dhe "gra kryefamiljare".

Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës nëpër programet

Më poshtë paraqiten të dhënat ku Aparati MFE është pjesë e programeve.

Shpenzimet korrente në lekë

Ent. Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i Produktit	Plani	Fakt
						Total MEKI	1,611,542,777	276,083,792
001	12	1012001	01	01110	600	91201AA	238,687,000	131,303,596
001	12	1012001	01	01110	601	91201AA	39,400,000	21,035,795
001	12	1012001	01	01110	602	91201AB	135,844,000	45,356,678
001	12	1012001	01	01110	605	91201AB	30,000,000	5,144,009
001	12	1012001	01	01110	606	91201AB	4,456,872	1,045,127
							448,387,872	203,885,205
001	12	1012001	01	01150	600	91204AC	100,000,000	-

001	12	1012001	01	01150	601	91204AC	10,000,000	-
001	12	1012001	01	01150	602	91204AB	15,250,000	960,692
							125,250,000	960,692
001	12	1012001	01	04130	602	91205AA	31,625,000	5,385,655
							31,625,000	5,385,655
001	12	1012001	01	06190	606	91208AC	5,955,249	-
001	12	1012001	01	06190	606	91208AD	6,801,629	-
001	12	1012001	01	06190	606	91208AE	9,069,927	-
							21,826,805	-
001	12	1012001	01	08220	600	91202AH	3,786,000	-
001	12	1012001	01	08220	601	91202AH	1,724,000	-
001	12	1012001	01	08220	602	91202AD	63,776,000	-
001	12	1012001	01	08220	604	91202AD	92,219,000	17,413,800
001	12	1012001	01	08220	606	91202AG	113,000,000	-
							274,505,000	17,413,800
001	12	1012001	01	08230	600	91203AR	2,201,000	-
001	12	1012001	01	08230	601	91203AR	790,000	-
001	12	1012001	01	08230	602	91203AJ	44,864,000	8,088,287
001	12	1012001	01	08230	604	91203AJ	229,450,000	38,638,730
001	12	1012001	01	08230	604	91203AL	150,000,000	507,056
001	12	1012001	01	08230	605	91203AJ	8,150,000	1,202,376
							435,455,000	48,436,449
001	12	1012001	01	09240	600	91209AB	17,000	-
001	12	1012001	01	09240	600	91209AG	12,200,000	1,991
001	12	1012001	01	09240	600	91209AI	8,400,000	-
001	12	1012001	01	09240	601	91209AB	3,000	-
001	12	1012001	01	09240	601	91209AG	2,100,000	-
001	12	1012001	01	09240	601	91209AI	1,400,000	-
001	12	1012001	01	09240	602	91209AB	240,120	-
001	12	1012001	01	09240	602	91209AG	37,500,000	-

001	12	1012001	01	09240	602	91209AI	6,500,000	-
001	12	1012001	01	09240	606	91209AB	186,102,980	-
001	12	1012001	01	09240	606	91209AC	14,500,000	-
							268,963,100	1,991
001	12	1012001	01	10220	600	91210AR	4,650,000	-
001	12	1012001	01	10220	601	91210AR	880,000	-
							5,530,000	-

Shpenzimet kapitale me financim te brendshëm

Programi	Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	Plani	Obligim	Fakt	Fonde te disponushme
		Total MEKI	2,970,330,655	503,381,097	888,755,621	1,578,193,937
01110	24AG801	F.V. Sistem ngrohje ftohje per ish ambjentet e MZHETTS sot MEKI	22,100,000	21,644,832	-	455,168
01110	24AI901	Rikonstruksion i godinës për ish ambjentet e MZHETTS	47,900,000	47,900,000	-	-
01110	M120245	Blerje Pajisje	10,000,000	-	-	10,000,000
		Total	80,000,000	69,544,832	-	10,455,168
01150	24AI501	Biletimi Qendror ON Line per Muzete dhe Sitet e Trashegimise Kulturore	50,000,000	-	-	50,000,000
01150	24AD901	Transferte kapitale	1,000,000,000	-	867,200,000	132,800,000
		Total	1,050,000,000	-	867,200,000	182,800,000
04130	M100332	TVSH per projektet me financim te huaj	20,000,000	-	14,150,514	5,849,486
		Total	20,000,000	-	14,150,514	5,849,486
06190	18AY404	Projekte për përmirësimin e infrastruktures, kryesisht ne zona informale që janë në proces legalizimi	19,099,344	-	-	19,099,344
06190	M100397	Rikonstruksion i godinave ne pronesi te Njesive te Qeverisjes Vendore per strehim social	148,542,344	-	-	148,542,344
06190	M100399	Permiresim i kushteve te banimit per komunitetin Rom/Egjiptian	300,156,300	-	-	300,156,300

		Total	467,797,988	-	-	467,797,988
8220	18AE409	Hartim projekti shtepia e Arberesheve	30,000,000	-	-	30,000,000
		Total	30,000,000	-	-	30,000,000
8230	18AE703	Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjës Muzeore në Muzeun Historik	25,000,000	-	-	25,000,000
8230	18AE706	Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të Bukura (GKA)	200,000,000	2,619,223	2,380,777	195,000,000
8230	18AE715	Ndërtimi i Qendres Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave	150,000,000	-	-	150,000,000
8230	M120201	Fond i ngjirë	138,863,667	-	-	138,863,667
8230	19AA302	TVSH për projektet me financim të huaj	200,000	-	-	200,000
		Total	514,063,667	2,619,223	2,380,777	509,063,667
9240	M120201	Fond i ngjirë	27,915,000	-	-	27,915,000
9240	18AY503	Laboratore, pajisje, makineri për reparatet e praktikave profesionale	100,000,000	74,648,424	-	25,351,576
9240	18AY639	Ndërtim rikonstruksion i reparatit të praktikave profesionale shkollë "Karl Gega", Tiranë	36,430,000	32,786,800	-	3,643,200
9240	24AB502	Rikonstruksion i godinës së shkollës Mekanike "Hasan Gjinë" Lushnjë	51,952,000	-	-	51,952,000
9240	24AB503	Rikonstruksion/ndërtim i ri godinës së shkollës dhe repartëve të praktikave Industriale Pavarësisht Vlores	148,783,000	-	-	148,783,000
9240	24AB504	Rikonstruksion Konvikti Cerrik	25,000,000	-	-	25,000,000
9240	24AB505	Rikonstruksion Shkollë "Bajram Curri", Kukës	58,794,000	50,188,180	-	8,605,820
9240	24AB506	Rikonstruksion për shkollën "Enver Hoxha", Pogradec	49,213,000	46,852,278	-	2,360,722
9240	24AB507	Rikonstruksion/ndërtim për godinën e shkollës dhe reparatet e praktikave profesionale të Shkollës Teknike, Korce	55,898,000	-	-	55,898,000
9240	24AB509	Rikonstruksion i Shkollës Arben Broci	82,314,000	79,844,580	-	2,469,420

9240	24AB510	Ndërtim /rikostruksion Shkolla “Hamdi Bushati”, Shkoder	32,648,000	29,383,220	-	3,264,780
9240	24AB511	Ndërtim I ri I Shkollës Karl Gega Tirane	121,148,000	117,513,560	-	3,634,440
9240	24AB512	Taksa per ndikim ne infrastrukture	2,085,000	-	2,084,936	64
9240	18BS314	TVSh per projektet te ndryshme	16,289,000	-	2,939,394	13,349,606
		Total	808,469,000	431,217,042	5,024,330	372,227,628

Shpenzimet kapitale me financim te huaj

Ent. Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Art.	Kod	Emertimi	Faktike
001	12	1012001	02	04130	231	18AX304	Programi Italian	15,041,210

SHPENZIMET NGA TË ARDHURAT JASHTË LIMITIT

Për vitin 2025, në nivel grupi 12 , MEKI, janë shpenzuar rreth 21,198,443 lekë nga të ardhurat jashtë limitit, në programet:

Institution		Realizim në lekë
Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inov	Shp. Operative	1,820,670
Arkivi Qendror i Filmit (3535)	Shp. Operative	405,849
Teatri Operas dhe Baletit (3535)	Shp. Operative	2,326,732
Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (3535)	Shp. Operative	1,173,666
Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (3535)	Shp. Operative	3,740,656
Drejtoria Qendrore AKPA (3535)	Shp. Operative	9,186,000
Q.Form. Profes. Korçë (1515)	Shp. Operative	80,539
Q.Form. Profes. Vlore (3737)	SINV	466,776
Q.Form. Profes. Levizshme (3535)	SINV	240,000
Shk. Prof. "Mihal Shahini" Elbasan (0808)	SINV	198,980
Shk. Prof. "Mihal Shahini" Elbasan (0808)	Shp. Operative	131,940
Shkolla e Sherbimeve Korce (1515)	Shp. Operative	1,337,160
Shkolla e Sherbimeve Korce (1515)	Shp. Personeli	5,920

Përfundimi

- i. Plan i fillestar i buxhetit për shpenzimet korrente për vitin 2025 u miratuan me shkresën nr. 17786/17, datë 21.01.2025, në grupin 12, të Ministrisë së Financave.
- ii. Plan i fillestar i buxhetit për shpenzimet kapitale FB për vitin 2025 u miratuan me shkresën nr.1110/1, datë 22.02.2025, në grupin 12, të Ministrisë së Financave.
- iii. Financimi i huaj është detajuar gjatë muajit maj në sitemin SIFQ.
- iv. Referuar të dhënave buxhetore të gjeneruara midis Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar Shqiptar (AFMIS) vihen re se në anekset e monitorimit të gjeneruara nga AFMIS nuk paraqiten të dhënat e art. 232 “*Transferta kapitale*” për programin 01150, përkatësisht në vlerën 1 miliardë lekë për vitin 2025 dhe 20 milionë leke për program 01110 në vitin 2024.
- v. Programet që janë transferuar nga grupi 10 në grupin 12 nuk iu shfaqën fondet e realizuar në grupin 10 për 4 muajin e parë të vitit 2024. Në këto kushte është ndërhyrë në çdo aneks për të rakorduar me MF për faktin e vitit 2024.
- vi. Gjatë gjenerimit të raporteve sjellim në vëmendje që sistemi AFMIS shfaq probleme, gjë që bëri të pamundur përdorimin e sistemit në një periudhë shumë vendimtare për hartimin e pasqyrave të monitorimit. Treguesit e performancës (Sasite), janë plotësuar manualisht në anekset e monitorimit.